

Xhevat Syla, Shefkije Islamaj, Rizah Sheqiri

LETËRSIA SHQIPTARE

Fletore tematike
për nivelin e tretë

duk gjini

**MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS**

**TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË**

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Nexhat Maloku,
Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla.

Hartues të këtij teksti: Xhevat Syla, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut
(Instituti IPE – International Projects in Education) dhe
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.

PH Zürich



**LOTTERIEFONDS
KANTON ZÜRICH**

PËRMBAJTJA

1. Gjuha shqipe – Ndre Mjedja	7
2. Ti, Shqipëri, më jep nder - Naim Frashëri	9
3. Bukë e kripë e zemër – Mark Gurakuqi	10
4. Bijtë e shqipes – Bajroni	13
5. Skënderbeu u flet ushtarëve – Marin Barleti	15
6. Malli i atdheut - Faik Konica	17
7. Bukuria e Tanushës – Këngë kreshnike	19
8. Fytyra e asaj – Sef Serembe	24
9. Dita e Flamurit – Fan S. Noli	26
10. 28 Nëntori – Lasgush Poradeci	28
11. Poezia patriotike - Rexhep Qosja	30
12. Zëri i nënës – Din Mehmeti	32
13. Dila e Marisë – Anton Pashku	34
14. Rruga që shkela dikur - Jusuf Gërvalla	36
15. Dëshmi – Ismail Kadare	38
16. Jeta - Nënë Tereza	41
17. Një natë në Stamboll – Nonda Bulka	42
18. Katër këshilla vetes – A. Shkreli	44
19. Mollë e ndalueme – Migjeni	46
20. Vendit tem – Martin Camaj	48
21. Gjarpri i shtëpisë - Arif Demolli	50
22. Hapma derën zonja mëmë – Vorea Ujko	54
23. Anija e kapitenit Batllar – Abdylazis Islami	56
24. Poçari – Dritëro Agolli	59
25. Malli - Eqrem Basha	61

26. Epoka para gjyqit – Ekrem Kryeziu	63
27. Refugjat – Frederik Reshpja	69
28. Isa Boletini – Sabri Hamiti	70
29. Yjet nuk vishen kështu – Elvira Dones	72
30. Çamëria – Eqrem Cabej	75
31. Baladë Çame – Bilal Xhaferri	77
32. Në veri – Ramiz Kelmendi	79
33. E marta - Rrahman Dedaj	82
34. Elegji për kosovën - Mihal Hanxhari	87
35. Fjalë të urta – Populli	89
36. Një natë nga netët pa gjumë – Ali Podrimja	90
37. Kokërrmeli – Përrallë shqiptare	92
38. Ëndrra... pastaj Vlora – Abdullah Konushevc	94
39. Debutimi im në Burgteatër – Aleksandër Moisiu	96
40. Dhoma ime në Ulqin – Basri Çapriqi	99
41. Si u emërova mësues – Petro Marko	100
42. Rubaitë e mëngjesit – Omar Khajami	103
43. Poeti i vogël – Gjergj Zheji	104
44. Pranverë – Vitore Stefa – Leka	107


PARATHËNIE

Me fletoret për letërsinë shqiptare dedikuar mësimi plotësues të nxënësve shqiptarë në diasporë janë bërë përpjekje t'u përgjigjemi kërkesave që për këtë lëndë apo fushë mësimore shtron kurrikula e miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës. Jemi munduar të përzgjedhim tekste të përshtatshme, të cilat do të kenë ndikim në forcimin e ndjenjës së përkatësisë kombëtare, tekeste të lidhura me momentet historike dhe me vlerat e rëndësishme të traditës sonë kombëtare, kryesisht të autorëve të cilët kanë një vend të caktuar në letërsinë shqipe, librat e të cilëve janë të preferueshëm për nxënësit të cilëve u dedikohen këto fletore.

Në fletoren për nivelin e tretë, kishim dëshirë sidomos që, përveç teksteve të zgjedhura të disa autorëve të traditës letrare, të ofronim një panoramë të teksteve të zgjedhura të autorëve më të rëndësishëm të letërsisë sonë bashkëkohore, por doli të ishte e pamundur për shkak të kërkesave të caktuara të kurrikulës, të përshtatshmërisë së teksteve nevojave të caktuara, si dhe për shkak të vëllimit të kufizuar të kësaj fletoreje. Sidoqoftë, konsiderojmë se kjo fletore përmban vlera të caktuara të autorëve të letërsisë sonë, duke filluar nga ata të traditës letrare e deri tek autorë të brezit më të ri, të cilat do të jenë të përshtatshme për lexim si të tilla, por edhe si udhëzim për lexuesit që dëshirojnë të thellohen më shumë në leximin e letërsisë shqipe.

Vërejtjet dhe sugjerimet nga opinioni, nga nxënësit dhe mësuesit e shkollës shqipe në diasporë do të jenë të mirëseardhura për përparimin e mëtejme të cilësisë së kësaj fletoreje, si dhe të fletoreve të letërsisë shqiptare për nivelet e tjera, të parin dhe të dytin.

Autorët





GJUHA SHQIPE

Përmbi zâ që lëshon bylbyli,
Gjuha shqipe m'shungullon,
Përmbi erë që jep zymbyli,
Pa da zemrën ma ngushllon.

Ndër komb'tjera, ndër dhena tjera,
Ku e shkoj jetën tash sa mot,
Veç për ty m'rreh zemra e mjera,
E prej mallit derdhi lot.

Njikto gjuhë që jam tu ndie,
Janë të bukura me themel,
Por prap kjo, si dielli pa hije,
Për mue t'tanave ia del.

Geg'e Toskë, Malsi jallia,
Janë një komb m'u da s'duron,
Fund e maje një â Shqipnija,
E një gjuhë t'gjith na bashkon.

Qoftë mallkue kush qet ngatrrime,
Ndër këta vllazën shoq me shoq!
Kush e ndan me fjal' e shkrime,
Ç'ka natyra vet përpoq!

Ndre MJEDJA

Bisedojmë për poezinë

Gjuhës poetët i kënduan me shumë dashuri, ashtu siç i kënduan edhe atdheut, si një gjëje të shenjtë. Asaj i kanë kushtuar rëndësi të veçantë intelektualët dhe atdhetarët tanë. Edhe dom Ndre Mjedja, poeti i shquar i Rilindjes Kombëtare, i këndoi me shumë mall e dashuri gjuhës sonë. Ai këndoi duke qenë i mërguar në dhe të huaj, atje ku malli e përvëlonte për vendin dhe për njerëzit ku do të dëgjonte gjuhën e vet, siç e thotë ai vetë, atë më të mirën, më të bukurën, më të dashurën ndër gjithë gjuhët e tjera.

Pyetje

Përse poeti Ndre Mjedja këndon më kaq dashuri për gjuhën?

Ju që jetoni në vende të ndryshme të botës çka mendoni për rëndësinë e gjuhëve të ndryshme?

Detyrë

Poezia është shkruar në dialektin gegë. Gjeneroni dhe shënoni dallimet me gjuhën standarde letrare shqipe.



Pak fjalë për shkrimtarin

Ndre MJEDJA (1866-1937) lindi dhe vdiq në Shkodër. Mësimet e para dhe gjimnazin e jezuitëve e kreu në vendlindje, ndërsa për teologji studioi në Spanjë, Poloni, Kroaci dhe Itali. U doktorua në filozofi dhe teologji. Punoi si mësues, por edhe familjar në disa fshatra të Shkodrës, ku zhvilloi aktivitet patriotik dhe kulturor. Bashkë me vëllanë Llazër Mjedjen themluan shoqërinë Agimi, e cila krijoi alfabet të vetin dhe botoi edhe libra shkollorë. Si përfaqësues i kësaj shoqërie, Mjedja mori pjesë në Kongresin e Manastirit dhe u zgjodh anëtar i komisionit për përpilimin e alfabetit të shqipes. Një vend me rëndësi në punën e Mjedjes zë krijimtaria poetike. Poemthin Vaji i bylbylit e botoi kur ishte vetëm 21-vjeçar. Botoi edhe veprën poetike Juvenilia (1917, Vjenë) etj.

TI, SHQIPËRI, MË JEP NDER

Ti, Shqipëri, më jep nder, më jep emrin shqipëtar,
Zemrën ti ma gatove plot me dëshirë e me zjarr.
Shqipëri, o mëma ime, ndonëse jam i mërguar,
Dashurinë tënde kurrë zemra s'e ka harruar.
Kur dëgjon zëthin e s'ëmës, qysh e le qengji kopenë?
Blegërin dy a tri herë, edhe ikën e merr dhenë,
Edhe në i prefshin udhën njëzet a tridhjetë vetë
E ta trembin, ai s'kthehet, po shkon në mes si shigjetë.
Ashtu dhe kjo zemra ime më le këtu, tek jam, mua,
Vjen me vrap e me dëshirë aty, në viset e tua! ...

Naim FRASHËRI

Fjalorth

kopenë – tufën e deleve

Bisedojmë për poezinë

Njeriu është krenar me atë që është. Se kështu edhe duhet të jetë, mbase na mësojnë më së miri këto vargje të shkëputuara nga poema e Naim Frashërit „Bagëti e Bujqësi“, e cila është një himn bukurisë së atdheut dhe dashurisë ndaj tij.

Pyetje

Si e mendon poeti që Shqipëria i jep nder; pse ajo i jep nder?

Ç'është për poetin Shqipëria?

Si e përjeton ti identitetin tënd shqiptar (apo të qenit shqiptar) në një vend të huaj?

Çka mendojnë të tjerët atje ku jeton ti për shqiptarët dhe për identitetin shqiptar?

Detyrë

Shkruaj një ese të shkurtër (1 faqe) për njërën nga 4 pyetjet më lart.



Pak fjalë për shkrimtarin

Naim FRASHËRI (1846-1900) lindi në Frashër të Përmetit dhe vdiq në Stamboll. Mësimet e para i mori në vendlindje të hoxha i fshatit, ndërsa në Janinë kreu gjimnazin „Zosimea“. Aty njohu letërsinë klasike greke e latine dhe kulturën evropiane, ashtu si edhe gjuhën dhe letërsinë persiane. Pas gjimnazit dy vjet qëndroi në Stamboll, prej nga përsëri u kthye në atdhe, i sëmurë nga tuberkulozi, ku qëndroi po ashtu dy vjet. Punoi në Berat dhe në Sarandë. Ishte për mjekim në ilixhat e Austrisë. Ishte vëlla i Sami e Abdyl Frashërit dhe shumë aktiv në lëvizjen patriotike kombëtare. Vepra të tij të njohura janë: „Vjersha për mësonjtoret e para“, „Bagëti e bujqësia“, „Lulet e verësë“, „Historia e Skënderbeut“ etj.



BUKË E KRYPË E ZEMËR

Ndodheshim në një fshat malor, dy orë larg Krujës e ku kamba e turkut s'kishte mundur të shkille.

Gjini u drejtue nga një shtëpi, që ndodhej në majë të një rrëpine.

Si u afruen, Skënderbeu ja pat:

- A doni miq, o i zoti i shtëpisë?

Përgjigja nuk erdhi menjëherë. Mbas pak kohe, në krye të shkallëve doli një grue:

- Urdhëroni, bukë e krip e zemër.

Skënderbeu i tha Gjinit:

- Na prij! - dhe e ndoq.

Kur hynë mbrenda, vunë re se s'kishte njeri tjetër. Grueja ishte një pesëdhjetëvjeçare. Dukej e plakun para kohe.

- Lironju, burra! - u tha ajo.

Ata hoqën armët, simbas zakonit, e i vendosën në një skaj, të gjitha bashkë.

Skënderbeu e të tjerët u ulën rreth votrës. Në buxhakun tjetër, qëndroi ajo.

Për pak, s'foli njeri.

Pastaj, heshtjen e theu e zonja e shtëpisë. Ajo pyeti:

- A u lodhët, burra?

- Pak po, për besë, - u përgjegj, tue buzëqeshë, Skënderbeu.

- Asht koha, - tha plaka dhe shtoi: "A sot a kurrë".

Fliste thjeshtë, e me za të premë. Çdo fjalë e saj dilte nga zemra, me bindje.

Skënderbeu s'ja ndante sytë. E, tue kundrue, mendonte: -"Ja ky asht populli. Fjalë pak e punë shumë. Sulltani e fuqitë e hueja çuditen pse ne fitojmë gjithnjë. Po të na shihnin sonde, në këtë shtëpi të thjeshtë, po të ndigjonin si flet kjo plakë e vuajtur, do të kuptonin ku qëndron fshehtësia e ngadhnjimeve tona: te populli".

E shkundi nga këto mendime zani i plakës. Ajo i fliste Gjinit:

- Mos u zoritni, burra. Për miqtë, shtëpia asht gjithnji çilë. Tash po ju shtroj sofrën. Nuk keni me më fikë për pak groshë e qepë, - dhe shtoi:
- Duhet të hani. Lufta don forcë. Duhet me e zhbimë sa më shpejt këtë farë të keqe.
- Fjalë me vend, motër. Dhe ne do ta zhbijmë – iu përgjegj Gjergji (Skëndërbeu); e tue qeshë shtoi:
- Sa për të ngranë, me të thanë të drejtën na ka marrë pak uria. Prandaj edhe ta behëm kaq vonë...
- Plaka ja preu fjalën:
- Për trimat e Gjergjit shtëpia asht çelë natë e ditë. T'ja thoni edhe atij, kur ta shihni.
- Gjini deshi të flasë, por Skëndërbeu i shtërngoi krahun sikur të donte t'i thoshte: "Hesht..." E ju përgjigj vetë plakës:
- Të faleminderës motër. Gjergji e din këtë. Ne do t'ia thomi sa ta takojmë. Ajo ja nguli sytë me dashamirësi. Pastaj e pyeti:
- Si asht ai?
- Njeri, si të tjerët, - iu përgjigj Gjergji.
- Plaka buzëqeshi:
- Kështu më thonin edhe djemtë e mi kur i pyesja.
- Gjergji desh ta pyes por ajo s'e la. Vazhdoi:
- Ata ishin me te. U vranë.
- Ai u drodh, i mallëngjyshëm. Pyeti:
- S'ke njeri tjetër?
- Si s'kam? Gjergjin e sokolat e tij, – u përgjegj ajo.
- Gjergji s'duroi ma e i tha:
- Më fal, motër.
- Plaka e shikoi me habi:
- Ti s'bane asgja të keqe. S'kam çka me të falë.
- Po, motër, bana. Edhe njëherë më fal. Gjergji jam unë.
- Ajo shtangu. I nguli sytë, si të kundëronte një vegim të çuditshëm, të paprekshëm. Belbëzoi:
- Mos u tall me mue, o trim!
- Gjergji u ngrit, e përqafoi:
- Nuk tallem, motër. Unë jam Gjergji.
- Jo, ai s'kishte pse të tallej, ta gënjente. Ai thonte të vërtetën, ai ishte Gjergji.
- E pushtoi me ngashërim, me dashurinë e thellë të një nane, të një motre. Lotët vërshuan nga sytë e saj. Lotë të ngrohtë dashunie, gëzimi. E shqiptonte: "Gjergj! Gjergj! ", " Të falemnderit, bir! ..."
- Të tjerët vështronin të mahnitun atë skenë, në atë dhomë të thjeshtë, ndër dritën e pishës... Biseduan deri vonë, aty rreth votrës...

Mark GURAKUQI

Fjalorth

rrëpinë – faqe mali shumë e pjerrët
buxhakun – qoshe pranë vatrës
tue kundrue – duke shikuar
çilë - hapur

Bisedojmë për tregimin

Ky është një rrëfim i bukur nga koha e Skënderbeut. Na e jep të gjallë atë, por nëpërmjet figurës së plakës na paraqet edhe diç shumë më shumë: pranimin që pati dhe shpresën që kishte mbjellë Gjergji në popull dhe mikpritjen shqiptare si një traditë të moçme. Edhe vetë titulli i tregimit ka një thënie të njohur të mikpritjes tradicionale shqiptare "Bukë, kripë e zemër! "

Pyetje

Si ju duket pritja që gruaja ua bëri luftëtarëve të lirisë?

Përse Gjergj Kastrioti – Skënderbeu nuk tregoi që në fillim se ishte ai?

Po për reagimin e gruas kur mësoi se aty ishte Skënderbeu, çfarë mendoni?

Detyrë

Mësoni ta ritregoni këtë rrëfim, me gjuhën shqipe të cilën e flisni në shtëpi dhe në shkollë.



Pak fjalë për shkrimtarin

Mark GURAKUQI (1922-1977) lindi në Pogradec dhe vdiq në Tiranë. Mësimet e para i mori në vendlindje, të mesmen e kreu në Elbasan, kurse studimet për letërsi në Universitetin e Sofjes në Bullgari. Shkroi për fëmijë dhe për të rritur, por u mor edhe me studimin e letërsisë. Disa nga veprat e tij letrare janë: Miniera nuk u mbyll (1951), Këngë për jetën (1951), Pranverë (1953), Këngë për dashurinë (1957), Në udhët e jetës (1960), Në gjurmët e viteve (1964), Porosia e fundit e Gjergj Kastriotit (1967), Gjurmë të padukshme (1972) etj.

BIJT E SHQIPES

Shqipëri, lejomë të kthej syt' e mi
Mbi ty, o nënë e rreptë burrash të ashpër! ...

Të rreptë bijt' e Shqipes! ...
Armiku ua pa kurrizin ndonjë herë?
Kush e duron si ata mundimin e luftës?
Shkëmbinjtë e tyre s'janë më të patundur
Nga ata në çast rreziku dhe nevojë.

Ç'armiq për vdekje, po sa miq besnikë!
Kur besa e nderi i thërret të derdhin gjakun,
Si trima turren ku t'i çojë i pari i tyre...

Haroldi i pa në kullë të Ali Pashës;
E pritën në shtëpi me gjithë të mirat...

Pa lajka. Ndezën zjarr, u thanë rrobat;
Pa ndezën llambën, mbushën plloskën,
Dhe shtruan sofrën, me atë që patën;
Kësaj i thonë dashuri njerzore.

Flaka se ç'u ndrin faqen kur kërcejnë
E derdhin trupin, syt'e zez shkëlqejnë,
Flokët e gjatë u derdhen gjer te supet,
Dhe tok ia thonë me të thirrur kësaj kënge.

"Tamburxhi! Tamburxhi! " thirrja jote ushton
U ngjall trimave shpresën! Për luftë na fton,
Gjithë djemt e malsisë i thërret anembanë:
Himariotët, ilirët, suliotët zeshkanë!

BAJRONI

Fjalorth

plloskën – enën e rrumbullakët të drurit për ujë dhe për verë

tamburxhi – njeri që i bie tamburës, daullës së vogël

Bisedojmë për poezinë

Këto vargje janë shkëputur nga libri "Çajld Herold" i poetit anglez G.G. Bajron. Ai, në udhëtimin e tij nëpër Ballkan, qëndroi edhe në Shqipëri, nga ku përjetësoi në vargje përshtypjet e veta. Përveç shkrimeve të shkrimtarëve tanë, janë shumë me rëndësi edhe shkrimet që bënë të tjerët për ne. Vargjet e Bajronit për shqiptarët dhe Shqipërinë, përveçse kanë rëndësinë e tyre si vargje të një poeti të madh, ato shprehin me shumë dashamirësi jetën e shqiptarëve në atë kohë. Si të tilla, këto vargje kanë ngelur të dashura dhe të respektuara për lexuesin dhe përgjithësisht për popullin shqiptar.

Pyetje

Me ç'fjalë i drejtohet poeti Shqipërisë?

Çfarë thotë ai për shqiptarët, apo për "bijtë e shqipes", siç i quan?

Si shkruan se u prit Haroldi në kullën e Ali Pashës?

Ç'kuptim ka kënga "Tamburxhi, tamburxhi! ..."?

Si përputhet imazhi të cilin Bajroni e ka prej shqiptarëve me imazhin e sotëm të shqiptarëve atje ku jeton ti? Shpjego dallimet!

Detyrë


Kërkoni në internet të gjeni diç për Bajronin (Lord Byron, dhe për librin e tij "Childe Harold's Pilgrimage", si dhe për librat e tjerë të tij); bëni një përmbledhje apo përgatitni një referat të shkurtër.

Pak fjalë për shkrimtarin - Xhorxh Gordon BAJRON (1788-1824) lindi në Londër, ndërsa vdiq në Greqi, i sëmurë nga ethet, në moshën 36-vjeçare, në kulmin e pjekurisë dhe të krijimtarisë. Që në moshën trevjeçare mbetet pa babanë. Deri në moshën dhjetëvjeçare ai bashkë me të ëmën jetoi në qytetin e vogël Alberdin, ku njohu për së afërmi natyrën e ashpër të Skocicë dhe legjendat e malësorëve të këtij vendi, të cilat patën ndikim në frymëzimet e tij. Studioi gjuhën dhe letërsinë klasike



Thomas Phillips: Bajroni
në kostume shqiptare

greke e latine dhe historinë e antikitetit dhe të vendeve të Lindjes. Lexoi me pasion shkrimtarët e mëdhenj anglezë e francezë. Ishte në konflikt me aristokracinë e kohës, prandaj në vitin 1809 bashkë me një mikun e tij nisën udhëtimin e tyre të njohur drejt Orientit. Në këtë udhëtim ai vizitoi edhe Shqipërinë. Nga ky udhëtim shkroi poemën e tij të njohur "Çajld Harold", të cilën nis ta shkruante në sarajet e Ali Pashë Tepelenës. Botoi vëllimet me poema "Orët e prehjes" (1807), "Gjauri", "Nusja e Abidos", "Korsari", "Lara", "Parisina", "Rrethimi i Korinthis" etj.



SKËNDERBEU U FLET USHTARËVE

Kapedanë dhe ushtarë trima!

Asgjë të re as të papritur nuk shoh këtu, që të mos ma ndiente më parë zemra dhe të mos më mbushte me shpresë, sa herë sillja ndër mend, tërë mall, edhe bujarinë e popullit, edhe shërbimet e veçanta dhe zyrtare tuaja ndaj babait tim, Gjonit. Dhe me të vërtetë, mos ma merrni për mburrje, por unë s'kam dyshuar kurrë, në asnjë çast të jetës sime, se, kur ruaja në zemër këtë qëllim, këtë dashuri për atdhe, kur ushqeja këto ndjenja për liri, këto dëshira të miat që s'më ndaheshin, ishin dhe tuajat.

Kur ju më ftonit shpesh, në kohën që isha pranë tiranit, me tërë dashurinë dhe gatishmërinë tuaj për këtë vepër, gjë që unë tani e kujtoj me kënaqësi dhe e them me mburrje, ju shkonte ndoshta në mend se e kisha harruar atdheun, se e kisha harruar nderin tim dhe lirinë, meqë ju ktheja prapë në shtëpi të pikëlluar, pa asnjë shpresë të sigurt, pa asnjë shenjë të qartë të qëllimit tim. Po s'kam dyshim, qytetarë, se me atë heshtjen time, me atë përlësi të shtirë, unë mendoja për vete dhe për ju, sepse punët ishin të atilla, që duheshin më tepër bërë se sa thënë.

Ju epirotët, mund të gjeni një tjetër mbrojtës të lirisë, një tjetër përkryes të qëllimeve dhe të ëndërrave tuaja, sepse në këtë vend s'kanë munguar mendjet e ndritura. Po juve ju pëlqeu që këtë liri ta pritnit më mirë nga unë, qoftë edhe vonë, sesa nga të tjerë, ose të fitonit vetë me dorën tuaj. Ju, si burra aq të fortë, të rritur në liri, që qëndruat kaq kohë në mynxyrën barbare, nuk u mërzitët derisa të më shihnit. Por, përse doni që unë ta mbaj për vete me të padrejtë emrin e çlirimtarit?

Lirinë nuk ua solla unë, po e gjeta këtu. Sapo më shkeli këmba në truallin tuaj, sapo dëgjuat emrin tim, m'u derdhët me vrap të gjithë, më dolët përpara kush e kush më parë, sikur të kishit dëgjuar se u ngritën nga varret etërit, vëllezërit, bijtë tuaj. Ju më mbytët me shërbime aq të mëdha dhe me një gaz shpirtëror aq të madh, saqë duket se ju më keni bërë tani aq rob, sa edhe të lirë. Mbretërinë dhe këtë qytet nuk jua dhashë unë, po ju ma dorëzuat mua. Armët nuk jua solla unë, po ju gjeta të armatosur. Lirinë e pashë se e keni kudo. Në kraharor, në ballë, në

shpatat e në ushtat tuaja. Përpara tani, për të shtënë në dorë edhe çka mbetet. Pjesën më të madhe të punës e kemi mbaruar. Kruja është fituar, krahina e gjithë është jona. Dibra dhe pastaj popullsitë e tjera janë bashkuar me ne dhe emri i armiqve është zhdukur nga fushat. Mbeten qytetet. Po të mendoj gjendjen e tyre të vështirë, duke parë se të gjitha janë të rrethuara nga ne, të zëna në befasi, se të rrethuarve u kanë mbetur vetëm muret e zhveshura, kam shpresa të mira. Po të marr parasysh vështirësitë që paraqitin këto vende dhe trupat që janë vendosur brenda nga tirani, duket se do të jetë nevoja të përdorim ndonjë zgjuarsis ose këmbëngulje shumë të madhe. Por këto do t'i gjykojmë më mirë kur të ndodhemi në vend e të kemi përpara armikun e kur të mbajmë shpatën në këtë të djathtë tonë shkumbuese, sesa tani për së largu e në tym. Të nisemi, pra, pa ngurim dhe kudo të tregohemi me guxim prej fitimtarësh.

Marin BARLETI

Fjalorth

mynxyrë, a – e keqe e madhe, fatkeqësi

Bisedojmë për tekstin

Ky është fjalimi i Skënderbeut që e mbajti para popullit të tubuar me rastin e kthimit të tij në Krujë, i shkëputur nga libri "Histori e Skënderbeut" e Marin Barletit.

Detyrë

Gjeni DVD-në dhe shikojeni filmin për Skënderbeun. Diskutoni për domethënien apo rëndësinë që ka Skënderbeu për shqiptarët në ditët e sotme.



Pak fjalë për shkrimtarin

Marin BARLETI (1460-1513) lindi në Shkodër, në kohën e sundimit të venedikasve. Gjatë rrethimit të dytë të Shkodrës (1478) nga ushtritë turke, Marin Barleti mori pjesë aktive në mbrojtjen e saj. Venedikasin ua dorëzoi Shkodrën turqve. Marin Barleti bashkë me shumë shqiptarë mërgon në Itali. Atje jetoj në Venedik dhe në Romë, ku u njoh me lëvizjen e Rilindjes evropiane. Atdheu vazhdoi të jetojë në kujtimet dhe në shpirtin e tij, ndaj ai iu përkushtua shkrimit të historisë së tij, të luftës kundër turqve, duke filluar nga rrethimi i Shkodrës e deri te luftërat e Skënderbeut. Kështu krijoi veprat monumentale të shkruara në gjuhën latine, si "Rrethimi i Shkodrës" (Venedik, 1501), "Historia e Skënderbeut" (1508-1510) etj.



MALLI I ATDHEUT

Kur vete njeriu, i lirë e i vetëm, larg atdheut – viset e ra, ndryshimi i zakoneve, ëmbëlsia e udhëtimit e një mijë gjëra që vihen re ndër popuj të huaj, të gjitha këto ta përgëzojnë zemrën e të bëjnë jo të harrosh Shqipërinë, po të mos të vejë tek ajo aq dendur mendja.

Më tutje, si ngopen sytë së pari ndryshime, gazi shuhet pak nga pak. S'di ç'të mungon, s'di se ç'të duhet. Nji hije trishtimi ta mbulon fytyrën; e, pikë së pari herë-herë mbasandaj më dendur e më në fund shpesh e pothuaj kurdo e kudo, kujtimi i prindërve, i miqëve e i shokëve, kujtimi i dheut ku u lindëm dhe u rritëm, ku qajtëm foshnja e ku lozëm djelmë, kujtimi i atyre maleve larg të cilave nuk rron dot mirë një shqiptar, kujtimi i kombit, që, megjithë ca të liga që ka, është kombi ynë e më tepër kujtimi e dëshira e etja e gjuhës sonë - ta shtërngojnë e ta dërmojnë me të vërtet zemrën.

Ah, malli i Shqipërisë, malli i atdheut të dashur, i shenjtë mall e dashuri e shenjtë, kush është ai shqiptar që s'e ka pasur në dhe të huaj! Duhet të jesh jashtë Shqipërisë, e të jesh larg, për të kuptuar se ç'forcë e ç'bukuri të ëmbël ka për veshët kjo fjalë: Shqipëri! Ajo më e zbrazura letër, ajo fjala më e vogël na sjell, kur vjen nga Shqipëria, nji gaz të pa rrëfyeshëm, se na sjell si një copë të atdheut...

Faik KONICA

Fjalorth

të ra – të reja

dendur - shpesh

Bisedojmë për tekstin

Ky tekst i shkurtër është një ese për atdheun, për lidhjen që krijon njeriu për të dhe për mallin që do të ketë në rast të largimit nga ai. Këtë ndjenjë na ka rënë ta ndiejmë edhe te rilindësit tanë. Mjafton të kemi lexuar poezi të Naimit, Çajupit, Filip Shirokës, Vaso Pashës e të tjerëve dhe të bashkëndiejmë mallin dhe dhimbjen e tyre. Shkrimtari dhe intelektual ynë i madh Faik Konica e shpreh bukur këtë ndjenjë në pak radhë tekst, nga përvoja e vet, që e jep si ndjenjë dhe përvojë të secilit që do të jetë gjendur, që gjendet apo që do të gjendet në atë pozitë.

Pyetje

Cila është pjesa kulmore e këtij teksti?

Po fjalë kyçe, cila është?

Çfarë ndiejmë kur lëmë vendin dhe, pavarësisht për çfarë arsyeje, shkojmë në një vend tjetër? Diskutoni këtë edhe me prindërit apo gjyshërit tuaj!

Po kur kalojmë një kohë në atë vend, çfarë ndiejmë? Si e përjetoni ju situatën tuaj jashtë atdheut?

Si mund t'ia dimë më së miri vlerat dhe bukuritë atdheut, vendlindjes?

Detyrë

Shkruani një ese për ndjenjat që i keni a) për vendlindjen tuaj (apo të prindërve tuaj), dhe b) për vendin ku jetoni tani!



Pak fjalë për shkrimtarin

Faik KONICA (1875-1942) lindi në Konicë, qytezë rrëzë maleve të Pindit. Në Bruksel dhe në Londër botoi gazetën Albania. Ishte kryetar i Shoqërisë Vatra dhe ka drejtuar gazetën Dielli. Ishte ambasador i Shqipërisë në SHBA. U mor me probleme të gjuhës, me letërsi, publicistikë, përkthime, kritikë letrare dhe konsiderohet si njëri ndër stilistët më të mëdhenj shqiptar. Vepra të tij të rëndësishme janë: "Shqipëria-kopsht shkëmbor i Evropës Juglindore", "Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurasit" etj.



BUKURIA E TANUSHËS

(Fragment)

Dheu m'ka mlue fat s'i qita vedit,
po s'e mora Tanushën e kralit!
E unë Tanushën vet' e kam pa:
Gja ma t'mirë s'sheh njeri nën këtë diell!
Vetulla e saj e drejtë si fiskaja;
shtegu i ballit, si shtegu i malit,
kur merr hana me prendue;
syni i saj si kokrra e qershisë;
e qerpikun si krahun e dallëndyshes;
fytira e saj si kuqet molla n'degë;
hunda e drejt-o si kalemi i Tushës;
goja e vogël si lulja që shpërthen;
dhambët e bardhë si gurëzit e lumit,
fill mbas shiut, kur po shndrit dielli;
qafa e saj si qafa e pëllumbit;
shtati i saj posi shtat çetinë;
mishi i dorës posi rremi i shemshirit...

Fjalorth

kral, i – mbret sllav
fiskajë, a - bisk i ri, thupër e hollë, filiz
kalem, i - laps
çetinë, a - pishë e zezë

Bisedojmë për vargjet

Këto vargje janë shkëputur nga kënga e njohur kreshnike "Martesa e Halilit", e cila është ndër më të bukurat në ciklin e këngëve të kreshnikëve. Shquhet për përshkrimin e bukurisë së Tanushës, për çka përdoret dendur krahasimi si figurë letrare.

Pyetje

Si e përshkruan këngëtari bukurinë e Tanushës?

Detyrë

Me çka e krahason këngëtari bukurinë e Tanushës? Nënvizoni krahasimin si figurë letrare që përdoret në këtë tekst.
Gjeni dhe lexoni këngën të plotë.

Këngët e kreshnikëve janë krijimet më të vjetra dhe më të bukura të letërsisë gojore shqiptare. Ato ndryshe quhen edhe Eposi i Mujit dhe Halilit, meqë pjesa më e madhe e tyre pasqyrojnë bëmat e këtyre dy heronjve. Temë kryesore e tyre është lufta për mbrojtjen e trojeve nga të huajt dhe lufta për mbrojtjen e nderit dhe të dinjitetit personal dhe familjar.

Këto këngë këndohen rëndom të shoqëruara me lahutë. Kanë përshkrime të bukura dhe, në përgjithësi, i shquan një ligjërim i bukur poetik.



PSALMI I KANGËS PËR ATDHEUN

Kori i burrave u mbledh me nguti më një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë (1878) në Prizren dhe përpara përfaqësuesve të zgjedhun të të gjitha vendeve shqiptare këndoi, për herë të parë, pas më shumë shekujsh harrese të shenjtën Kangë mbi kangët për Atdheun. Jehona e saj shkoi e u përçoll nga salla në rrugë, rruga ia tha rrugës tjetër e rruga tjetër fushës përtej Prizrenit e fusha përtej Prizrenit në Shkodër, e përtej Shkodrës, në Durrës, e përtej Durrësit, në Vlonë, e përtej Vlonës, në Dibër e përtej Dibrës në Shkup e përtej Shkupit në Kosovë e fushave të tjera e maleve përreth e malet fushave e fushat lumenjve e lumenjtë Detit dhe ajo u dëgjua gjithkund... Prandaj po e jap ashtu, ngapak të tretun ndër jehet e ndonjëherë edhe (mundet) të ndryshueme, mirëpo nuk ka asnjë dyshim që kjo asht besnike dhe kështu ka qenë.

Qe Psalmi i Kangës për Atdheu:

Atdheu

O i shtrenjti Atdhe hirploti, Nana e përmëshirshme,
Ti neve nga anmiku na ruej, e n'ditë të mortjes sonë na prano.

Lavdi ty t'qoftë: ti le në gjak të Dëshmorëve.
Me na qitë përpara lirinë
Je përherë i bekuem o Atdhe, e me lirinë e shenjtë për jetë të jetës.

Lavdi i qoftë Atdheut!

Atdheu tha: fushat janë fushat e mia,
Lemenjtë janë lumenjtë e mi,
Pyjet janë pyjet e mia,
Krejt çka janë të miat, janë të tuat!

Atdheu tha: Shpëtom dhe kam me t'i mblue me të mira dhe fëmijët e tu e pasardhësit e tene.

Kam me të shumue si ranën në det
Që nuk mundesh me e numrue prej shumësisë.

*

Atdheu tha: Nëse i takon Atdheut:
Për gjakun tand,
Për jetën tande,
Për jetën tande njerëzore
Kërkoj llogari për ty.

Në punofsh për Atdheun do të shkëlqejsh nga lumtunia,
Në punofsh kundër dënimi të rri si egërsinë në derë: Ty të ruan!
Në e tradhtofsh Atdheun,
Ti tokën e tij mundesh me e punue
Po ai s'ta jep ma frytin e vet!

(Fragment nga libri "Jusufi")

Zejnullah RRAHMANI

Bisedojmë për tekstin

Është një tekst i fuqishëm për dashurinë ndaj atdheut. Dhe jo vetëm për dashurinë, por edhe për kuptimin e tij, për besnikërinë ndaj tij. Është shkruar në vargje, në dialektin gegë, që duket një gjuhë e moçme shqipe, e moçme aq sa është i moçëm edhe vetë atdheu dhe dashuria e njeriut për të.

Pyetje

Çfarë ka ndodhur në vitin 1878, kur shkrimtari thotë se u këndua “Kënga mbi këngët për Atdheun”?

Para kujt e këndoi kori i burrave këtë këngë?

Si dhe kah përhapet zëri i këtij kori?

Prej nga ka lindur Atdheu, sipas këtyre vargjeve?

Çka thotë Atdheu në këto vargje dhe kujt i drejtohet ai?

Çfarë mund të të ndodhë nëse punon për Atdheun? Po nëse e tradhton atë, çka mund të të ndodhë?

Çfarë figurash përdor poeti në vargun e parë të këngës për Atdheun?

Detyrë

Shkruani një ese në temën “Vendlindja” dhe lexojeni në klasë!



Pak fjalë për shkrimtarin

Zejnullah RRAHMANI lindi më 1952 në fshati Ballofc, ku kreu edhe shkollën fillore. Gjimnazin e kreu në Besianë, kurse studimet universitare dhe pasuniversitare në fushë të letërsisë i mbaroi në Prishtinë. Punoi një kohë në gazetën “Rilindja” dhe në revistën “Fjala”, kurse më vonë u bë ligjërues në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Shkruan prozë, romane e tregime dhe merret me studimin e letërsisë. Në veprat e tij trajton kryekëput temën kombëtare. Veprat e tij

më njohura letare janë “Zanoret e humbura”, “Sheshi i unazës”, “Udhëtim arbdhetar”, “Romani për Kosovën”, “Jusufi”, “Mjeshtri i vetmisë”. Është autor edhe i disa teksteve universitare për letërsinë etj.

FYTYRA E ASAJ

Si vajza ime e bukur s'ka asnjë:
E prerë, e holl' si kumbull, drejt më rri:
Kur ecën, shkon si zogë e mbase më
Zërin e saj e ngre plot harmoni.

I ndan flokët në mes dhe rrethas vë
Gërshetin që i shkëlqen krejt në të zi,
I feks balli që rreze drite zë
Si gryka e detit n'agim'n e ri.

Të zes e tërë mënd e mall të thellë,
Sytë e saja shkëlqejnë më se hënë,
Në mes të faqes i qesh hunda e hollë.

Ka buzët si merxhan, është faqemollë,
Dorën dhe zverkun si alabastër vënë
Edhe, kur qesh, sikur të ngre në Qiellë.

Zef SEREMBE

Fjalorth

gërshet – tufë flokësh të thurur si bisht, bishtalec

i feks – i shndrit

mënd – mend

më se hënë – më shumë se hënë

Bisedojmë për poezinë

Kjo është njëra nga lirikat më të bukura të Serembes për dashurinë. Për përshkrimin e të dashurës së tij, ai zgjedh fjalët dhe figurat më të bukura.

Për nga struktura strofike, poezia i takon sonetit. Soneti, që ndryshe quhet edhe tingëllimë, është poezia që përbëhet nga katër strofa, nga të cilat dy të parat janë me nga katër vargje, kurse dy strofat e tjera me nga tri vargje.

Në poezinë tonë sonete kanë shkruar Ndre Mjeda, Enver Gjerqeku, Beqir Musliu, Hasan Hasani etj.

Pyetje

Si e përshkruan poeti vajzën që e do?
Çfarë vëren të veçantë tek ajo?
Çfarë janë sytë e saj dhe si shkëlqejnë ata?
Po buzët e ballin si i ka?

Detyrë

Shkruani një ese për këtë poezi!

Gjeni edhe vjersha të tjera të Zef Serembes dhe bisedoni në klasë me mësuesin/sen për to dhe për jetën e poetit.



Pak fjalë për shkrimtarin

Zef SEREMBE (1843-1901) lindi në fshatin Kozmo të arbëreshëve të krahinës së Kozencës dhe vdiq në Sao Paolo (Brazil). U shkollua në Kolegjin arbëresh të Shën Adrianit, ku mësues pati Jeronim de Radën, me të cilin u bë mik i ngushtë. Me krijimtari letrare u mor qysh si nxënës dhe një ndikim pati edhe Jeronim de Rada me veprat e tij. Ishte shëndetling dhe kaloi jetë të vështirë. I etur për dituri, dashuri e lumturi, u bë poet endacak. I eci këmbë gjithë fshatrat e Sicilisë dhe të Kalabrisë, ku jetonin arbëreshët. Vjershat e tij edhe i këndonte. Pati një dashuri të pafat. Vajza të cilën e done, kishte emigruar me familjen në Brazil, ku edhe kishte vdekur. Serembe shkon ta vizitojë varrin e së dashurës në Brazil. Gjatë kthimit, në Spanjë, humb shumë dorëshkrime që i kishte me vete. Udhëtoi këmbë nëpër Spanjë, Francë dhe Itali. Kthehet në vendlindje, por nuk gjen prehje dhe niset prapë për në Amerikën Jugore. Më 1897 gjurmët i gjenden në Buenos-Aires të Argjentinës. Thuhet se vdes në një gjendje afër çmendisë. Nipi i tij Kozmo Serembi i mbledhi poezitë e tij dhe i botoi me titullin "Vjersha".



DITA E FLAMURIT

E duam flamurin e kuq me shkabën e zezë me dy krerë, se është flamuri ynë, se nën të do të rrojmë të lirë, të nderuar dhe kryelartë në mes të kombeve të qytetruara të Evropës.

E nderojmë flamurin e kuq me shkabën e zezë me dy krerë, se është flamuri i kurorëzuar me nder e me lavdi i kryeushtarit dhe luanit të shkëlqyer që çuditi botën me trimërit' e tij duke thyer njëzet e pesë vjet me radhë njëren pas tjetrës ushtritë më të forta të asaj kohe, të kryesuera prej sulltanëve më të mëdhenj të Turqisë. Kur Evropa dridhej nga mizëritë Otomane, dragoi shqiptar, që s'dinte ç'është frika, me një grusht trimash të zgjedhur, vërvitej mbi armikun si rrufe që tundte malet dhe shkëmbinjtë dhe u jpte arratinë kulçedrave asiatike me atë shpatën e tij të rëndë që vetërinte dhe tmerronte nën atë flamur të kuq me shkabën e zezë me dy krerë.

E ngremë lart flamurin e madh të Skënderbeut, se ai që e mbajti i thirri tërë botës me trumbetë ç'është i zoti të bëjë shqiptari kur bashkon trimërinë me besën, me nderin dhe me dashurinë e vendit të tij. Papa, kryetar i Krishtëritimit në Perëndim, Republika e Venedikut, Mbretëresha e deteve, dhe të gjithë mbretërit dhe princërit e Evropës, në kohën e Skënderbeut, e përshëndoshën flamurin tonë me bekime, pagëzime dhe lavdërime.

E qanë kur u ul për katërqind e pesëdhjetë vjet, se Shqipëria u shua nga lista e shteteve të lira dhe varfëria, mjerimi dhe robëria, e shtypën dhe e vogëluan në sytë e botës.

Po kur u ngrit dhe valoi përsëri në Vlorë dhe u sallutua në Durrës me gjëmime topash prej anijeve të fuqishme evropiane, kockat e shenjtura të Skënderbeut u drithruan në varr dhe ne, kur e pamë si në ëndërr, derdhëm lot mallëngjimi, gazi, shprese dhe kryelartësie kombëtare.

E kujtojmë këtë ditë historike, dhe e kremtojmë, se mësuam ç'do me thënë flamuri i huaj, shpatë, kamxhik dhe zjarr armiku; fshatra të djegura; ara të shkretuara; pleq, gra, fëmijë të therrur pa mëshirë a të arratisur në shpella e përrenj, të çveshur, të zbathur, pa bukë, të rrahur prej së ftohtës, të çjerrur prej urisë, të shtrydhur prej sëmundjeve, me syrin të errur prej helmit dhe dëshprimi. Nga goja e kësaj ushtrie dëshmorësh të pafajshëm të barbarisë dhe të pashpirtërisë së armiqëve të pabesë në Shqipërinë e shkretuar dhe nga zemra e të gjithë shqiptarëve të mërguar e të shpërndarë si zogjtë e korbit në vise të huaja, ngrihet sot një lutje e nxehtë, e mëshirëshme, e mallëngjyer përpara fronit të Perëndisë:

O zot i madh, i drejtë dhe i dhembshuruar, shpëtoje popullin dhe vendin tonë të mjerë dhe nderoje përsëri me liri nën flamurin tonë, flamurin e Skënderbeut, flamurin e kuq me shkabën e zezë me dy krerë.

Fan S. NOLI

Fjalorth

shkabë, a – shqiponjë
mizëritë otomane – këtu: ushtarët e shumë otoman

Bisedojmë për tekstin

Këtu kemi një ese të Fan Nolit për flamurin tonë kombëtar, për historinë e tij, e bashkë me të edhe për historinë e popullit shqiptar. E shquan një njohje e thellë e historisë dhe e rrethanave nëpër të cilat kaloi populli shqiptar gjatë shekujve. E shquan, po ashtu, stili i lartë dhe i qartë i mendimit, çfarë mund ta kishin pak kolosë të kulturës sonë kombëtare si Noli, Konica e të tjerë.

Pyetje

Çfarë di për flamurin kombëtar shqiptar; si duket ai dhe nga cila kohë ka këtë pamje?

Edhe kush tjetër, përveç nesh, e nderoi dhe bekoi flamurin tonë kombëtar?

Ç'bënë ata kur ky flamur u ul gjatë shekujve të sundimit osman?

Ç'domethënie kishte për shqiptarët flamuri i huaj?

Cila është lutja që shqiptarët në trojet e veta ia drejtojnë Perëndisë lidhur me flamurin?

Detyrë

Bisedoni në klasë me mësuesen/sin për historikun e flamurit shqiptar!

Cilën vlerë simbolike mund ta ketë flamuri shqiptar sot për grupe të ndryshme shqiptarësh/esh (në atdhe, jashtë atdheut, për të moshuarit, për të rinj/të reja etj.). Diskutoni në grupe dhe shënoni rezultatet tuaja ose në një tekst ose si tabelë.



Pak fjalë për shkrimtarin

Fan Stilian NOLI (1882-1965) lindi në Qytezë (Ibrik Tepe) të Turqisë, ndërsa vdiq në Fort Lauderdale të Floridës në SHBA. Ai është poet, përkthyes, historian, muzikolog, publicist, burrë shteti, orator, prift e atdhetar i madh. Mësimet e mesme i kreu në Edrenë dhe u laurua për filozofi në Universitetin e Harvardit në Boston Mass, si dhe për muzikë në konservatorin e Nju Englandit. Është njëri nga themeluesit e gazetës Dielli dhe i Federatës "Vatra", udhëheqës i lëvizjes patriotike në mes të shqiptarëve në SHBA, kryeministër i qeverisë demokratike që doli nga Revolucioni i Qershorit të vitit 1924. Noli shkroi veprat "Israelitë dhe Filistinë" (1907, Boston), "Historia e Skënderbut" (1921, Boston), "Mallë e brengë"

(1943, Tiranë, Ligjëron Fan S. Noli (1944, Tiranë), "Bethoveni dhe Revolucioni freng" (1947, Boston), "Albumi" (1948, Boston) etj. Fan Noli ishte edhe përkthyes i shkëlqyeshëm i veprave të shumë shkrimtarëve të njohur botërorë si Shekspiri, Servantesi, Ibseni, Khajami etj.



28 NËNTORI

Bien telat, venë e vinë
 Po na tundin Shqipërinë,
 Toskërinë, Gegërinë,
 Në çdo vend, në çdo krahinë
 Që në Shkodër në Janinë,
 Që në Vlorë e në Prishtinë.
 Opopo! Ç'fitoi lirinë!
 Opopo! Ç'u ngrit rrëmeti!
 Se ç'u tund si valë deti,
 Po si det që vjen me valë,
 Po vjen rëndë e me ngadalë
 E po ndjek Smail Qemalë.
 Ismail burri i shpie në Vlorë,
 Me flamur të kuq në dorë,
 Me flamurin e lirisë,
 M'u në thelb të Shqipërisë!
 Shqipëri, moj Shqipëri,
 Hidhe larg atë shami,
 Që të treti në të zi,
 Në vajtim e në robëri!
 Se që sot e paskëtaj
 Më s'ke breng' e më s'ke vaj
 Se që sot e kësaj dite,

Ti m'u ndrite e vetëtite,
 Posi yll me rreze drite!
 Se që sot e që tashti
 Po të ndrinë një yll i ri,
 Mu në zemr' e mu në gji!
 Pa ke nder e madhëri!
 Ke gëzim e lumturi!
 Ke flamur të kuq, të zi!
 Ke liri! Liri! Liri!
 Rrofsh, e lira Shqipëri!
 Rroftë! – tha Smail Qemali,
 Me zërin si zanë mali.
 Rroftë! – iu përgjigj rrëmeti,
 Pa u tund si valë deti.
 Rroftë! – fusha oshëtiu.
 Rroftë! – pylli uturiu.
 Rroftë! – e deti ia buçiti.
 Rroftë! – e pushka ia kërciti.
 E sakaq, një vall' e madhe
 U përhap n'ato luadhe.
 Ishte vall' e dashurisë,
 Në luadhet e lirisë.
 M'u në thelb të Shqipërisë.

Lasgush PORADECI

Fjalorth

rrëmet, i – turmë njerëzish

Bisedojmë për poezinë

Flamuri kombëtar shqiptar ka histori të lashtë, mirëpo si ditë të veten ka 28 nëntorin. Kjo datë është e lidhur me 28 nëntorin e vitit 1912, ditën kur Ismail Qemali ngriti flamurin në Vlorë dhe shpalli pavarësinë e Shqipërisë. Pikërisht kjo ditë, me atmosferën e saj, me gëzimin dhe entuziazmin e popullit, u bë frymëzim edhe për poetin tonë të madh Lasgush Poradeci të na dhurojë këtë poezi-këngë të mrekulleshme.

Pyetje

Cilat troje shqiptare përfshin entuziazmi i popullit sipas kësaj poezie?

Çka e porositi poeti Shqipërinë në këtë ditë të shënuar?

Ç'valle hodhi populli këtë ditë?

Përse kjo poezi përshkohet nga një tonalitet i këngëtimit popullor?

Detyrë

Komentojeni me shkrim këtë poezi!



Pak fjalë për shkrimtarin

Lasgush PORADECI (1889-1987) lindi në Pogradec dhe vdiq në Tiranë. U shkollua në vendlindje, në Manastir, në Athinë. Studimet në Akademinë e Arteve të Bukura i mbaroi në Bukuresht, ndërkaq në Universitetin e Gracit studioi filologjinë romane dhe atë gjermane. Punoi në Korçë dhe në Tiranë. Botoi librat me poezi “Vallja e yjve” (1933) dhe “Ylli i zemrës” (1937).

POEZIA PATRIOTIKE

Thua jse nuk mund të gjendet ndonjë poet shqiptar i periudhës romantike, i cili nuk shkruan poezi romantike. Të gjithë ata fillojnë të shkruajnë me qëllim që të zgjojnë dhe të forcojnë atdhedashurinë, që të forcojnë vetëdijen kombëtare të popullit të vet dhe të gjithë ata shfrytëzojnë poezinë si mjet të luftës kundër pushtuesit. Rëndësia e idealit kombëtar doemos përcakton përparësinë e temës dhe të motiveve në krijimtarinë poetike dhe përsëritjen e saj në format lirike. Është, ndërkaq, jashtëzakonisht i madh numri i vjershave të dobëta, fare të dobëta me këtë përmbajtje. Të bazuara, kryesisht, në temën patriotike apo pseudohistorike – sa i përket përmbajtjes dhe në himnizimin e virtytit etnik – sa i përket disponimit që shprehin, të qëruara shpesh domethëniesh me të përgjithshme, vjershat romantike patriotike, herat më të shpeshta, janë përmbushje e interesave jashtestetike. Me frymën moralizuese dhe didaktike, me patosin emocional, me foljezin dhe retorizmin gjuhësor, ato dikur marrin karakterin e një skeme të përgjithshme, thua jse të domosdoshme për çdo autor. Kjo skemë poetikisht vërtet e thjeshtë – didaktizëm-patetikë-retorizëm – dikur, sidomos në vitet pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, nis të bëhet formulë, që do të zëvendësojë prirjen dhe vlerën. Trimëria, Shqipëria, Pirrua, Aleksandri i Maqedonisë, Gjergj Kastrioti, Marko Boçari, gjuha, shkolla, bëhen rekuizite të shpeshta, gati të përhershme, të vjershës patriotike, që me aq patetikë tipike romantike i përmbledh Loni Logori në vjershën Një sulm për Shqipërinë:

Si s'dëgjohet Shqipëria,
Humbi thellë trimëria?
Humbi far' e trimërisë,
Humbi fam' e Shqipërisë?
Humbi Pirrua, Aleksandri,
cili dhenë tërë hëngri,
Skënderbegu Kastrioti,
ku është Boçar Sulioti? ..
Të marrë, dhe neve dritë,
të na shohën mbretëritë
dhe të mundemi të themi
"Tani vetë zotër jemi"!

Vjersha patriotike, në të vërtetë, bëhet përmbushje psikologjike e romantikëve: bëhet dashuria e tyre, arti i tyre, por edhe ideologjia dhe politika e tyre. Ajo është forma më adekuate kallëzimit të tyre shpirtëror kombëtar, që çliron subjektin lirik dhe pothuajse, të gjitha format e tjera të vetëdijes, e aq më parë vetëdijes estetike, ia nënshtron asaj. Ky orientim i poezisë patriotike shqiptare në mënyrë

të veçantë shquhet pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur çështja e pavarësisë kombëtare ashpërsohet edhe më tepër. Vetëm poetët më të talentuar për poezinë lirike, siç janë Zef Serembe, Naim Frashëri apo, më vonë, Ndre Mjedja shkruajnë vjersha patriotike me vlerë artistike, sado që edhe ata, kur e kur, shkruajnë edhe vjersha të dobëta me këtë përmbajtje.

Rexhep Qosja

Bisedojmë për tekstin

Ky është fragment i një studimi më të gjatë i akademik Rexhep Qosjes për letërsinë shqipe, marrë nga libri "Historia e letërsisë shqipe/Romantizmi I". Bën fjalë për poezinë patriotike, për motivet të cilat i kanë cytur poetët ta shkruajnë atë dhe për vlerat e saj.

Pyetje

Në cilën periudhë janë shkruar më shumë poezi patriotike në letërsinë tonë dhe pse?

Çka u ka prirë poetëve në këtë krijimtari?

Ku qëndron rëndësia e poezisë patriotike për lexuesit e saj/popullin?


Cilët poetë nga tradita jonë letrare shquhen për poezitë e tyre patriotike?

Po nga poetët e sotëm dalloni ndonjërin për poezi të këtilla?

Detyrë

Mësoni përmendsh ndonjë vjershë patriotike të Naim Frashërit!

Kërkoni në internet të dhëna më të shumta për veprën e Rexhep Qosjes dhe bisedoni në klasë për kontributin e tij dhënë letërsisë dhe kulturës shqiptare!



Pak fjalë për shkrimtarin

Rexhep Qosja (1936) ka lindur në Vuthaj (Mal i Zi). Shumë vite punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe ligjërues në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Shkruan prozë, dramë, kritikë letrare, publicistikë dhe është njëri nga historianët më të shquar të letërsisë sonë.

Ka botuar një numër të madh të veprave, si "Episode letrare", "Dialogje me shkrimtarët", "Kritika letrare", "Asdreni – jeta dh vepra", "Historia e letërsisë

shqipe / Romantizmi", "Porosia e madhe", "Vdekja më vjen prej syve të tillë", "Populli i ndaluar", "Çështja shqiptare", "Tronditja e shekullit", "Një dashuri dhe shtatë faje" etj. Disa nga këto vepra janë përkthyer edhe në gjuhë të tjera.



ZËRI I NËNËS

Këtu nuk të ka kush mërzi
Të duan guri e druri
Gjethet bari bjeshka vërrini
Të duan rrugët shtigjet
Lumenjtë gurgullues urat
Zogjtë cicërojnë për ty
Degëve të pemëve
Të duan ajri shiu dielli
Edhe çiftelia edhe fyelli të duan
Të do vendi e kuvendi
Të duan gurët e murit të shtëpisë
Trarët kulmi me strofuj lejlekësh
Eja bir të m'i bësh shpirtit dritë
Se jeta është sa çel e mbyll sytë
E nata është e pafund

Din MEHMETI

Bisedojmë për poezinë

Largimi nga të afërmit ishte përherë i shoqëruar me dhimbje e mall. Këtë e ndien më shumë se çdokush zemra e nënës. Kështu ishte kur ajo të birin e përcillte në mërgim, apo kur ai për shkaqe të ndryshme detyrohej të largohej nga shtëpia. Këtu kemi, pra, zërin e nënës që i flet të birit, një zë plot ndjenja të çiltëra, të shoqëruara me dashuri e mall mall të pashuar.

Pyetje

Çfarë i thotë nëna të birit, kush krejt e do atë?

Përse e fton ajo t'i kthehet i biri?

Çfarë thotë nëna për jetën dhe për natën?

Krahaso përmbajtjen e tregimit me situatën tënde apo me situatën e prindërve të tu ose të të huajve atje ku jeton ti! Çfarë lidhjesh sheh?

Detyrë

Shkruani një ese në temën: Nëna, ç'është ajo për mua?



Pak fjalë për shkrimtarin

Din MEHMETI (1932-2010) lindi në fshatin Gjocaj të Junikut e vdiq në Gjakovë. Shkollën fillore e mbaroi në Junik, normalen në Gjakovë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Beograd. Studimet pasuniversitare i mbaroi në Prishtinë. Punoi në gazetën Rilindja në Prishtinë, profesor në normalen dhe në gjimnazin e Gjakovës dhe një kohë të gjatë profesor i letërsisë në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Gjakovës. Botoi një numër të madh përmbledhjesh poetike për të rritur, si: "Në krahët e shkrepare" (1966), "Rini diellore" (1966), "Dridhjet e dritës" (1969), "Heshtja e kallur" (1972), "Ora" (1974), "Ikje nga vdekja" (1978), "Fanar në furtunë" (1981), "Zogu i diellit" (1982), "Fatin tim nuk e nënshkruaj" (1984), "As në qiell as në tokë" (1988) etj. Din Mehmeti botoi edhe dramën "Agu" (1982) dhe kritika letrare.



DILA E MARISË

E mori gjogu i ëndrrave, i cili, si duhia, e çoi në trok drejt njëfarë vendi të panjohur, në një copë toke në midisdisit të detit. Eu, po kjo ishte njajo toka e çuditshme, për të cilën i kish kallëzuar Delia i Ndreut, i Ndre Delisë. Ç'mos i kish kallëzuar; atje, në atë farë toke të bukur, të cilën e kishte parë kur kish qenë në "ushtrinë e detit", dielli nxen gjithë ditën e lume.

Kurse nata.

Nata s'është natë, si këtu.

- Hëna, sa një kallamoqe e çerepit, del nga deti dhe zbrit tokën midis ujit të njelmët, të cilit s'i dihet skaji.

"A kurrë s'bie shi? "

"Bie, por nuk asht si ky i yni, që t'ban gozhdar! "

"Po thue? "

"Jo, për këta dy sy! Tekembrama, do ta shohësh..."

"Kush... unë? ! "

"Ti."

"Unë? ! "

"Unë e ti."

"Bashkë? ! "

"Pojzi."

"Po a je ti në mend? A s'e ditke hiç se m'kanë dhanë? ! "

"Si s'e ditkam, moj Dilë..."

"Ani edhe ty ta kanë zanë një tjetër! "

Delia i Ndreut, i Ndre Delisë, e kish shikuar drejt në sy, të cilët Dila, prej turpit, i kish paluar. Delia, mbasandej, ia kish kapur krahun dhe ia kish shtrënguar aq fort, sa Dila s'pat duruar pa i thënë:

"Uf, djalë, djalë ...ç'je tu'ba kështu? "

"Mos u tremb, moj Dila e Marisë, mos u tremb! Kish thënë Delia i Ndreut, i Ndre Delisë. "Mos u tremb, ani që deti asht i gjanë e i fellë"! Do të dalim matanë dhe do të mbërrim në tokë në midisdisin e tij.

Dila pa se Delia ish burrë që s'i vetëtonte askja e syrit.

Anton PASHKU

Fjalorth

midisdisi – mesi, pikërisht mesi

pojzi – po a?

Bisedojmë për tregimin

Tregimi "Dila e Marisë" është njëri nga tregimet e fillimeve letrare të Anton Pashkut, i shkurtër, i qartë, mjaft poetik. Në të autori trajton një zakon të shqiptarëve kryesisht të kohëve të shkuara – martesën e të rinjve pa u njohur me njëri-tjetrin, pra pa qenë të simpatizuar apo të dashuruar më parë. Megjithatë, personazhet e këtij tregimi, Dila e Marisë dhe Delia i Ndreut, i Ndre Delisë, duan t'i kalojnë këto vështirësi, të kalojnë edhe "detin e gjerë e të thellë" për të realizuar ëndrrën e dashurisë së tyre dhe për t'ua vënë shqelmin zakoneve prapanike.

Pyetje

Çka i takon personazhet e këtij tregimi dhe ku?

Çka i premton djaloshi vashës; si reagon Dila e Marisë?

Po djaloshi trim, Delia i Ndreut, çfarë i thotë Marisë?

Çka ju pëlqeu me shumë në këtë tregim: dialogu, përshkrimi, situatat... dhe pse?


Detyrë

Provoni ta shfaqni këtë tregim si pjesë teatrale të vogël!



Pak fjalë për shkrimtarin

Anton PASHKU (1937-1995) lindi në fshatin Grazhdanik të Hasit të Thatë. Shkollën fillore dhe pesë klasë të gjimnazit të ulët i kreu në Prizren, kurse klasat e fundit dhe maturën në Prishtinë. Punoi redaktor i kulturës në gazetën Rilindja dhe redaktor po ashtu në Ndërmarrjen Botuese Rilindja. Anton Pashku shkroi prozë për të rritur tregime, romane, drama. Ai botoi librat: "Tregime" (1961), "Një pjesë e lindjes" (1965), "Kulla" (1968), "Sinkopa" (1969), "Oh" (1971), "Kjasina" (1973), "Gof" (1976), "Lutjet e mbrëmjes" (1978) etj.



RRUGA QË SHKELA DIKUR

as kurora t'buta blinsh nuk ka veç gështenja
ca dëllinja anës përroit atje rrëzë mali
nën atë kulm prej kashte vatra pusi e govata
dimrit vjen e tkurret gjithçka duke prit' qershorin
një rrugë e përbaltur me fërkem të thellë qerresh
ndonjë zë i mbyllur një ndërsimë e lehje qeni
a do t'ketë akoma n'arka fshehur pemë të ëmbla
një shami e larme si dhuratë me një grusht lotësh
a do t'ketë akoma një natë dimri rreth një stufe
a do të rrapëllojnë shkallët a do të thonë siç thoshin prore
na u kthye së largu dimri i paska hyrë në eshtra
është atje një rrugë e largët përbri fjalësh të nënës sime

Jusuf GËRVALA

Fjalorth

fërkem, i - gjurmë

Bisedojmë për poezinë

Shkrimtari Jusuf Garvalla është autor i disa librave me poezi, i një drame dhe i një romani. Pra, pjesën më të madhe të krijimtarisë së tij letrare e përbën poezia. Atë e shquan një lirizëm i hollë, tema e motive të lidhura për ambientin e lindjes, për jetën tradicionale, kujtime dhe imazhe të pashlyeshme nga fëmijëria, të jetës në familje, në kullën-fortesë, në fshatin që e ndjek kudo, me të afërmit e njerëzit e dashur, të përvuajtur dhe krenarë. Imazhe të këtilla spikaten edhe në këtë poezi, e cila është një kthim plot mëllëngjim i autorit në fëmijërinë e tij.

Pyetje

Çfarë gjen e nuk gjen poeti në rrugën e tij të fëmijërisë?

Si do të ketë qenë fshati i poetit sipas kësaj poezie?


Po jeta në të?

Si e kuptoni vargun "është atje një rrugë e largët përbri fjalësh të nënës sime"?

Detyrë

Kërkoni në internet ose në biblioteka informacione për Jusuf Gërvallën, përgatitni një prezantim të vogël!

Kërkoni në internet ose në biblioteka vargje të tjera të Jusuf Gërvallës, përgatitni një ose dy poezi për recitim para klasës!



Pak fjalë për shkrimtarin

Jusuf Gërvalla (1945-1982) lindi në fshatin Dubovik të Deçanit dhe vdiq në Shtutgard të Gjermanisë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë, kurse studimet i filloi në Lubllanë e i mbaroi në Prishtinë. Punoi në gazetën "Flaka e vëllazërimit" në Shkup dhe në gazetën "Rilindja" në Prishtinë. Në vitin 1980 emigroi në Gjermani, ku për shkak të veprimtarisë së tij patriotike u vra nga policia serbe më 17 janar 1982 bashkë të vëllanë Bardhoshin dhe bashkëpunëtorin e tij Kadri Zeka. Iu botuan veprat letrare "Fluturojnë e bien" (1975), "Kanjushë e verdhë" (1978), "Shenja të shejta" (1980), "Rrotull" (1983). Shtëpia botuese "Faik Konica" në Prishtinë më 2010 ia botoi komletin e veprave letrare. Përveçse me letërsi, Jusuf Gërvalla u mor edhe me muzikë.



DËSHMI

(Fragment nga tregimi "Baladë për vdekjen e J.G.")

5

Nga dëshmitë për natën e shtatëmbëdhjetë janarit, Zigfrid D., gjerman, banor i Untergruppenbahut, fiqnji i viktimës.

Ora kishte kaluar dhjetën. Megjithëse nata ishte e ftohtë, kisha dalë në ballkon për të marrë ajër të freskët. Rruga përpara shtëpisë sime ishte e shkretë, kështu që dëgjova fare qartë gërvimën shkaktuar prej hapjes së garazhit të J. G, prej nga ai bashkë me dy të tjerë po nxirrnin makinën. Një copë herë u morën me të ngaqë siç dukej rruga kishte zënë akull dhe rrotat rrëshqisnin. Më në fund u futën të tre në makinë, po nuk arritën të nisen? Dikush u afrua nga e djathta dhe qëllloi me breshëri makinën. Pastaj njeriu u largua me vrap. Dy-tri sekonda më pas, ndoshta nga qoshja prej nga ia kishte behur ai, ndoshta nga ndonjë drejtim që nuk e vura re, një tjetër njeri iu afrua makinës, nuk ishte i pari, sepse ndryshonte nga shtati, veç kësaj në vend të armës automatike mbante në dorë diçka të vogël, me siguri revolver ose bombë. Sa mbërriti te makina hapi derën e prasje dhe në çast u tërhoq pas, sepse njëri nga viktimat u rrëzua në këmbë të tij. E kapërceu me këmbë trupin e tij dhe nëpër derën e hapur vështroi një grimë brenda makinës, pastaj u largua me vrap, njëlloj si i pari. Rruga vazhdonte të ishte e boshatisur dhe unë hyra brenda për t'i telefonuar policisë.

Nga dëshmia e Peter S., polic. Kur mbërritëm ne (ora po i afrohej njëmbëdhjetës, në mos gaboj) njëri prej viktimave gjendej ende i rrëzuar përdhe, me fytyrë nga toka. Tjetëri, ai që ishte në timon, dukej menjëherë që kishte ngrirë në vend ashtu siç e kishte zënë çasti i vdekjes. Një grua, e shoqja, me sa dukej qante me kokën rrëzuar në timonin e makinës. I treti, J.G., siç e morëm vesh më pas, vazhdonte të rrinte gjysmë i përkulur te dera e prapme, si njeriu që bëhet gati të zbresë. E shoqja i fërkonte ballin si dhe njërin krah. Flisnin të dy në një gjuhë të

panjohur (shqip, siç e morëm vesh më pas).

Sipas dëshmisë së Karl. L., ndihmësmjek i spitalit të Untergruppenbahut. Makina e ndihmës së shpejtë mbërriti një minutë pas asaj të policisë. Dy nga viktimat kishin vdekur, madje ishin ftohur. I treti J. G. ishte gjallë.

Në kohën që po e ngrinin për ta vendosur në makinë ai tha: "Dua të bëj një deklaratë" gjë që tregonte se ishte në gjendje krejtësisht të ndërgjegjshme.

"Më vonë, thashë unë. Do të keni kohë më vonë".

Ndihej menjëherë që kishte shumë plumba në trup. Gjatë rrugës përsëriti edhe një herë dëshirën për të bërë deklaratë. Siç duket një ide e tillë e lehtësonte.

6

Nga dëshmia e S.G., bashkëshorte e J. G.

Sapo u dëgjuan krismat, kunata thirri e para: "I vranë! " Isha e veshur dhe u sula jashtë pa pritur. Makina ishte disa metra larg hyrjes së garazhit, me faret ende të ndezur. Po unë nuk i hiqja dot sytë nga një gjë e zezë në anën e djathtë të saj. Kur u afrova dhe pak dallova që ishte një trup njeriu i rënë përmbys. Rrëshqita, gati u rrëzova mbi të, gjersa e ktheva mbarë. Ishte K. Z. i vdekur.

Nuk e mbaj mend si u ngrita. Mbjaj mend vetëm që u gjenda te xhami i hapur nga ana e timonit. Ishte kunati i ngujuar në ndenjësë. Duart i kishte hequr nga timoni dhe i mbante mbi gjunjë. Sytë i kishte të mbyllur. Tepër i zbehtë.

I futa duart pas zverkut për t'i kërkuar plagët. S'kishte vdekur. Brenda në makinë ishte gjysmë terr dhe në krye s'dallova kurrë, gjersa ndjeva zërin e J. që tha:

- Çikë, qe ku jam.

Kështu më thërriste zakonisht, "çikë". Zërin e kishte të qetë, të kthjellët. Apo ndoshta m'u duk ashtu prej fjalëve që shqiptoi. Kurse mënyra si qe mbledhur kruspul, me një dorë të mbështetur te shkallina e makinës, jepte, në kundërshtim me zërin, një mendim të madh.

- Oh, - ia bëri kur e preka në shpatulla, - Aty i kam.

Kështu më tha, me siguri për plumbat.

Pastaj:

- Kjo dorë m'u mpi. Ma liro pak!

- J. më ndjen? – e pyeta.

- Në bark kam të tjera, – foli ai.

S'dija si t'ia lehtësoja dhimbjet.

- K. e shoh që ka vdekur, – tha me vështrimin e ngulur nga kufoma në rrugë. – Shife B. te timoni.

- U mata t'i thosha se vëllai ishte gjallë, po në atë çast u ndie kuja e kunatës, që porsa kishte mbërritur.

- Ka vdekur, – tha ai.

- Ndoshta jo.

Që nga larg u ndie një sirenë makine. Duhej të ishte policia ose ndihma e shpejtë.

Ismail KADARE

Bisedojmë për tekstin

Ky tekst i shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare është pjesë e një tregimi më të gjatë me titull "Baladë për vdekjen e J.G.", i cili i kushtohet vrasjes së Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës. Vrasja e këtyre atdhetarëve e veprimtarëve tanë të shquar nuk i shpëtoi as penës së këtij shkrimtari të madh. Në një tregim, të ndarë me numra në disa pjesë apo akte, ai me një mjeshtëri të rrallë bën përshkrimin e detajeve të vrasjes së tyre, ashtu siç është dëshmuar nga dëshmitarët e gjallë.

Pyetje

E kujt ishte dëshmia e parë dhe çfarë thuhet në të?

Po dëshminë e dytë kush e jep?

Çka thuhet në dëshminë e S.G.?

Çka ju ka prekur më së shumti në tregimin e Ismail Kadaresë?

Detyrë

Gjeni, lexoni dhe shkruani një vështrim letrar për tregimin e Ismail Kadaresë "Baladë për vdekjen e J.G."



Pak fjalë për shkrimtarin

Ismail KADARE lindi më 1936 në Gjirokastrë. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Tiranë. Për letërsi u specializua në Institutin e Lartë të Letërsisë "Maksim Gorki" në Moskë. Punoi në redaksi të disa gazetave dhe të revistave, në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, drejtoi revistën që botohej në gjuhën frenge "Les lettres Albanises" në Tiranë dhe shkrimtar i lirë. Në vitin 1991 mori azil në Paris dhe që nga ajo kohë jeton në Paris dhe në Tiranë. Është autor i një numri të madh veprash letrare me poezi, tregime, novela, romane, drama, kritika letrare, studime, udhëpërshkrime, publicistikë etj. Për vlerat e veprës së tij ka disa vite që është kandidat për Çmimin Nobel për letërsi. Disa na veprat e tij janë: "Frymëzime djaloshare", "Princesha Argjiro", "Shekulli im", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Kështjella", "Vjersha dhe poema", "Motive me diell", "Autobiografia e popullit në vargje", "Dimri i madh", "Koncert në fund të dimrit", "Ura me tri harqe", "Darka e gabuar" e shumë e shumë të tjera.

JETA

Jeta është mundësi, pranoje!
Jeta është bukuri, admiroje!
Jeta është lumturi, shijoje!
Jeta është ëndërr, zbatoje!
Jeta është sfidë, ballafaqoje!
Jeta është detyrë, kryeje!
Jeta është lojë, luaje!
Jeta është e çmueshme, nderoje!
Jeta është pasuri, ruaje!
Jeta është dashuri, përjetoje!
Jeta është fshehtësi, zbuloje!
Jeta është premtim, plotësoje!
Jeta është pikëllim, tejkalaje!
Jeta është himn, këndoje!
Jeta është tragjedi, zbuloje!
Jeta është aventurë, zbërtheje!
Jeta është kënaqësi, meritoje!
Jeta është jetë, mbroje!

Gonxhe BOJAXHIU



Bisedojmë për poezinë

Përveç veprave të shumta të bamiësisë, për të cilat u nderua edhe me Çmimin Nobël për paqe, Nënë Tereza u shqua edhe për mesazhet e vlefshme që ia la njerëzimit. Shumë sosh vijnë të artikuluar në formë poezie, gjë që ua shton edhe më shumë vlerën dhe rëndësinë. Poezia "Jeta" përmban në vete më shumë mesazhe të cilat i nevojiten njeriut në jetë.

Pyetje

Çfarë dini për Nënë Terezën?

Çka mendoni për vargjet dhe porositë e Nënë Terezës?

Detyrë

Renditni porositë në poezinë e Nënë Terezës sipas rëndësisë që kanë për ju!

Mund të shtoni edhe ndonjë rresht i cili do të ishte me vlerë të veçantë për ju.



NJË NATË NË STAMBOLL

Nata ka mbuluar me krahët e vet Stambollin. Dritat e shtëpive të qytetit po shuhën njëra pas tjetrës. Në një dhomë, buzë një rrugice të ngushtë, dritat nuk shuhën akoma. Është dhoma e punës e një shqiptari të madh.

Nga dritarja e vogël, drita duket ende. Brenda në dhomë ndodhet rilindësi i madh. I rrethuar nga librat, është ulur në një kolltuk të vjetër dhe shkruan... Nga kalldrëmi i rrugës së ngushtë vazhdon të kumbojë zhurma e hapave të zaptijeve.

Dinjitoz, i heshtur, i vrazhdë, i brengosur nga të therurat e gjunjëve, nga reumatizmi i pashërueshëm, ai vazhdon të shkruajë. Kohë pas kohe e lëshon penën mbi tryezë dhe diku i mbërthen sytë. Ai ëndërron dhe shkruan, shkruan dhe ëndërron.

I mbështjellë në ëndrrën e vet të madhe, ai kaloi dete, male, fusha, bregore dhe arriti atje ku ëndërronte kryeqytetin e Shqipërisë së ardhshme, në Belsh. Qëndroi para liqeneve dhe në pasqyrën e atyre ujërave të kristalta soditi një botë të tërë përmes ëndrrës së vet. Njeriu me mjekër të gjatë e të thinjur para kohe shikonte sytë e mendjes që sot e shikojmë me sytë e ballit. Ai e dinte se ëndrrat e tij s'mund të qëndronin ëndrra: ai e njite fuqinë shpirtërore të popullit shqiptar, zotësinë e tij, legjendare.

Në ato ujëra të kristalta ai soditi Shqipërinë, të lirë, pa shtypës, pa pushtues, pa të ligj. Ai kundroi universitetin ku hynin e dilnin mijëra djem e vajza me libra nën sqetull. Ai aty pa si në pasqyrë minierat nga të cilat rridhnin lumenj naftë dhe sere, ai pa male plot me krom, hekur e nikel. E tërë Shqipëria aty ishte. Dheu u mahnit. Një lot shkau si një rubin nga sytë e tij, çau përmes rrudhave të asaj fytyre, u rrokullis në ujërat e kulluara të liqenit, e një valëz uji e rrethoi atë lot. Ai buzëqeshi. Ndofta pas kaq e kaq vitesh ishte e para buzëqeshje që zbukuronte fytyrën e tij. Një valëz u përplas lehtas në breg dhe me zhurmën e vet ndoshta përshëndeti rilindësin e madh.

U zgjua nga ëndërra, erdhi në vete, fërkoj sytë me duart e veta dhe duart iu qullën. Kishte qarë. Drita e zbehtë e llambës me vajguri vazhdonte të përpëlitej dhe hapat ritmike të rëndë të zaptijeve dëgjoheshin nga jashtë. Ngriti pakëz kokën, hodhi sytë rreth e rrotull dhe i mbërtheu me mallëngjim mbi librat që e rrethonin nga të katër anët. Ndofta desh t'u jepte lamtumirën e fundit. Mori përsëri penën, por pena për herë të parë nuk iu bind dhe i shkau nga dora. E uli kokën mbi libër, po sytë iu veshën, fytyra iu zbeh, mjekra iu drodh.

Pena pret një dorë që të lëvizë, por dora s'leviz më. Dhe boja u tha mbi libër. Vdiq mbi libra, i rrethuar nga libra, si trim në fushën e betejës me armë në dorë.

Nonda BULKA

Fjalorth

shkau – shkoi, kaloi, i ra

Bisedojmë për tekstin


Shkrimtari Nonda Bulka, nëpërmjet këtij teksti, na jep portretin e dijetarit dhe rilindësit të madh shqiptar Sami Frashëri. Samiu ishte vëllai i vogël i personaliteteve të tjera të mëdha të Rilindjes kombëtare shqiptare, Naim Frashërit dhe Abdyl Frashërit. Me këtë rrëfim ai përjetëson çastin e fundit të jetës së dijetarit të madh shqiptar.

Pyetje

Si e përshkruan shkrimtari Sami Frashërin?
Ku e shpie ëndrra Samiun dhe çfarë bëri aty?
Si e pa ai Shqipërinë në atë kthim të vetin të ëndërruar?
Çfarë ndodhi pas ëndrrës që e pa Samiu?

Detyrë

Diskutoni në klasë bashkë me mësuesen/in çfarë dini për Sami Frashërin, çka ka shkruar dhe çka ka punuar ai.



Pak fjalë për shkrimtarin

Nonda BULKA (1906-1972) lindi në fshatin Leusë të Përmetit dhe vdiq në Tiranë. Shkollën fillore dhe liceun i kreu në Korçë, ndërsa studimet e larta i vazhdoi në Francë, ku edhe u diplomua për drejtësi dhe letërsi. Punoi mësimdhënës i gjuhës shqipe dhe frënge. Shkroi vjersha, skica, shkrime satirike etj. Kontribuoi shumë në zhvillimin e humorit dhe satirës në revistën Hosteni, në të cilën punoi një kohë të gjatë. Vepra të tij janë: "Kur qan e qesh bilbili" (1934), "Skica dhe tregime" (1950), "Vargje satirike" (1951), "Maska të çjerra" (1968) etj.



KATËR KËSHILLA VETES

Mos u bëj poet nëse s'mund të lindësh
Me secilin varg, të lindësh me secilën fjalë.

Ngrehu mbi veten në do t'rokësh frerët e erërave,
Të shkelësh shpërgajt e mërisë dhe shtërgatat e gjakut tënd.

N'se dashurohesh, dashurohu n'flakë e n'valë,
Jo në sy të kaltër se bëhesh det i çmendur pendimi.

Mos u bëj poet nëse s'mund të vdesësh
Për secilin varg, të vdesësh për secilën fjalë.

Azem SHKRELI

Fjalorth
n'se - nëse

Bisedojmë për poezinë

Kjo, në të vërtetë, është një poezi për poezinë. Ndryshe quhet edhe metapoezi. Poeti flet për përgjegjësinë për fjalën e shkruar, sidomos për vargnimin poetik, ndaj thotë "mos u bëj poet nëse s'mund të vdesësh / për secilin varg, të vdesësh për secilën fjalë..." Vdekja këtu ka kuptim metaforik, që nënkupton përgjegjësinë e lartë që duhet të ketë poeti për racionalitetin dhe bukurinë e shprehjes poetike. Poeti Azem Shkreli, përveç të tjerash, njihet edhe për këtë cilësi në poezinë e tij.

Pyetje

Përse thotë poeti mos u bëj poet?

Çfarë tjetër porosit poeti? Përmbliidhi porositë e tij në fjalët e tua.

Kujt, në të vërtetë, ia drejton poeti këto porosi dhe pse?

Detyrë

Gjej informata për Azem Shkrelin në libra ose në internet dhe tregoji para klasës!

Provo të gjesh poezi të tjera të Azem Shkrelit dhe përgatit një për recitim para klasës.



Pak fjalë për shkrimtarin

Azem SHKRELI (1935-2007) lindi në Shkrel të Rugovës së Pejës. Aty mori mësimet e para, ndërsa gjimnazin e mbaroi në Pejë. Në Prishtinë kreu fakultetin për gjuhë dhe letërsi shqipe. Është autor i një numri të madh të përmbledhjeve me poezi, si "Bulëzat", "Engjujt e rrugëve", "Nata e papagajve", "Lirikë me shi" etj., si dhe i përmbledhjes me tregime "Sytë Evës" dhe i romanit "Karvani i bardhë". Azem Shkreli shkroi edhe drama dhe u mor edhe me publicistikë.

MOLLË E NDALUEME

Nji tridhjetë vjeçar. I papunë. Qëndron përpara reklamave të kinemasë.... E ditë pune asht. Phe! – I pështyhet nga buzët dhe e sjell kryet prej reklamave. Iu ba se e thërret dikush. Po jo. Askush s’e thërret. Askush nuk ka nevojë për punëtorë. E ky rehat vazhdon punën e përditëshme: shikon reklamat e kinemasë. Phe, këta çojnë jetë! - thotë dhe afrohet për studim ma preciz. Asht filmi i përditshëm: Nji vajzë e bukur e pranë saj një djalë i pashëm. Nji zili në sytë e punëtorit. Nji mnijë ndien për protagonistin. E shikon me sy të keq. Pështynë. Shikon mathen e vet. Nuk din as ai vetë se ç’asht. Inkarnacion i këpucëve: shkarpa. Ulet e njesh shkarpën me spagë dhe tue lëshue një eeeh, merr qëndrimin e drejtë! Ecën nëpër trotuare, u muar vesh. Edhe fare z bathë mund të ecë nëpër trotuare, pse jo.

Lëviz ngadalë, i qetë. Si njeri pa punë. Edhe të tjerët ecin, por jo të qetë – të shqetësuem. Sa mirë asht të jesh i qetë, të ecësh ngadalë si zotni. Por, çka po them? A asht ma mirë të ecësh ngadalë e i qetë? ... Jo edhe po! Po edhe jo! Si të merret. Për një zotni asht mirë të ecë ngadalë se tretet ushqimi, për një punëtor nuk asht mirë të ec ngadalë. Pse? E dini. Por punëtori ynë po ecën gjithnjë ngadalë e me komoditet të plotë, i qetë. Nuk po ia len asgja mangut zotnisë. Ç’t’i bajsh? Kështu e ka kjo kohë... Edhe kjo botë. Dhe po s’deshe të jesh zotni bahe zotni. Punëtori ynë nuk do të jetë zotni as të emitojë zotnitë, por koha... S’ka qejf! Nuk i pëlqen ky soj zotnillëku. Jo se mërzhitet, por... Edhe këtë e dini.

Tan-tan-tan-tan: katër orë mbas dreke! Sa mizorisht therrin miden e punëtorit! Katër orë tingëllojnë nga kambanarja e shenjtë dhe ushtojnë në mide të mallkueme të punëtorit. Katër! Katër! Katër! Gjithkund katër! E pse katër? Pse? Pse katër? Grindje. Kapërthim. Diçka si revoucion. Revolucion në miniaturë. Gjëmon... Topi? Jo! – midja nga uria.

Vazhdon punëtori ynë t’u bjerë pash më pash rrugëve të qytetit. Kërkon punë. Si kolegët e tij në Berlin e në London. Askund një karrocë e ngarkueme që ta shkarkojë ai. Askund udhëtarë me valixhe në dorë që ta ndihmojë. Askund! Askund! S’e do kush djersën e tij. Kurrsesi me fitue një dy-tre lekë.

Ndalet punëtori përpara dyqaneve dhe nëpër xhama shikon. Shikon dhe shijon romantizmin e kohës. Përpara xhamit të një kartolerie: Prapë artistët! Shtërngoi dhëmbët. Nga inati u ngritën grushtet përjetë me një qëllim... Por ligji! Polici! Ia përshkruen trutë. Me përbuzje i len artistët. Pështyen. Vazhdon. Prapë pështyen. Shikon djathtas e majtas dhe pështyen. I unshëm e zhelemel, ecën ngadalë përbri dyqaneve plot me "mollë të ndalueme" (përrallë biblike).

Nji dashje instinktive don të shpallet! Punëtori ynë sundon veten. Ligji! Polici! Për sigurim duert i ven mbrapa. E duert e tij janë të forta, të fuqishme. Edhe dreqin e kishin kapë për fyti dhe e kishin mbytyë. Por, edhe dreqin e mbron ligji.

Tan-tan-tan-tan! Deri kur kështu ma!

MIGJENI

Fjalorth

mnijë - inat

mathen - mbathjen

Bisedojmë për tregimin

Millosh Gjergj Nikolla – Migjeni njihet si poet i mjerimit, ngase ai shumë frymëzime i pati nga jeta e njerëzve me gjendje të vështirë shoqërore në kohën dhe në rrethin e tij jetësor. Kësaj teme ai ia kushtoi një pjesë të madhe të krijimeve të veta edhe në poezi, edhe në prozë. I kësaj teme është edhe tregimi i mësipërm. Bëhet fjalë për punëtorin që i bie cep më cep qytetit duke kërkuar punë për të fituar për kafshatën e bukës. Ai bredh ndër një botë kundërthëniesh të shumta, me pashpresën e pafuqinë e tij.

Pyetje

Si reagon i papuni pranë reklamave të filmit?

Ku qëndron dallimi midis ecjes së të papunit dhe *zotnisë*?

Ku dallon i papuni i këtij tregimi me kolegun e tij në Berlin apo në Londër apo atje ku jeton ti?

Çka e bën të përmbahet të papunin kur sheh romantizmin e kohës, siç thuhet në tregim?

Çka kuptoni me shprehjen *mollë e ndalueme*?

Detyrë

Ritregojeni me shkrim këtë tregim, bëni një përmbledhje!

Tregimi është shkruar në dialektin gegë. Kërkoni dhe shenjoni fjalët dhe format që dallojnë nga gjuha standarde!



Pak fjalë për shkrimtarin

Millosh Gjergj Nikolla – MIGJENI (1911-1938) lindi në Shkodër dhe vdiq në Torre Pelice të Italisë. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa të mesmet në Manastir të Maqedonisë. Një kohë punoi mësues në fshatrat Pukë dhe Vrrakë. Në vitin 1938, i shtyrë nga sëmundja, shkoi në Itali për t'u shëruar nga tuberkulozi. Aty edhe vdiq. Migjeni botoi krijime në poezi dhe në prozë. Ato i përmbledhi në librin "Vargje të lira", botuar më 1936.

VENDIT TEM

Kur të vdes, le të bahem bar
Në malet e mia në pranverë,
Në vjeshtë do të bahem farë.

Kur të vdes, le të bahem ujë
E frymë e eme avull,
Në fusha do të bije si shi.

Kur të vdes, le të bahem gur,
Në skajin e vendit tem
Të qindroj kufi.

Martin CAMAJ



Isa Alimusaj: Profile dardane

Bisedojmë për poezinë

Në këtë poezi kemi ndjenjen që ka poeti Martin Camaj për vendin e vet. Ai do të sakrifikohet për mirëqenien, zhvillimin dhe përparimin e tij, por edhe ta ruajë dhe ta mbrojë atë.

Pyetje

Përse kërkon poeti që pas vdekjes të bëhet bar në pranverë, kurse farë në vjeshtë?

Po ujë përse kërkon të bëhet?

Analizoni kështu edhe strofën e fundit dhe thoni çfarë do ta ketë shtyer poetin të kërkojë të bëhet gur në kufirin e atdheut?

Detyrë

Kthejeni këtë poezi nga dialekti gegë në gjuhën standarde letrare dhe diskutoni për bukurinë dhe natyrshmërinë e njërës dhe tjetrit variant.



Pak fjalë për shkrimtarin

Martin CAMAJ (1925-) lindi në fshatin Temal të Malësisë së Dukagjinit, afër Shkodrës. Shkollën fillore dhe Kolegjin Severjan i kreu në Shkodër. Pastaj emigroi në Jugosllavi. Studimet universitare, dega e gjuhëve sllave dhe poezia popullore ballkanike i kreu në Universitetin e Beogradit. Nga Jugosllavia emigroi në Itali e pastaj në Gjermani dhe u vendos në Mynih. Studimet pasuniversitare dhe doktoranturën i kreu në Itali. Një kohë të gjatë punoi profesor i gjuhës shqipe në Universitetin e Munihut. Ishte edhe kryeredaktor i revistës “Shejzat”, që botohej në gjuhën shqipe në Romë. Vepra të tij letrare janë: Një fyell ndër male, Kanga e vrrinit, Diella, Meshari i Gjon Buzukut, Rrathë, Njeriu me vete e me të tjerë, Dranja, etj.



GJARPRI I SHTËPISË

(Fragment nga romani "Të gjallët dhe të vdekurit e një fëmijërie")

Nëna këlthiti. Mua, që po i shkoja bisht pas, nuk më doli as zëri nga frika. Gjyshja hyri me nxitim në dhomën tonë, por sikur u qetësua nga ajo që pa në shtrat.

– Dil përjashta, – i tha nënës. – Jepi djalit ujë që t'i kalojë frika.

Nëna më dha ujë dhe piu edhe vetë.

Gjyshja mbeti të merrej vetëm me gjarprin. Nuk ka më trime se gjyshja, mendoja. Pa e prishur fare terezinë – kjo mbresë mund të fitohej nga zëri i saj – zuri t'i fliste gjarprit. Fjalët e saj ishin të qeta, të ëmbla, plot kujdes e përkëdheli. E luste të mos na bënte keq, të largohej nga shtrati ynë dhe të strukej në vrimën e vet.

Herë pas here e vidhja me bisht të syrit se ç'bënte gjyshja e si ia dëgjonte fjalët gjarpri – uji vërtet më kishte qetësuar pak – dhe nuk mund t'u besoja as syve, as veshëve të mi. Gjarpri, sikur t'i thoshte gjyshes: "Ndonëse më pëlqen të prehem në këtë shtrat të pastër, që kundërmon erë sane të re, po iki, po ta bëj qejfin, pasi qenke kaq plakë e mirë e trime", zbriti nga shtrati, e trupoi dhomën dhe u fut pak me përtesë në një vrimë të murit, skaj dyshemesë.

– Pse nuk e thirre dikë nga burrat që ta mbyste? ! – pothuajse e qortoi nëna. – Si të flemë tash në këtë dhomë, kur e dimë se në atë vrimë është strukur një gjarpër aq i madh? !

Gjyshja e shikoi nënën më tepër me keqardhje e me habi, si të ishte e vogël fare, sesa me hidhërim.

– Si të mbytet, moj, gjarpri i shtëpisë? ! Je në vete ti? Ai është roja jonë...

Nëna u skuq dhe e uli kokën. Ishte turp të flitje keq për të, apo të mos e njihje fare gjarpurin e shtëpisë.

Si të mos kishte ndodhur gjë fare, gjyshja u ul në shkëmbin e saj pranë vatrës, e futi në shokë furkën tërë zbukurime, i dha hov boshtit gati të mbushur plot dhe pastaj filloi t'i fliste nënës, duke i mbajtur sytë në fundin e shtëllungës së leshit, prej nga dilte peri:

– Si nuk e ditke, moj, se gjarpri i shtëpisë nuk të kafshon? ! Ku më je rritur ti që nuk e paske mësuar? !

– E di, e di, – u përgjigj nëna e turpëruar. – Ama sa vlen kjo, kur rrëqethem sapo ta kujtoj gjarpurin, e lëre më edhe ta shoh në shtratin tim, ta di se e kam në dhomë, se mund të më futet nën jorgan, në gji të fëmijëve...

– Edhe në u futë, nuk u bën gjë, – fliste gjyshja me siguri të plotë. – E kam gjetur gjarpurin unë edhe nën jorgan, edhe në djep të burrit tënd kur ka qenë foshnjë... I kam folur dhe ai më ka dëgjuar, është futur në vrimë të vet... Mbaje mend, se je e re ti, gjarpri është rojë e robëve të shtëpisë. Kur ne flemë, ai kalon mbi trupat tanë që të na mbrojnë. Ku ka gjarpër, nuk ka të keqe...

– E si na mbron, gjyshe? – pyeta, pasi nuk më bindën fjalët e saj.

– Si? ! – u zu ngushtë ajo. – Këtë nuk e di as unë... Gjarpri është fshehtësi e madhe... Ai ashtu na duket, por vetëm zoti e di se ç'fshihet nën lëkurën e tij... dhe sa është... sa fuqi ka... Gjarpri mund të jetë edhe njeri... Ta kam treguar atë përrallën për djalin gjarpër që martohet me çikën e mbretit?

– Po, gjyshe.

– Edhe ata kanë menduar se ajo është martuar me gjarpër, po ç'djalosh i bukur na ka qenë ai!

Gishtat e thatë të gjyshes e nduknin dhe e ngjishnin leshin me shpejtësi të pabesueshme, boshti sillej aq shpejt sa agërshaku gati nuk shihej fare. Gjyshja e ndër-priste pakëz rrëfimin sa për t'i pështyrë gishtat, kurse unë sakaq tretesha në përfytyrime të botës mahnitëse e plot befasi të asaj përrallës për djaloshin gjarpër. Dhe nuk kishte si të mos më shkonte mendja se ndoshta pikërisht ai gjarpër që pak më parë ishte fshehur në vrimën e vet ishte një djalosh i bukur, të cilit do t'i shkonin pas të gjitha vajzat e Murrizajës po të mund ta nxirrje prej lëkurës së tij. Si e ndiente veten ai djalosh në atë vrimë? Mërzitej vetëm? Kishte prindër, vëllezër, motra, shokë? Kishte shtëpi tjetër pos sonës? Dilte ndonjë herë me fytyrën e tij të vërtetë

nëpër fshat? Kishte nuse të bukur si ajo vajza e mbretit të përrallës? Ku rronte ajo?

– Prandaj, nuk bën assesi të mbytet gjarpri i shtëpisë, – vazhdoi gjyshja gati si të fliste me vetveten, – sepse do të ndodhë domosdo ndonjë e keqe e madhe. E po bëre dhe e vrave gjarprin tënd – thonë se secili njeri e ka gjarprin e vet – do të vdesësh në vend.

Nëna dëgjonte në heshtje, herë pas here tundte kokën dhe se pse fytyra i bëhej lulëkuqe. Më dukej se donte të thoshte: “E di, e di, por nuk kam ç’të bëj, po kam frikë”. Ndoshta mendonte ndonjë ngjarje tragjike: babai e mbyste gjarprin e shtëpisë, ai qëllonte gjarpri i tij, prandaj vdiste... E ndieja se si skuqesha edhe vetë, derisa po i merrja me mend këto pamje.

Gjyshja vazhdoi të fliste, nëna gjeti një arsye dhe doli përjashta, kurse mua më kujtoheshin përralla e rrëfime të ndryshme për gjarpërinj e për bolla. Ishte rrëqethës sidomos rrëfimi për një bollë të gjatë sa një litar, me flokë të kuqe si një vajzë, e cila i mbyste njerëzit që hynin në livadhin ku rronte ajo. Më bëhej se e ndieja se si ma shtrëngonte trupin ajo bollë gjigante dhe pastaj sesi e fuste kokën e saj nën sqetullën time, që të ma shponte trupin dhe të ma hante zemrën... Dora më shkonte vetvetiu së pari nën sqetull, pastaj mbi zemër... Zemra ishte aty dhe rrihte pak më shpejt se zakonisht, duke treguar kështu jo vetëm se ishte aty, në vendin e vet, shëndoshë e mirë, por edhe shqetësimin tim.

Arif DEMOLLI

Fjalorth

agërshak, u – rrasë e vogël qeramike a guri, që vendosej në fund të boshtit për t’i shtuar peshën

bollë, a – gjarpër tepër i madh, jo helmues

furkë, a- mjet ku vihej leshi për t’u tjerre

shkëmb, i – stol, karrige e thjeshtë me tri këmbë, pa mbështetëse

Bisedojmë për prozën

Ky fragment është shkëputur nga romani “Të gjallët dhe të vdekurit e një fëmijërie”, në të cilin autori përshkruan fëmijërinë e tij të vështirë, në një mjedis tepër të veçantë: me zakone e paragjykime që tashmë i ka shlyer koha. Romani, pos për vlerat letrare, lexohet me kureshtje dhe me mëndje edhe për të dhënat historike, etnografike, etnopsikologjike etj. që ia ofron lexuesit të sotëm.

Pyetje

Si e përjeton e ëma e fëmijës takimin me gjarprin?

Pse e qorton gjyshja e fëmijës renë e saj?

Si çmohet gjarpri i shtëpisë sipas traditës popullore shqiptare?

Detyrë

Lexo më tepër për gjarprin e shtëpisë!

Bisedo me prindërit e tu për mitin e gjarprit të shtëpisë!

Shkruaj një ese të shkurtër me këtë temë!



Pak fjalë për shkrimtarin

Arif DEMOLLI (1949) lindi më në fshatin Glllogovicë (Murrizajë). U shkollua kryesisht në Prishtinë. Ka punuar në revista, kurse tash punon në Ministri të Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës. Shkruan për fëmijë e për të rritur. Ka botuar romane, përmbledhje me tregime, përralla, vjersha, pjesë teatrale etj. Disa nga librat e tij për fëmijë janë: "Lushi si askushi", "Pse gjirafa ka qafë të gjatë", "Libër larush", "Njeriu i Blertë", "Lushi në kopshtin e magjepsur", "Lulevera dhe ylberi" etj. Nga librat për të rritur mund të veçojmë romanin "Vdekja e Akanit", përmbledhjet e tregimeve "Ante potas" dhe "Si mbetën gjallë shqiptarët" etj. Romani i tij "Të gjallët dhe të vdekurit e një fëmijërie" u botua në Zvicër në gjuhën gjermane me titull "Es war ein Dorf in Kosova? Die Lebenden und die Toten meiner Kindheit", përkthyer nga Basil Schader.



HAPMA DERËN, ZONJA MËMË

Edhe sivjet, moj nënë,
nga mërgimi i shkretë,
më dogji malli për ty.
Unë e di që ti e pritje
birin tënd të largët,
e qave fshehurazi
kur s'pate mundësi ta përqafoje.
Ndjemë, o e paharruara,
mos qaj, pse mjafton sa qave
për bijtë gjatë shekujve.
Ti e di, nënë Shqipëri,
që unë s'kam asnjë faj
nëse jetoj larg teje,
ashtu ka qenë fati i shkretë,
e është kot t'i kujtojmë hallet.
Erërat kanë fryrë mbi mua,
dëborërat kanë rënë mbi mua,
si edhe mbi kokën tënde,
por përmes erërave e dëborërave
fytyra jote e largët
më forcoi e ngushëlloi.
Ti paske qenë dhurata

që unë e bleva në pazaret,
por më vinte nga gjaku,
gjithmonë e kërkuar
te vorbulla e jetës endacake.
U krenova me legjendat e tua,
u dashurova me fjalët e tua,
qava me vajtimet e tua.
E tash në buzë të së kaluarës e së ardhmes
i drejtoj ende sytë nga ti,
e prej së largu ndjek emrin tënd
dhe orvatem ta mbaj lart.
Lëri dyshimet e mos mendo
që unë do të doja të kisha
një pretendim të padrejtë privilegji,
unë do të doja vetëm të isha
biri yt, si të tjerët.
Ashtu unë e di
e i ardhur nga lufta e jetës,
unë i bie derës sate:
Hapma derën, zonja mëmë,
Se yt bir jam unë, o nënë.

Vorea UJKO

Fjalorth

orvatem – përpiqem

Bisedojmë për poezinë

Poezia është një kuvndim i singertë i poetit me atdheun e tij, nga i cili është mërguar. Është kjo një histori më vete e atdheut dhe e popullit të saj. Poeti i kërkon t'ia hapë derën, meqë ai (atdheu) një kohë të gjatë e pati atë të mbyllur për bijtë dhe bijat e saj të shpërndarë botës gjatë historisë. Është kjo një lutje e singertë, ashtu siç mund të jetë lutja që njeriu ia drejton nënës së vet.

Pyetje

Me kë e krahason poeti atdheun?

Çfarë i kërkon ai atij?

Si e përjeton poeti atdheun?

Krahaso mënyrën si poeti e përjeton atdheun me mënyrën si ti e përjeton atë!

Detyrë

Shkruani mendimet tuaja për pyetjen: «Çka më thotë poezia “Hapma derën zonja mëmë”? ». Pastaj diskutojini dhe krahasojini tekstet tuaja në klasë dhe me mësuesin/sen.



Pak fjalë për shkrimtarin

Vorea UJKO (1931-1988) është poet i njohur arbëresh. Emri i vërtetë është Domenico Bellizi. Lindi në fshatin Frasnitë dhe vdiq në fshatin Firmë të Kalabrisë. Punoi profesor i gjuhës frenge. Ishte redaktor i revistës Zëri i arbëreshëve. Me shkrime u paraqit qysh herët. Shkroi poezi, kritikë letrare, eseistikë etj. Vepra të tij letrare janë: Zgjimët e gjakut (1971), Kosovë (1973), Mote moderne (1976), Ankth (1979), Stinët e mia (1980), Këngë arbëreshe (1983), Burimi (1985).



ANIJA E KAPITENIT BALLTAR

Qe e pajisur me vela dhe me rrema. Udhëtonte sipas rastit. Kur s'kishte erë velat s'hynin në punë, rremtarët përvilnin krahët dhe rremonin në harrim. Në asnjë anë nuk shihej hije toke. Shihej vetëm uji e dallgët. Deti dukej si fytyra e një njeriu vigan që rrudhej e ç'rrudhej. Herë-herë me dukej si ndonjë krahavor i madh që fryhej e ç'fryhej. Në të dy anët e anijes kishte nga një rend rremtarësh. Kapiteni i anijes vetëm komandonte, duke sjellë në një vegël që përhapte bubullimë. Në ritmin e bubullimës rremtarët lëviznin rremat dhe anija çante ujin me të shpejtë. Ishte kënaqësi të shikoje se si dielli pikturonte qiellin në perëndim. Nën ujë loznin dritëzat e kuqërremta dhe të dukej se ishe në një botë të panjohur, në një botë të bukur dhe të rrallë, që për të parën herë e shikon.

- Hej, vocërrak! – më thirri kapiteni, pa më pyetur si më quanin, - Nëse më ke vënë

re se si komandoj, do të më zëvendësosh pak kohë sa të çlodhem!

Unë nuk fola. Heshta si peshku. Vetëm e tunda kokën në shenjë pohimi.

- More, a je duke më dëgjuar se ç'them, apo jo! – më qortoi kapiteni pse s'fola.

- Po, kapiten, ju dëgjova, po s'e di a do të më pranojnë të tjerët, rrematarët?

- Patjetër, ata janë nën komandën time. Ti nëse do të dish të komandos, do ta fal

anijen bashkë me rrematarët e mi, më kupton? ! E nëse nuk do të dish të komandos, edhe ty fati do të të detyrojë të mbetesh përgjithmonë në anijen time.

- A mundem, komandant? !

- Mos mendove të të them të ulesh në kadife, ë? !

- Po, mundem, si s'mundem, kapiten! – i thashë dhe m'u tha pështyma.
- Ja gongu dhe mëshoi kësaj daulleje. Ritmi të jetë i njëtrajtshëm: as i shpejtë, as i ngadalshëm, si frymëmarrja.

E mora gongun dhe me anë të frymëmarrjes e mata ritmin e rremimit të rremtarëve. Kur m'u duk se mësova, fillova t'i mëshoj daulles. Tingulli u përhap e m'u duk se linda për së dyti herë. Nuk ma merrte mendja se mund të urdhëroja edhe unë, e dikush të më dëgjonte besnikërisht. Ritmin e rregullonte edhe vetë bubullima, vetëm duhej kujdes në të komanduar. Kur e mësova, edhe këndoja, edhe mbaja ritmin e të rënit të daulles, remëtarëve u erdhi mirë nga kjo, këndonin edhe ata. Kështu e harronin lodhjen. Kënga jonë kapitenin e vuri në gjumë. Gjatë rrugës bënim edhe nga pak pushim sa për të marrë fuqi të reja për tempin e udhëtimit. Remtarët mbetën të kënaqur me komandimin tim. Dëshironin që unë të bëhesha kapiten. Kapiteni Balltar kishte qenë i rreptë. Asnjëherë nuk kishte kënduar. Asnjëherë s'i kishte lënë të merrnin frymë. Kur u zgjua kapiteni, të gjithë i varën buzët. Kur arritën në mol, ku ishte caku i kapitenit, rremtarët të mërzhitur nga ai komandim i rreptë, ia shprehën atij moskënaqësitë dhe ai pranoi të tërhiqej, të mbetesha unë në vend të tij. Unë i mblodha rremtarët e mbajta një fjalim të shkurtër:

“Të dashur rremtarë, o ju njerëz të ndershëm, o ju detarë të mirë! Prej tash ju nuk jeni më rremtarët e kapitenit të deritashëm zemërgur, ju jeni njerëz të lirë. Anija është prona jonë e përbashkët, vetëm duhet të zgjidhni kapitenin e ri, i cili do të jetë urdhërdhënës dhe zbatues i mendimit tuaj të lirë”. Kur e kreu fjalimin tim, njëri ndër rremtarët u çua e tha:

“Kapiten do të bëhesh ti, s'di ç'thonë të tjerët? ! ”

Të gjithë i çuan duart lart:

“Rroftë kapiteni i ri! ” dhe, të gjithë së bashku hypën në anije.

Rremtarët, nën komandën time, filluan të rremonin nën një këngë të përbashkët.

Ishte mëngjes. Dielli i madh e plot rreze, që thyheshin në valët e panumërta të detit, të gjerë e të thellë, si zemra e rremtarëve të mi.

Në drejtimin tonë vraponte një përbindësh i madh deti, që me një të mëshuar me bisht, mund të na e fundoste anijen. Rremtarët i lanë rremat e rrokën shtizat e gjata. U përqendruan në drejtim të përbindëshit dhe e verbuan. Përbindëshi nuk shihte më. Remtarët i rrëmbyen remat e nën një komandë të rreptë, e lamë pas duke përpëlitur në valët e njëpasnjëshme të detit. Pas një udhëtimi të gjatë e të rehatshëm, pamë tokën në anën tjetër të detit, në anën tonë të bukur, tokën e ëndrrave tona. Të gëzuar nga ky rast bërtitëm e u çuam në këmbë. Asnjëherë përbindëshi s'i kishte lejuar rremtarët të shihnin anën tjetër të detit. Gëzimi që i madh e i përmëmbajtur.

Abdylazis ISLAMI

Fjalorth

Rrem, i – lopatë e barkës

gong, u – vegël muzikore prej një disku të metaltë, të cilit i bihet me një çomangë të vogël

daulle, ja - tupan

Bisedojmë për tregimin

Në këtë tregim kemi një detaj nga jeta e detarëve. Bëhet fjalë sa është me rëndësi të kesh udhëheqës të mirë. Kjo vihet në pah nga ndërrimi i kapitenëve të anijes, ku kapitenin Balltar, me pajtimin e ti, j e zëvendëson kapiteni i ri, i cili është i afërt dhe i pranueshëm për rremtarët. Me këtë kapiten ata arritën ta mundin përbindëshin dhe të shohin vise që kurrë ndonjëherë nuk i kishin parë më parë.

Pyetje

Kah lundronte anija dhe çfarë bënte komandanti i saj?

Çka i tha komandanti vocrrakut në anije?

Çka bëri pastaj vocërraku?

Ç'fjalim u mbajti vocërraku rremtarëve?

Si e pritën ata emërimin e vocërrakut kapiten i anijes?

Çka bënë rremtarët kur panë t'u ofrohej përbindëshi?

Çka panë dhe si u ndien ta pas udhëtimit të gjatë e të rrezikshëm

Detyrë

Mësoni ta ritregoni këtë tregim.



Pak fjalë për shkrimtarin

Abdylaziz ISLAMI (1928-2005) lindi në fshatin gajre të Tetovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, semimaturën në Tetovë, ndërsa Normalen në Shkup. Punoi mësues në fshatra të Tetovës, pastaj gazetar në Radio Shkup, në emisionet në gjuhën shqipe. Shkroi poezi dhe prozë, për të rritur dhe për fëmijë. Botoi shumë libra, si “Era dhe vargjet” (1964), “Mëngjezi në fshat” (1965), “Këngët e zgjuara” (1968), “Soditje nga toka” (1969), “Gurgurina” (1974), “Fatiana” (1975), “Korieri Artan Arta” (1976), “Agullina” (1978), “Vajza e panjohur” (1985), “Oaza” (1973), “Ujërat” (1976), “Për qepalle varen plepat” (1983), “Pëllumbi sqepartë” (1988) etj.



POÇARI

Vajta në Stamboll të bëj pazar,
Për kujtim të ble një vazo balte:
-Paqe dhe selam, usta poçar,
Vazon më të mirë, po e pate,
Paqe dhe selam, usta poçar!

Vazoja nga dora shkau e ra
Dhe m'u bë njëzet e pesë copë,
Më erdhi rrotull deti Marmara
Dhe m'u hap, dyqani turk si gropë,
Më erdhi rrotull deti Marmara.

Pa më shau poçari keq turqisht
Unë e shava shqip e mend i rashë;
Për çudi poçari nuk u ligsht,
Veç dy lot në sytë e kuq i pashë,
Për çudi poçari nuk u ligsht!

Mos u çmend ky turk, ky mysliman?
Unë e shaj, ai me duar në qafë!

Poçe tjetër mori në dyqan
Dhe më tha: "Më shaj, për besë, prapë! "
Poçe tjetër mori në dyqan.

Psherëtiu si unë: "Jam shqiptar,
Shqip, vëlla, ti shamë dhe një herë,
Fjala shqipe s'blihet në pazar,
Në dyqan ka vjet që s'e kam ndjerë,
Fjala shqipe s'blihet në pazar! "

Ikën nga dyqani burra e gra,
Unë e një poçar e tjetër s'kishte,
Vazot frynte deti Marmara,
Vazove poçari shqip u fliste,
Vazot mbushte deti Marmara...

Stamboll, 1980

Dritëro AGOLLI

Bisedojmë për poezinë

Në këtë poezi kemi një rrëfim apo, më mirë të themi, një përjetim interesant të poetit në dyqanin e një shqiptari në Stamboll. Duhet të këtë qenë përjetim, ngase na vjen me një ndjeshmëri aq të thellë, aq prekëse, saqë nuk shpëton pa prekur edhe zemrën e secilit që e lexon.

Pyetje

Ku vajti poeti dhe për se?

Çka i tha ai dyqanxhiut - poçarit?

Çka i ndodhi poetit, subjektit krijues, kur mori në dorë vazon dhe si u ndie ai me atë rast?

Çfarë ndodhi me këtë rast? Si reagues dyqanxhiu dhe blerësi?

Si reagoi dyqanxhiu kur dëgjoi blerësin ta shajë shqip?

Cilat vargje shprehin kulmin e mallëngjimit të poçar dyqanxhiut?

Çfarë bënë blerësit e tjerë në dyqan kur panë këtë dramë të poçarave?

Detyrë

Vazhdoni bisedën duke komentuar vargjet e strofës së fundit të vjershës!

Gjeni këtë poezi si këngë dhe dëgjojeni në klasë!



Pak fjalë për shkrimtarin

Dritëro AGOLLI (1931) lindi në fshatin Menkulas të Devollit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Gjirokastrë, ndërsa studimet për gazetari në Rusi. Punoi në gazeta dhe në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Botoi shumë përmbledhje me poezi, tregime, novela, romane, drama, artikuj kritikë, reportazhe e udhëpërshkrime etj. Vepra të tij të njohura janë: "Në rrugë dolla" (1958), "Poemë për babanë dhe për vete" (1962), "Zhurmë e erërave të dikurshme" (1965), "Mesditë" (1969), "Komesari

Memo" (1969, "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo", "Njeriu me top" (1975), "Mosha e bardhë" (1975) etj.



MALLI

më merr malli për erën e shamive
nga dollapi i nusërisë së nënës
për strofkën e miut skaj shtratit
për macen që pjell nën kulm
tri larushka të vogla
për ngjyrën e djegur të hatullave
dhe rrugën me kalldrëm

më merr malli
për setrën e babait hedhur krahëve
dhe për të vdekurit e tjerë të Dibrës
me merr malli tek shoh
botën në perëndim
dhe tek rriten fëmijët

Eqrem BASHA

Bisedojmë për poezinë

Familja, shtëpia e lindjes, vendlindja, atdheu janë ato që nguliten në mendjen dhe zemrën e njeriut dhe kah do të shkojë ai ato e ndjekin pas. Kjo vërtetohet edhe nga kjo poezi e shkrimtarit tonë të njohur Eqrem Basha.

Pyetje

Për çfarë mediton poeti në këtë poezi?

Përgjigjen në këtë pyetje më lehtë do ta jepte një njeri më i moshuar apo më i ri? Pse?

Ju ka ndodhur ndonjëherë t'u ktheheni kujtimeve të kohës së shkuar?

Detyrë

Bëjini një komentim me shkrim poezisë.



Pak fjalë për shkrimtarin

Eqrem Basha lindi më 15 nëntor 1948 në Dibër (Maqedoni), ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Në Prishtinë studioi gjuhë dhe letërsi shqipe. Punoi gazetar në gazetën "Rilindja" të Prishtinës dhe redaktor i TV Prishtinës deri në mbyllje të tij nga regjimi serb. Tash punon redaktor në shtëpinë botuese "Dukagjini" të Pejës. Është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Shkruan poezi, tregime, romane, skenarë filmash, kritikë të filmit etj. dhe merret me përkthime nga gjuha frënge. Është ndër autorët më të përkthyer në gjuhë të ndryshme. Disa nga librat e botuar: "Shëtitje

nëpër mjegull", "Marshi i kërmillit" (tregime), "Brymë në zemër" dhe "Zogu i zi" (poezi), "Lakorja e Iksit" dhe "Varrë" (romane) etj.



EPOKA PARA GJYQIT

(Fragment drame)

Personazhet:

ABDYL FRASHËRI

SYLEJMAN VOKSHI

TURSUN BEU - zëvendës i Kryetarit të Gjyqit

MEXHID BEU - zyrtar i lartë turk

ROJA E BURGUT

IDRIZ SUMO - dëshmitar i rremë

PLAKU I LAGJES SË HAXHIYMERIT - dëshmitar

DËSHMITARI

GJYQI

Në vendet e veta ulen Abdyl Frashëri dhe Sylejman Vokshi. Të dy kësaj here janë më të zbehur se herët e kaluara. Nga ana tjetër e sallës dëgjohej zëri i Tursun beut.

TURSUN BEU – Me keqardhjen më të madhe duhet të lajmëroj se prej ditës së sotme, 22 nëntor të vitit 1885, këtë gjyq nuk do ta kryesojë Qamil beu, oficer i lartë i shërbimit të sigurimit, por unë, Tursun beu, oficer i shërbimit të sigurimit. Abdyl Frashëri, ngrihuni (Abdyli ngrihet).

TURSUN BEU – Po e keqpërdorni mëshirën që ka ky gjyq ndaj jush dhe po përpiqeni të zhvilloni propagandë armiqësore kundër nesh, edhe këtu. Kini mendjen, punë të tilla nuk i duroj. (Abdyli do të flasë)

TURSUN BEU – kurkush nuk ju dha fjalën. Do të përgjigjeni kur t’ju pyes. Kuptuat?

(Abdyli nuk përgjigjet. Qëndron në këmbë thujse nuk dëgjoi se çka i tha Tursun beu. Është i tretur diku në mendime).

TURSUN BEU - Cilat kanë qenë lidhjet tuaja me shehun e Tetovës?

(Abdyli mendohet a t’i përgjigjet apo jo dhe, më në fund, thotë):

ABDYLI - Lidhje shqiptarësh. Lidhje intelektualësh.

TURSUN BEU – Pas kthimit të tij nga Stambolli, ku ishte në audiencë te padishahu, u takuat në Selanik, në shtëpinë e Thanas Timos, një shqiptar ortodoks, ju, Pashko Vasa dhe shehu i Tetovës. Kjo ndodhi në dhjetor të vitit 1878. Këtë informatë, a mund ta konfirmon si të vërtetë?

ABDYLI - Pse jo?

TURSUN BEU – Për çka biseduat?

ABDYLI - Duke ditur se cili është autoriteti i tij në Stamboll, kemi kërkuar nga ai të ndërhyjë për lirimin e disa të burgosurëve nga burgjet otomane.

TURSUN BEU - Nuk është e vërtetë. Ju atë natë jeni munduar ta bindni atë të bashkëpunojë me ju. T’ju shërbejë si spiun nga Porta e Lartë.

ABDYLI – Keni prova për një gjë të tillë?

TURSUN BEU – (thërret). Dëshmitari Idriz Sumo! (Rojat menjëherë thërrasin dhe me të shpejtë paraqitet ai. Është burrë i moshës 35-40 vjeç, i veshur qytetarçe).

TURSUN BEU – A e njihni këtë njeri?

ABDYLI – Jo.

TURSUN BEU - E ju këtë njeri?

IDRIZ SUMO – Po është Abdyl Frashëri. Për herë të parë e kam parë në shtëpinë e Thanas Timos në Selanik, kur erdhën me Pashko Vasën dhe sheh efendinë e Tetovës.

Aty u shërbeja me kafe.

TURSUN BEU – Ç’ka tha aty Abdyl beu?

IDRIZ SUMO - U mundua të bind sheh efendinë të spiunojë Portën e Lartë.

ABDYLI – (me ironi të thellë). Dhe të gjitha këto biseda i bëmë para teje?

IDRIZ SUMO - Po.

ABDYLI - O i mjerë, sa të kanë paguar të gënjeshtësues?

TURSUN BEU – Asgjë. Me këto fjalë dëshmon besimin që ka në të madhin padishah. (Idrizit).

- Mund të shkoni. (Pastaj Abdylit). E dëgjuat?

ABDYLI – E dëgjova. Është turp të bëni provokime të këtilla me dëshmitarë të rremë. Nëse vazhdoni kështu, nuk do t’i përgjigjem asnjërës prej pyetjeve tuaja. (Për një çast në gjyq mbretëron qetësia. Mexhid beu i thotë diçka me ngadalë

Tursun beut).

TURSUN BEU – Nuk mundem pa jua thënë këtë në fytyrë, loja juaj gjatë tërë kohës ishte kundër nesh. Në fillim edhe ju luftuat për programin e Kararnames. Por tash është fare e qartë se tërë këtë e paskëshit bërë vetëm sa për sy e faqe, të na hidhnit pluhur syve.

ABDYLI – Perandoria Osmane kurrë nuk ka qenë për zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare.

TURSUN BEU – Nuk është e vërtetë. Porta në fillim e përkrahu Lidhjen.

ABDYLI – Asaj nuk i thuhet përkrahje por interes.

MEXHID BEU – Nuk është mirë, Abdyl, të flasësh në këtë mënyrë. Ne jemi munduar aq sa kemi pasur hapësirë nga Paqja e Shën – Stefanit.

ABDYLI – Jeni munduar për vete, jo për ne. Këtë e kam ditur që nga fillimi, e dija se heret a vonë do të kriste konflikti me ju. Vullneti i popullit nuk mund të ndalet. Ta them, Mexhid bej, edhe këtë: Pa zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare nuk do të ketë qetësi as Turqia, as Evropa. (Për një çast mbretrojnë qetësia dhe më në fund):

TURSUN BEU – Me ju nuk kam çka të flas më. Tash e tutje do të flasë me ju veç ligji. Uluni!

ABDYLI – Nëse e keni.

TURSUN BEU - (gërthet) Uluni!

(Në sallë mbretëron qetësia.)

TURSUN BEU – Sulejman Vokshi, ngrihuni!

(Sulejmani ngrihet)

TURSUN BEU – Nga të dhënat që kemi, dhe nga procesi i hetimeve, del pa dyshim se jeni fajtori kryesor edhe për marrjen e Shkupit.

SULEJMANI – Për çlirimin e Shkupit.

TURSUN BEU – (Shikon dokumentin para vetës).

-Më 4 dhjetor të 1880 – shit nuk e keni lejuar mytesherif Raif efendinë të hyjë në Shkup.

SULEJMANI – Po.

TURSUN BEU – Duke menduar se Shkupi do të ngelë gjithmonë në duart tuaja dhe se mytesherifi Raif efendiu, mbasi shkoi në Selanik, nuk do të ketë guxim të kthehet më, u bëtë aq të paturpshëm dhe i ndaluat drejtorisë së hekurudhës Selanik – Shkup të bëjë transportimin e ushtrisë osmane në cilindo drejtim, qoftë nga Shkupi në Selanik, ose anasjelltas.

SULEJMANI – Po. I kam ndaluar. Në territorin tonë të çliruar komandonim ne.

(Për një çast heshtja e kaplon gjyqin).

MEXHID BEU – Si nuk ju vjen turp të flitni kështu!

SULEJMANI – Dëgjoni. Mexhid bej, duke ju shikuar kështu, juve në atë anë dhe veten në këtë anë, po më duket se pak kam bërë. Është dashur dhe më shumë të bëja, do të vdes në atë ixhram (vendim).

MEXHID BEU – Po më habitni. Njeri në moshë dhe me përvojë të flasë kështu në një vend siç është ky!

SULEJMANI – Të gjitha i kam bërë me të vetmin qëllim: Ta luftoj pushtetin tuaj.

MEXHID BEU – Më interesojnë rrënjët e mllefrit kundër nesh.

SULEJMANI – Na morët lirinë, na i morët të gjitha. Kurrë nuk u ngopët me gjakun tonë. Në fund dhe në pazar të botës na qitët të na ndërroni si lecka të vjetra, si harrnën, vetëm e vetëm të shpëtonit kokën tuaj. Unë nuk jam i mençur si Abdyli e ky këto punë do t'ju thoshte më mirë, por unë desha t'ju them të vërtetën që më fle në zemër.

TURSUN BEU – Nuk keni nevojë më tepër të flitni. Se lufta juaj e armatosur i ka sjellë dëme të mëdha Portës, këtë e keni ditur edhe ju. Kjo ju ka gëzuar dhe ju ka dhënë vullnet për aksione të reja, mirëpo, se aktiviteti juaj u ka sjellë dëme edhe fqinjëve tuaj të lagjës së Haxhiymerit, këtë nuk e keni ditur, por do ta mësoni tash.

(Rreh shuplakat dhe roja hap një derë, prej nga del i lidhur plaku i lagjes së Haxhiymerit. E shoqërojnë dy roje. Sulejmani habitet kur e sheh. Sa është prezente habia në fytyrën e Sulejmanit, aq është kënaqësia në atë të Tursun beut.)

TURSUN BEU – E dini pse gjendeni këtu?

PLAKU – Jo.

TURSUN BEU – I njihni këta njerëz?

PLAKU – Sulejman Vokshin po, këtë tjetrin jo.

TURSUN BEU – A e ke parë edhe ndonjëherë tjetër Sulejman Vokshin?

PLAKU – Po qysh.

TURSUN BEU – Dhe nuk keni ardhur të na lajmëroni?

PLAKU – Është e vërtetë, nuk kam ardhur.

TURSUN BEU – Pse?

PLAKU – E pse të vijë t'ju lajmëroj... Njerëzit kanë ardhur në shtëpi të vet... E sa për Sulejmanin, mund të them se është burrë që për gjak nuk vritet... Para se të vazhdoj do t'ju pyetja juve, kadi efendi, për çfarë burri do të më mbanit sikur të vija e të tregoja për fqinjtë tim, për atë që me qindra herë ma ka këputur lakun. Jo, nuk keni nevojë të thoni, e di unë, do të thoshit se jam i poshtër... Tradhtar... E besa, t'ju them edhe këtë. Sulejman Vokshi me shokë është, si thotë populli, ujk që punët i rregullon vetë.

MEXHID BEU – Shihesh se je burrë i ndershëm, po duhet të të përkujtojmë se padishahu për këso farë punësh të humb me tërë familjen, më larg se Kastamonia (vend internimi në Azinë e Vogël).

PLAKU – Shumë bukur, besa... Kurrë nuk kam dalë jashtë kësaj kazaje. Ajo që

padishahu merret me punë të mia, më bën nder të madh... Në mes të këtij qejfi, që më afron vetë padishahu, në kotamoni (plaku e shtrembëron emrin e vendit. Për të ai është shumë i largët e i panjohur.), radios e gjetiu dhe asaj që të tradhtoj, unë do të zgjidhja syrgjynllëkun.

TURSUN BEU - Ke ardhur këtu të tallesh me ne?

PLAKU – Qoftë larg, erdha pse më keni thirrur, e unë u përgjigjem pyetjeve të zotërisë suaj... T’ju them të drejtën, unë nuk kam faj, po qe se ju duken qesharake përgjigjet e mia...

TURSUN BEU – Atëherë përgjigjuni si duhet!

PLAKU – Dëgjoni ... Nuk jua kam frikën. E di se do ta bëni punën tuaj edhe pa përgjigjet e mia... Po në fund kam për detyrë t’ju them se kot e keni që më pyesni për këta burra. Do të nisesha pas tyre, po qe se do të më thërrisnin, edhe në atë dynja, përndryshe do të skuqeshin për mua edhe fëmijët e fëmijëve të mi. Keq... (Tursun beu jep shenjë me kokë dhe rojat, që gjenden aty, e tërheqin me dhunë të lidhur. Tursun beu i kthehet përsëri Sulejman Vokshit, që gjatë tërë kohës ka qëndruar në këmbë.)

TURSUN BEU – E patë këtë njeri?... Do të dënohet me vdekje, se ka bashkëpunuar me ju..., se nuk ka lajmëruar se kah silleni. E, të tillë ka mjaft... mund të them se ju jeni fajtor kryesor për vdekjen e tyre...

SULEJMANI – Tursun bej... Jeni më i ri se unë. Po shihemi këtu dhe shyqyr zotit e njohim njëri-tjetrin. Unë nuk mendoj mirë, po edhe nuk pres që ju të mendoni mirë për mua. Sollët këtu atë të shkretë nga lagjja ime, të tregoni se sa të fuqishëm jeni e se si unë kujdesem për të afërmit e mi, se jam i pazemër, shumë mirë, besa. E, ju jeni njerëz me zemër... Si tha Qamil beu, të dy anët e shkopi janë në duart tuaja. Mbajeni, se ju duhet... Shkopi dhe arma të cilat neve na i morët me aq dhunë, janë dy gjëra që ju duhen aq shumë, po dijeni se edhe me to nuk do të keni gjumë të qetë. Do t’ju shtihen në ëndërra Mic Sokoli, Sef Kosharja e shumë e shumë të pafajshëm nga fshatrat e djegura që i latë pas. Të vdekurit, natën do t’jua bëjnë ferr të gjallë ditën. Kot më sillni njerëz këtu. Unë timen e kam bërë. Po të kisha edhe tri jetë, të tria do t’i kaloja në luftë për lirinë e atdheut tim. Mos më thërrisni më të përgjigjem. Asgjë më tepër nuk kam ç’të them. (Ulet. Në gjyq mbretëron qetësia. Të gjithë janë të hutuar. Në mes atyre që u duket e pakuptimtë pozita, është Qatipi, që herë shikon Tursun beun, herë Mexhid beun, herë Sulejmanin dhe Abdylin. (Skena errësohet)

Ekrem KRYEZIU

Bisedojmë për tekstin

Ky është një fragment i dramës "Epoka para gjyqit" e regjisorit dhe dramaturgut Ekrem Kryeziu. Personazhe ka aktorët kryesorë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878). Në të vërtetë, këtu kemi një gjyq që porta osmane ua organizon dy udhëheqësve të saj Abdyl Frashërit dhe Sylejman Vokshit. Teksti përmban edhe

didaskalitë, të cilat përshkruajnë veprimet e personazheve dhe të ambienteve ku zhvillohet ngjarja.

Kjo dramë është shfaqur disa herë nga ansamblet e teatrove shqiptare.

Pyetje

Përmblihdhini me gojë pikat më të rëndësishme të tekstit!

Diskutoni si mund ta shfaqni këtë fragment si pjesë teatrale ose si mund ta incizoni në DVD.

Detyrë


Ndani rolet nxënësve që u përshtaten më shumë dhe lozeni këtë fragment drame në klasë.

Drama është ndër gjinitë letrare, krahas poezisë dhe prozës. E veçantë e saj është se ndërtohet nëpërmjet dialogut dhe monologut.

Llojet e dramës janë: a) drama në kuptimin e ngushtë të fjalës, b) tragjedia, c) komedia.

Drama lexohet si tekst, por ajo rëndom shkruhet për t'u shfaqur në skenë.

Në letërsinë shqipe drama kanë shkruar: Anton Santori, Sami Frashëri, Çajupi, Gjergj Fishta, Ethem Haxhiademi, Anton Pashku, Fadil Paçrami, Rexhep Qosja, Teki Dërvishi, Ymer Shkreli, Sabri Hamiti, Mehmet Kraja, Fadil Hysaj etj.



Pak fjalë për shkrimtarin

Ekrem KRYEZIU (1943) lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa akademinë për teatër, film dhe televizion e mbaroi në Beograd. Punoi në teatër, në televizion si xhirues e regjisor dhe profesor në universitet. Ka botuar dramat Epoka para gjyqit, Viktimat e Tivarit, Darka e Dreqit, Engjëj e djaj, Lulëkuqt, Komploti ilir, Përtej bunarëve dhe Përplasjet. Ka bërë regjinë e disa filmave artistikë shqiptarë.

REFUGJAT

Shpejt e shpejt muret e natës
Ngritën vetminë time.
Nëna ime! Këtu s'njoh njeri,
As drurët, as folklorin e zogjve.

Mbi një kalë të vogël gjethesh
Garentina në ëndërr më vjen.
Ah, ç'do të më vrasë rrufeja e huaj
Nëpër shira që s'i njoh!

Fredrik RESHPJA

Bisedojmë për poezinë

Kjo poezi është një përjetim i fuqishëm i gjendjes në të cilën ndodhi refugjati, larg atdheut, larg të vetëve, në vetminë e tij, me ëndrrat dhe frikën në shpirt.

Pyetje

Kush ngre vetminë e poetit?
Çfarë i dëfton ai nënës?
Kush i vjen në ëndërr poetit?
Si shfaqet ndjenja e frikës te poeti?

Detyrë

Mendo nëse njeh në rrethin tënd refugjatë. Ua trego poezinë dhe pyeti a i pasqyron ajo përvojat e tyre dhe si u duket ajo atyre. Bëj një intervistë për përvojat e tyre si refugjatë/e.



Pak fjalë për shkrimtarin

Frederik RESHPJA (1941-2005) lindi në Shkodër. Aty kreu shkollën fillore dhe të mesmen, ndërsa studimet universitare në Tiranë. Njihet kryesisht si poet, sado që shkroi edhe tregime e romane. Disa nga veprat e tij janë: "Trimi i fshatit Bardhë" (1968), "Rapsodi shqiptare" (1968), "Eranda" (1969), "Trofta hutaqe" (1972), "Zëri i largët i kasollës" (1972), "Në këtë qytet" (1973), "Enise, enise" (1975), "Erdhi ora të vdes përsëri" (1994) et.j



Zef Shoshi: Isa Boletini me trimat e tij

ISA BOLETINI

Fliste. Flitshin. I ndëgjonte.
Isa me sy plot mall
Maste largësitë e Dheut.

Me gishta të trashë
Shkruante hartën e re
Në dheun e kuq të udhës.
Isa me sy të përmalluar
Maste largësitë e At-Dheut.

Tymi le të dalë në Llap
Kur nën lisa bie dushku
Të çohet flakë përnjëherë
Në Kaçanik, në Carralevë.
Isa me sy të përmallshëm
Shihte udhët që ngjiteshin.

Flaka nis zihet e rritet
Kur dushku bie ndër Lisa
Zjarri e djeg mustakun
Në sy ziente lotin Isa
E vargu i shtruar me plisa
E zdrët udhën në një.

Isa me sy të përmallshëm
Maste gjerësitë e Dheut
Këmbët ngulte në Gur
Kur shkelte mbi Flamë-Urë
I drejt si një Flamur.

E thirrte mallin Isa
Në flakë digjej shtëpia
Kur dushku bie nën Lisa
E rruga shtrohet me plisa
Me gisht krijonte hartën
Po gishti pikonte gjak.

Nuk herret mali me shpatë
Nuk shkelet deti me kalë
Nuk shuhet malli me valë
Në udhën e shkretë në natë.
Kur shkeli në Flamë-Urë
I drejtë si një Flamur.

Një dorë në zemër një në flakë
E shkundi malin fryu fushat.
Masha ia mati shtatin!
Kur tha se vdiq keq tjerr fatin,
Me lot me rrenat e Dheut
Mat gjerësinë e At-Dheut.

Sabri HAMITI

Bisedojmë për poezinë

Kjo poezi i kushtohet Isa Boletinit, që luftoi për mbrojtjen dhe çlirimin e vendit e mori pjesë edhe në shpalljen e pavarësisë në Vlorë më 1912. Fjalët e shkruara me shkronjë të madhe janë veçuar nga të tjerat. Ato kanë një funksion më të madh, janë figura, ndaj të kuptuarit e tyre do të na ndihmojë ta kuptojmë poezinë. Për shembull, këtu: Harta e re është vend i stërgjyshërve; Dheu – bota e jashtme; At-Dheu, mëmëdheu, atdheu; Flamë-Urë – urë e keqe; Flamur – simbol i kombit; Masha – tradhtari.

Pyetje

Çka dini për Isa Boletinin?

Çka e ka frymëzuar poetin për këtë poezi?

Çka kuptoni me shprehjen: Maste largësitë e atdheut?

Detyrë

Mblidhni informata dhe fotografi për Isa Boletinin, bëni një poster për të, paraqiteni para klasës.



Pak fjalë për shkrimtarin

Sabri Hamiti (1950) lindi në Dumnicë të Besianës. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa fakultetin për gjuhë dhe letërsi shqipe e mbaroi në Prishtinë, ku edhe u bë doktor i shkencave filologjike. Për letërsi specializoi në Paris. Punoi redaktor në redaksinë e botimeve "Rilindja" në Prishtinë, kurse tani është profesor i letërsisë në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. U mor me poezi, me proze, drame dhe kritikë letrare. Botoi veprat: "Trungu ilir", "Leja e njoftimit", "Njëqind vjet vetmi", "Futa", "Vetëdija letrare", "Melankolia", "Faik Konica jam unë", "Bioletra" etj.

YJET NUK VISHEN KËSHTU

(Fragment romani)

Sikur të mos isha kaq e trishtuar do të isha e lumtur. Po qëmton shi? Nuk dalloj dot ç'bëhet jashtë. Do të isha e lumtur, sikur të mos më kish kapluar kjo dhimbje e pabesë. Fundja më mirë kështu, po kthehem atje ku isha betuar të mos kthehesha kurrë. Me këtë vend s'më lidh më kurrëgjë, ndaj po iki, por s'do të kisha ikur, sikur të më kishin lënë të jetoja. Jo, ky që dëgjoj nuk është shi. Është shushurima e detit që shkryth eshtrat.

Si do më bëjë zemra të dëgjoj kujën tënde kur të më shohësh? Nënë, ç'nuk do të kisha dhënë për të të përqaftuar. Por do të më duhet veç të të duroj ulërimën, pa mundur të të marr kokën në krahëror: shshsht nëne, tani jam unë këtu, kaloi, iku dhimbja, tani jam këtu e s'duhet të rënkosh më, të kujtohet që ma ke premtuar? Veç të jemi pranë e gjithçka bëhet e kapërcyeshme, helmi i mendimeve, pabesia e diellit, madje edhe ftohtësia ngjyrë blu e hënës. Por nuk do të mundem të çel fjalë, e shpirti ma di si do ta duroj atë çast.

Kisha vendosur të mos kthehesha, jo ashtu si isha katandisur, jo kështu si jam përçudnuar. Nuk do të kthehesha kurrësesi. Do qëndroja këtu, ndonëse asgjë s'më lidh me këtë vend. Je kokëfortë, ndaj s'do të bësh hajër në jetë. Kështu është, jam kokëfortë, ose më mirë isha e tillë. Leilë, pa u pastruar atje s'do të vesh këmbë.

Gjatë ditës ky vendim ishte i kulluar, i qartë, përfundimtar. Por nata ma bënte me të pabesë.

Ato pak net që flija si gjithë njerëzia ëndërroja kthimin në AtjePoshtë. Zbrisja nga tragei, ishte një ditë me një diell që vetëm në AtjePoshtë mund të gjeje. Një diell i tillë që çmendte edhe çmendurinë. Zbrisja dhe përqafoja nënën që më vërsulej mes krahësh duke shpërthyer në lot, trupvogël para meje, maja e kokës nën mjekrën time.

Leilë.

Shshsht nëne, e sheh që u ktheva?

Leilë.

Rrotull atij përqaftimi qentë endacakë rrëmojnë mes plehrave që qelben hallakatur përgjatë molit. Fëmijë me sy të mrekullueshëm përhidhen në një valle prej xhindësh. Fluturojnë valixhe në ajër, drejt të afërmeve që presin të zhvasin diçka nga brendësia e tyre. Policë me uniforma të zbërdhlytura kruajnë të ndenjurat e vështrojnë të zilepsur. Pluhuri i dendur të pudros vetullat. Buritë grindavece të veturave shurdhojnë qiellin pa mëshirë. Vazhdojmë të përqafohemi. Pa lëvizur. Sytë e nënës në shpirtin tim e sytë e mi në zhegun e ditës.

Sepse në ëndërr ngaherë mbërrij në verë në AtjePoshtë. E kur zgjohem, brofthi, jam e lumtur. Vështroj dhomën e ngushtë, qelinë e këtij makthi, dhe vazhdoj të jem e lumtur nga ai takim me Kthimin. Është ende natë. Shtrihem përsëri e dua të vazhdoj ëndrrën që më dhuron një grimëz ëndërr. E di që në mëngjes do ndërroj mendje e do kthehem në vendimin e vjetër: kurrë më mbrapsht. Por tani është natë, dua ta vazhdoj fanepsjen. Mbyll sytë e gjithçka nis aty ku e kam lënë. Nëna, unë, gjyshja që çalon nga këmba e djathtë, Aurora që nuk ka vdekur dhe nuk ka pushuar së rrituri, babai pas shpatullave tona që na ndjek i ngarkuar me çanta, zhurma e qytetit që na shoqëron me pataksjen e tij dembele. Ecim me krahët në supet e njera-tjetrës, pëllëmba ime e majtë bie mbi zemrën gufuese të Aurorës.

Leilë, sa gjëra kam për të të rrëfyer.

Më thotë me ngashërim. Ma kap dorën që i prek zemrën dhe ngre sytë drejt të mive. Por unë shoh drejt përpara, nga frika se mos ata më tradhtojnë.

Do të më tregosh si ishte andej dhe sa gjëra ke mësuar dhe sa djem të bukur ke parë?

Po Aurorë, kur të kemi kohë.

Nesër.

Unë qesh, duke bërë çmos që e qeshura të duket e gëzuar. Ndonëse kjo është një ndjesi e çuditshme, sepse jam e gëzuar, kjo është një ëndërr e gëzuar. Gjyshja thotë diçka, në gojë i ka mbetur vetëm një dhëmb i përparmë duke bërë që gjuha t'i vërtitet si brumë byreku rreth tij. Pra nuk kuptojmë asgjë nga ajo që thotë. Por qeshim të trija, Aurora, nëna dhe unë. Gjyshja imiton, në fillim si me pahir, e pastaj qesh edhe ajo me të madhe. Kjo më shpëton nga sikleti. Vazhdojmë të ecim drejt shtëpisë që s'mbërrin kurrë. Nga pas dëgjohet dihatja e babait që mallkon zhegun e ndërron çantat nga njëra dorë në tjetrën. Përparojmë drejt askundit. E aty ëndrra ndalet. Përfundimisht.

Elvira DONES

Fjalorth

qëmton – bie ngadalë, imët

shkryth – ndrydh

zhegun – vapën

të zilepsur – me zili

brofthi - papritur, me vrull

makthi – ankthi

ngashërim - dënesje

Bisedojmë për tekstin

Ky tekst është fragment nga romani »Yjet nuk vishen kështu« i shkrimtares Elvira Dones. Është një meditim, një ëndërr e personazhit që dëshiron të kthehet në vendlindje, te të afërmit e saj, por nuk i jepet. Një ëndërr që shpreh një gjendje të veçantë psikologjike të personazhit...

Pyetje

Ku mendon të kthehet personazhi (narratori), Leila?

Kush i kujtohet Leiles në çastin kur vendos të marrë këtë udhë?

Çka thotë shprehja: Është shushurima e detit që shkryth eshtrat?

Përse ditën merr vendim të qartë, e natën ai i bëhet i pabesë?

Si quhet vendi ku ajo dëshiron të kthehet dhe çka kupton me këtë emër?

Komentoni shprehjen: Një diell i tillë që çmendte edhe çmendurinë.

Si e përshkruan Leila kthimin dhe përqafimin e saj me nënën?

Çka i thotë Leiles Aurora?

Shpjego shprehjen: dua të vazhdoj ëndrrën që më dhuron një grimëz ëndërr.

Kur ndalet ëndrra dhe pse?

Detyrë

Kërkoni në internet më shumë të dhëna për jetën dhe veprën e shkrimtares Elvira Dones!

Gjeni dhe lexoni ndonjë nga librat e shkrimtares Elvira Dones!



Pak fjalë për shkrimtaren

Elvira Dones (1960) lindi në Durrës. Mbaroi studimet për Letërsi Shqipe dhe Letërsi Angleze në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Nga tetori i vitit 1988 jeton dhe punon në Zvicër. Në gjuhën shqipe ka botuar librat: "Dashuri e huaj" (1997), "Kardigan" (1998), "Lule të gabuara" (1999), "Yjet nuk vishen kështu" (2000), "Ditë e bardhë e fyer" (2001), "Më pas heshtja" (2004) etj. Disa nga këto vepra janë botuar edhe në italisht. Romanet "Yjet nuk vishen kështu", "Ditë e bardhë e fyer" dhe "Më pas heshtja" janë pjesë të "Trilogjisë së dhimbjes". Elvira Dones është anëtare e Shoqatës Zvicerane të Shkrimtarëve.

ÇAMËRIA

Çamëria është pjesa e skajshme në jug të truallit gjuhësor shqiptar; banorët e saj quhen çamë. Që nga viti 1912 pjesa më e madhe e Çamërisë gjendet brenda kufijve shtetërorë të Greqisë. Në anën shqiptare është Konispoli me rrethinë, kurse në atë greke Filati, të dy të rrethuar me një numër të madh katundesh. Mund të argumentohet se pjesa dërmuese e rrethinave të sotme greke të qyteteve Artë e Prevezë kanë qenë shqiptare. Krahina e Sulëve (suliotët) që i dha famë të dhembshme këtij vendi në luftë me Ali Pashën e Janinës, e ka ruajtur pjesërisht edhe sot e gjithë ditën gjuhën shqipe. Një pjesë e banorëve shqiptarë të Çamërisë u quajt nga pushteti grek si popullatë turke dhe me rastin e këmbimit greko-turk të banorëve, si të këtillë i çuan me zor në Turqi.

E folmja e Çamërisë mund të quhet, për shkak të veçorive të saj të vjetra, mbeturinë e gjallë e shqipes së lashtë.

Eqrem ÇABEJ



Veshja popullore çame

Bisedojmë për tekstin

Në këtë copë teksti bëhet fjala për çamët dhe për Çamërinë. Ajo është një krahinë shqiptare, e cila gjatë prerjes së hartave gjatë viteve 1912 dhe 1913 ngeli brenda kufijve të shtetit grek. Kjo vërtetohet edhe nga e folmja e popullit të kësaj treve, gjuha e të cilëve sipas gjuhëtarit tonë të shquar Eqrem Çabej është mbetje e gjallë e shqipes së lashtë.

Pyetje

Ku shtrihet krahinë e Çamërisë?
Si quhen banorët e kësaj krahine?
Po gjuha e tyre si quhet?

Detyrë

Kërkojeni në harta gjeografike Çamërinë; mblidhni më shumë informata historike dhe të tjera për të në libra dhe në internet.



Pak fjalë për autorin

Eqrem ÇABEJ (1908-1980) lindi në Gjirokastrë dhe vdiq në Tiranë. Mësimet e para i mori në vendlindje, të mesmet në Klagenfurt, ndërsa studimet në Universitetin e Gracit dhe të Vjenës, ku më 1933 mbrojti disertacionin në temën "Studime iliro-shqiptare". Punoi profesor i gjuhës shqipe në Gimnazin e Shkodrës. Pas Luftës së Dytë Botërore punoi në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në Institutin e Gjuhësisë dhe të Historisë, kurse ligjëroi edhe në Universitetin e Prishtinës. Pas vetes la shumë vepra të rëndësishme për historinë, letërsinë dhe kulturën shqiptare.



Murret e këshjellës në Janinen e sotme

BALADË ÇAME

Ylberi, si një përshëndetje e përbotur lamtumire,
 U zhduk matanë largësive,
 Mbi kreshtat e flakëve,
 Njëpër shi.
 Matanë largësive u zhduk e përflakur Çamëria
 Dhe të gjitha rrugët tona shpien në veri.
 Ulërin era e Mesdheut mbi trojet e lashta epirote,
 Mbi të shtrenjtat trojet tona stërgjyshore.
 Në kullotat e braktisura kullosin rrufetë.
 Ullishtet e pavjelura gjëmojnë si dallgë nëpër bregore.
 Dhe kudo toka çame,
 Mbuluar nga retë,
 Rënkton e mbytur në gjak e lot,
 E mbetur shkretë,
 Pa zot.
 Na e tregojnë drejtimin plumbat,
 Na e ndriçojnë rrugën flakët, që gjithë tokën kanë përpirë.
 Pas shpinave tona përplas tufani dyert e shkallmuara të shtëpisë.
 Dhe rrugët zgjaten e zgjaten në veri.
 Ne, popull muhaxhir, ecim nëpër shi...
 Lamtumirë, Çamëri!

Bilal XHAFERRI

Fjalorth

muhaxhir – refugjat

Bisedojmë për poezinë

Atë që mësuam nga copa e tekstit të gjuhëtarit të shquar shqiptar Eqrem Çabej, na e vërteton në mënyrën më të qartë kjo poezi e Bilal Xhaferrit. Populli shqiptar i këtyre trojeve u ndoq me dhunë nga vatrat e veta, ashtu siç u ndoq gjatë historisë edhe nga vise të tjera si në Toplicë e gjetiu. Atmosfera e përndjekjes me dhunë të popullit që merr dhenë paraqitet me një ligjërime dhe figuracion të fuqishëm poetik.

Pyetje

Cilat vargje paraqesin më fuqishëm përndjekjen e popullit nga vatrat e tyre stërgjyshore?

Detyrë

Shkruaj një ese për dëbimin e shqiptarëve nga trojet e veta në Çamëri, duke hulumtuar të dhënat në internet.



Pak fjalë për shkrimtarin

Bilal XHAFERRI (1936-1986) lindi në fshatin Ninal të Konispolit dhe vdiq në Çikago të SHBA-së. Shkollën fillore e nisi në vendlindje dhe e kreu në Sarandë, ku punoi si korrier dhe në ndërkohë kreu shkollën e mesme teknike. Pastaj punoi në Tiranë, Durrës, Krujë, Laç e Malësi të Shkodrës. Bie në konflikt me pushtetin dhe e internojnë. Më 1969 arrin të arratiset në SHBA. Në Çikago botoi revistën Krah i Shqiponjës. Vdiq pas një operacioni të një tumori.

Në Prishtinë i është botuar kompleti i veprave letrare: Njerëz të rinj tokë e lashtë, Lirishta e kuqe dhe Krastakraus (Ra Berati).



NË VERI

E vetmja "shenjë" e kalimit të kufirit suedezo-norvegjez ishte natyra thjeshtë gjeografike.

Aty, me të shkelur në Norvegji, niste një konfiguracion i ri tokësor. I lamë vërrijet suedeze dhe hymë nëpër pyje, male, tunele, kodra, bjeshkë.

Kjo dhe - konduktori i ri, që hyri të na kërkonte biletën, më bëri të bindem se nuk jam në Suedi, por në Norvegji.

Kurrfarë formalitetesh të tjera, pasaportë a kontroll. Kurrëgjë.

Norvegjinë e kanë pagëzuar tokë fjordesh dhe –"tokë të diellit të mesnatës".

Në bllokun tim të shënimeve lexoj:

Oslo. Tash është ora 22 e 30 minuta. Unë jam ulur në një bankë skaj një shëtitoreje, e rruga është plot njerëz. Kam nxjerrë bllokun e shënimeve dhe shkruaj: terri s'e ka mendjen të bjerë, edhe pse tash, në vendin tim, shumica janë në më të mirin gjumë.

Hyra në një kinema në orën 19, atëherë kur "piqte" dielli i veriut, me shpresë se kur të dalë, kah ora 21, do të jetë terr. Mendoja të bija më herët, sepse vështirë do të kisha mundur të kënaq kureshtjen time që të shoh menjëherë atë natë jetën e Oslos, apo edhe vetëm vitrinat e këtij metropoli.

Kur dola, në orën 21, ende – dielli! E pabesueshme! Shikova orën. U frikësova mos nuk është gjë në rregull me të. Mirëpo, shumë shpejt u binda: jam në Veri. E gjatë, shumë e gjatë është këtu dita e verës, por - tejet e shkurtër ajo e dimrit.

Ajo ditë thuajse s'kishte – natë.

E shtuna dhe e diela: rrugët plot njerëz. Edhe të bëhet se lidhet dita me ditën pa u vërejtur aspak.

Më tutje, në veri është dielli i mesnatës - "Midnattssol"- që "ndriçon" dhe u jep një bukuri magjike fjordeve norvegjeze, laponëve e fiseve të tjera që gjenden afër polit verior.

Që në orën dy të mëngjesit lind dielli në Oslo. Prandaj njerëzit flenë – ditën. E jeta fillon mbas orës 9 a 10 e vazhdon deri në orën 17 e 18.

Mandej, mbas kësaj kohe një "vakuum", në qoftë se mund të thotë njeriu. Heshtje.

Krejt qyteti "vdes".

Rrallë ndonjë njeri shihet rrugëve.

Kah ora 21, 22 e 23 e "natës" bëhen gati prapë e dalin në shëtitje, shkojnë në kinema, në koncerte, teatro e – më së shumti me automobila në piknikë dhe në shtëpitë e tyre verore.

Për të dëshmuar, ndoshta origjinën, nëpër rrugët e Oslos shihen shumë shpesh të rinj të parruar, me flokë të gjatë, si të vajzave, djem e vajza që s'dallojnë ç'gjinie janë, "vikingë" modernë, në të vërtetë – djerrakohës e badihavxhinj, të cilët, pos që nuk janë "vikingë", nuk janë as dashamirës të mëdhenj të higjienës dhe të mirësjelljes, diku-diku.

Në "Karl Johans Gate", në sheshin kryesor të Oslos, e sidomos para një "kafeterie", një bufeje si kishim për t'i thënë ne – plot fytyra që nuk u përngjajnë vendësve.

Në shtetet skandinave, është shumë lehtë të njohësh atë që nuk është skandinav. Për kah shtati, për kah dukja, për kah ngjyra veçanërisht, për të mos thënë edhe për kah veshja.

Aty, në "Karl Johans Gate", ishte pikëpjekja e të huajve. Kryesisht e atyre njerëzve të cilët kanë ardhur prej anëve të ndryshme të botës për të punuar këtu. Sepse – i madh është fitimi, e çmueshme puna (fizike sidomos), por edhe shumë e shtrenjtë jeta...

Ramiz KELMENDI

Bisedojmë për tekstin

Autori i bën një përshkrim vendit, në të cilin ndodhet për herë të parë. Vëren dallimet e mëdha sa i përket kohës. Dita është e pafund, ndaj si i shkuar nga Ballkani e ka vështirë t'i përshtatet ritmit të jetës aty. Por ai bën fjalë edhe për njerëzit, për vendësit dhe të ardhurit, për ndonjë karakteristikë të tyre, për rrugët dhe vendet e caktuara në kryeqytetin norvegjez Oslo.

Pyetje

Si e kupton udhëtari-autori kalimin nga Suedia në Norvegji?
A dallon kjo nga hyrje-dalja në shtetin ku jeton ti?
Çfarë vëren së pari udhëtari që ka arritur në Oslo?
Çka bën autori për ta kaluar kohën?
Në ç'orë lind dielli në Oslo në stinën e verës?
Në ç'vend takohen të huajt në Oslo dhe përse ata shkojnë aty?

Detyrë

Përshkruaj një udhëtim tëndin në ndonjë vend ose një udhëtim që ëndërron ta bësh një ditë.

Udhëpërshkrimi është tekst në të cilin autori shkruan mbresat nga vizita që u bën vendeve të ndryshme.



Pak fjalë për shkrimtarin

Ramiz KELMENDI (1930) lindi në Pejë. Shkollën fillore dhe semimaturën i kreu në vendlindje, shkollën e mesme bujqësore në Prishtinë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Beograd. Punoi në vende të ndryshme, mësues në Gjakovë, gazetar në Rilindje, redaktor në Zanin e rinisë, kryeredaktor në Redaksinë e botimeve Rilindja, drejtor në Teatrin Kombëtar të Prishtinës, profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës. Shkroi tregime, novela, romane, udhëpërshkrime, kritikë letrare, fejtone, drama, radiodrama etj. Disa nga veprat e tij janë: Vija e vërragë 1958, Dy rrëfime 1962, Letra prej Ulqini 1967, Rrugët 1968, Heshtja e armëve

1971, Ahmet Koshutani 1972, Abrakadabra 1974, Shtatë persona ndjekin autorin 1974, Shtegtimet e mia 1982 etj.



E MARTA

E martë është
Sot vijnë fshatarët e mi
Dhe sjellin në treg
Zemrën e vendlindjes sime.

Të martën e blertë
Të martën e verdhë
Të martën me shi...

Ne dalim në treg
Dhe blejmë nga një pjesë të verës së pjekur
Nga një pjesë të martë prej fshatarëve të mi

Kur kthehen në shtëpi
Me nga një yll të ndezur në plis
Janë më të pasur për një të martë
E më të mëdhenj për një dashuri
Që na e lënë në sofrat e qytetit të bardhë.

E marta në sytë e vashave
Që blejnë në treg –
Lulet e vendlindjes sime
E marta e fëmijëve që blejnë
Mollat e arta të gjakut tim.

Rrahman DEDAJ

Bisedojmë për poezinë

Në këtë poezi kemi përshkrimin e një dite tregu në qytet dhe përjetimin e saj nga poeti.

Pyetje

Çfarë sjellin fshatarët e poetit në tregun e qytetit?

Çfarë kupton poeti me vargjet

Të martën e blertë

Të martën e verdhë

Të martën me shi...

Çka thotë poeti se blejnë qytetarët në treg; çka shpreh me atë metaforë?

Si kthehen fshatarët nga tregu; siç e shpreh poeti dhe çka do të thotë me këtë?

Detyrë

E marta e tregut është një ditë krejt e veçantë për fshatarët. Përshkruaj në një fletë atë ditë të javës që për ty është më e bukura (dhe thuaj edhe pse e do veçanërisht atë ditë).



Pak fjalë për shkrimtarin

Rahman Dedaj (1939-2005) lindi në fshatin Penu të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në Podujevë, normalen në Prishtinë, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Punoi gazetar e redaktor në Radio Prishtinë dhe një kohë të gjatë redaktor e kryeredaktor në redaksinë e botimeve të Rilindjes dhe drejtor i përgjithshëm i kësaj ndërmarrjeje botuese, gazetares e grafike të Prishtinës. Shkroi për fëmijë dhe për të rritur. Botoi librat: Me sy kange 1962, Mshehtësia 1966, Medaloni 1966, Dy liqej 1967, Simfonia e fjalës 1968, Baladë e

fshehur 1970, Zogu dhe kulla 1972, Etje 1973, Gjërat që s'preken 1980, Koha në unazë 1980, Jeta gabon 1983, Fatkeqësia e urtisë 1987 etj.



Nexhmedin Zajmi, Malësorja

NËNA

(Fragment nga romani "Rruga e shtëpisë sime")

Nëna ime ka sy të çuditshëm. Sytë e saj, sa herë i vështroj me kujdes, më duken më të çuditshëm se gjithçka në jetën e saj. Ata herë ndezin zjarrin në mua e herë e shuajnë atë zjarr dhe më ngrijnë. Vërtet, vjetëve të fundit, sa herë e vërej, bindem se nëna ime ka ndryshuar shumë. E ndryshimi i saj më frikëson. E kujtoj si ka qenë. Ndalem mandej dhe shikoj shpeshherë me kureshtje dhe kështu do kujtime gjithfarë më sillen nëpër kokë. Nuk ka qenë nëna ime kështu si është tash, i them vetes dhe ndiej diçka të më rëndoje.

Në këtë rrugën tonë ka ndryshuar gjithçka e ka ndërruar kaq shumë edhe nëna ime. E mendoj të kaluarën tonë. Ndryshimet e nënës time më lidhën gjithnjë me të kaluarën tonë. Ato ma kujtojnë menjëherë edhe këtë rrugë. Shoh: fytyra tash i është zbehur, sa i është zvogëluar dhe tretur, sikur ashtu me pamjen që kishte marrë, të donte të tregonte se nuk mund të qëndronte më, ose të rrëfente për të gjithë ato vjet të saj të kaluara, me të gjitha ato që e kishin rrëzuar në të dy gjunjët si thoshte ajo shpeshherë.

Megjithatë, sa herë e vërej, shoh se sytë i kanë mbetur po ata që i ka pasur gjithmonë: të gjallë, në shikimin e tyre më është dukur gjithmonë se kishte aq shumë dëshira për jetën dhe se ato më dukej se shkëlqenin dhe dilnin prej tyre. Më dukej se ajo edhe mbas tërë asaj shtrëngate nuk i kishte fikur, sepse më dukej se kishte plot besim, së pari në vete, e mandej edhe në ne të tjerët. Kështu i kisha thënë vetes gjithmonë, sa herë kisha menduar për këtë dhe mandej pohoja se nëna ime ka qenë e këtillë gjithnjë. Këto që i mendoja për nënën në do çaste dëshpërimi, më forconin. Vetëm sa herë i vëreja kështu sytë e nënës sime, kur i zija ashtu të qetë e të humbur në shikimet që vraponin mbas do kujtimesh, me siguri mjaft të rënda për nënën time, unë hetoja, në pamjen e saj, diçka aq të çuditshme, të fuqishme, por si përvëluese, si zjarri, sa më shtynte që një kohë të gjatë të mendoja vetëm për këtë; ia kujtoja jetën e saj qysh se mbaj mend. Thosha se mu jeta e saj ia kishte bërë edhe sytë kështu, të çuditshëm, edhe pamjen ia kishte dhënë mu këtë që e kishte tash.

Nëna ime nuk ka qenë kështu, por mbas tërë atij ndryshimi, sikur të gjithë i erdhën dhe e rënduan, e pleqërinë ia bënë kaq të rëndë.

“E shkreta pleqni, e zorshme më ka ardhë!” – thoshte.

Po ia shikoja sytë: ishin po ata, të pandryshuar. Ngazëllehesha.

Thosha se nëna ime ka qenë gjithmonë aq e lidhur me jetën sa edhe vetë ishte bërë mu kështu prej saj. Kujtoja mandej jetën tonë dhe nënën time. Të dyja ishin një. Nuk mund t’i ndaja. As t’i mendoja njëren pa tjetrën.

Po kur nëna ndalej dhe më vështronte mua, më dukej sikur po më fliste gjithnjë, sikur më thoshte diçka, sikur e kërkonte nga unë mu atë që mandej e qetësonte nënën time sa e gjente, sikur në shikimin që më hidhte, gjente mandej qetësinë e vet dhe prehej e kënaqur. Shikimi i nënës sime më fliste gjithnjë. Po unë edhe atëherë, mbas atij shikimi që më fliste, nisja dhe e kujtoja nënën time, edhe babanë dhe ia shihja gazin në sy, i shihja edhe vëllain, edhe motrën, edhe gëzimet e nënës... Edhe harenë e nënës sime... Po mandej hetoja se një rrebesh lëshohej mbi ne dhe na dërrmonte. E shihja prapë nënën time, edhe babanë, edhe vëllanë, edhe motrën, edhe gjyshen, djalin, gruan...

Unë vëreja pamjen e saj tash dhe e kujtoja atë dikur, edhe ajo kohëve të fundit, më shqetësonte aq shumë, më sillte përnjëherë në mendje kujtime që më vinin aq të rënda dhe më dërmonin. Jetën e mendoja prapë dhe ato më lidheshin: jeta jonë dhe nëna ime....

E mbaja mend nënën time në ato çaste të ndryshme gëzimi, edhe pse aq të pakta më dukej tash se kanë qenë, e tash më dukej se edhe ato e mendojnë nënën time. Kjo më shkaktonte tash pikëllim edhe mua më lente të zhgënjyer e të humbur sa më tepër që po e kuptoja.

Nazmi RRAHMANI

Bisedojmë për tekstin

Ky është një fragment romani, në të cili personazhi (rrëfimtari) flet për nënën e tij. Në fakt bëhet një portretizim i pamjes dhe i psikologjisë së saj. Nëpërmjet këtij përshkrimi, autori vë në pah jetën e nënës, të vuajtjet e saj, ato që gradualisht ia kishin ndërruar edhe pamjen.

Pyetje

- Çfarë spikat më shumë personazhi (i biri) në fytyrën e nënës së tij?
- Çka i kujtojnë atij ndryshimet që vëren në fytyrën e nënës?
- Si e sheh ai fytyrën e nënës?
- Çka i kujtohet të thoshte nëna derisa i biri e shikonte atë?
- Çfarë thoshte me vete i biri kur shkonte nënën, përse kishte ndryshuar aq shume ajo?
- Si ndihej i biri kur kujtonte edhe çastet e pakta të gëzimeve të nënës?

Detyrë

Në këtë pjesë teksti autori bën portretin e nënës. Gjeni edhe ndonjë rast tjetër të portretizimit të personazhit në ndonjë vepër letrare dhe bisedoni për to në klasë.

Imagjinoni pamjen e nënës sipas përshkrimit që i bëhet këtu dhe vizatoheni apo pikturojeni atë.

Gjeni dhe lexoni romanin e Nazmi Rrahmanit “Rruga e shtëpisë sime”.



Pak fjalë për shkrimtarin

Nazmi Rrahmani (1941) lindi në fshatin Ballofc të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Podujevë, gjimnazin në Prishtinë, ku i kreu edhe studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe. Punoi në Radio Prishtinë, në revistën letrare “Jeta e re” dhe një kohë më të gjatë në Ndërmarrjen botuese “Rilindja” të Prishtinës. Tash drejton Shtëpinë botuese “Faik Konica”. Është autori i disa romaneve, si “Malësorja” (1965), “Tymi i votrës së fikun” (1969), “Toka e përgjakur” (1973), “Pas vdekjes” (1975), “Rruga e shtëpisë sime” (1978).

ELEGJI PËR KOSOVËN

Zot nëse njerëzit s'dinë të shohin sot
Dhe nëse askush s'do të ketë më sy
Shpëto o Zot vetëm sytë e fëmijëve të Kosovës
Zot shpëto ata sy të kaltër të peshqve blu
Që flenë në shi dhe ëndërrojnë engjëjt e tu

Zot nëse zërat e çmendur s'do pushojnë
Dhe tamtamet do përplasen në kupën e qiellit
Dhe klithmat e marra do qeshin e do thërrasin
Zot shpëto ato heshtje të pleqve të Kosovës
Që flasin me brazdat e baltës plot ujë të vjetër
Ujë nga shiu i parë i botës që njomi këtë dhe

Zot nëse s'do këtë më vend në botë ku të lindin nënat
Oh lëre o Zot atë rrugë të gjatë ku nuset e Kosovës
Po lindin yjet e Yllnajës së Mjellmës
O Zot ato janë foshnjat e tua

Dhe nëse s'do të ketë shenjë nga delyzhi ku pirgu do bëhet
gropë dhe gropa kodër mbill nëpër rrugët e Kosovës
Dyqind qiparisa dy mijë qiparisa dyqind mijë Qiparisa
Dhe dy milionë rrape o Zot
Dhe ai do jetë ylli i parë i Lirisë në botë.

Tiranë, prill 1999
Mihal HANXHARI

Bisedojmë për poezinë

Krimet e bëra në Kosovë tmerruan botën, por edhe prekën zemrat e njerëzve liridashës dhe humanistë në botë, që solli intervenimin NATO-s. M. Hanxhari nuk gjeti kujt tjetër t'i drejtohet përveçse Zotit, që të ndalte këtë tmerr.. Këtë poezi e përshkon toni i dhembshur, pikëllues, ndaj njihet si elegji.

Pyetje

Cila është lutja e parë që i bën poeti Zotit?

Si e kuptoni lutjen të shpëtohet heshtja e pleqve të Kosovës dhe përse bëhet ajo?

Po për nënat e dhe foshnjat e Kosovës, cila është lutja e poetit?

Cili, sipas poetit, do të ishte ylli i parë i Lirisë në botë?

Detyrë

Si e kanë përjetuar familja jote dhe të afërmit e saj luftën në Kosovë? Shkruani dhe pastaj lexojini njëri-tjetrit tekstet tuaja!



Pak fjalë për shkrimtarin

Mihal HANXHARI (1930-1999) lindi në një qytezë të shtetit Kentaki (SHBA) dhe vdiq në Tiranë. U shkollua në Tiranë dhe në Budapest. Punoi profesor në gjimnaz, pastaj në Bibliotekën Kombëtare, e ligjëroi edhe në Institutin e Gjuhëve dhe Qytetërimeve Orientale në Paris. Për së gjalli nuk botoi krijimet e tij. Pas vdekjes, të afërmit e tij zbuluan dorëshkrimet e veprave letrare të krijuara në fshehtësi. Deri tash i janë botuar veprat: Se sytë e mi kështu e shohin botën (1999), Na ishte një herë (2000), Ti vdekja ime mbushur me jetë (2002), Malli për Shqipërinë (2002), Duke dëgjuar heshtjen (2002), Gdhend një statujë (2005).

FJALË TË URTA

Trimi i mirë me shokë shumë.
S'tundet mali nga dëbora.
Trimëria matet me zemër, jo me trup.
Shqiponja fluturon në qiell, po folenë e bën në tokë.
Më mirë vdekur e me nder, se sa gjallë e i turpëruar.
Njeriu plaket duke nxënë.
Ujku qimen e ndërron, por zanatin s'e harron.
Lumi fle, armiku s'fle.

Duaj, të të duan.
Fjalë pak e punë shumë.
Fol pak e dëgjo shumë.
Kali i huaj të le në udhë.
Klloçka që s'rri mbi vezë nuk nxjerr zogj.
Njeriu i pamësuar si druri i papunuar.
Një krimb thanë një lis.
Një pikë në çati, prish një shtëpi.
Besa e shqiptarit është shqiptaria.
Ai që përton sot, do pendohet mot.
Puna e bën njerinë njeri.
Mendo dhjetë herë e fol njëherë.
Liria vjen kur s'i druhash vdekjes.

Populli

Pyetje

- Cilat mesazhe të fjalëve të urta të pëlqejnë më shumë dhe pse?
- Si mund të karakterizohen fjalët e urta në krahasim me tekstet e tjera; cilat janë karakteristikat e tyre?

Detyrë

- Ilustro dy a tri prej fjalëve të urta të mësipërme!
- Çfarë fjalësh të urta di në gjuhën e vendit ku jeton, të cilat janë të ngjashme me një fjalë të urtë shqipe?

NJË NATË NGA NETËT PA GJUMË

Zgjohu, Kosovë! Zgjohu, nëna ime e dashur,
balli dhe emri im i shkelur –
zgjohu, oj! A po e ndien vajin tim?

A po sheh si t' i kam ngulur sytë
mu në zemër, mu në shpirt,
si t' i kam hedhur duart rreth belit
për të të përqaftuar, unë – ashti yt?

Zgjohu Kosovë!
Prej plagëve të mia të thyera kush po bahet,
këtë vatër kush po e lë?
Ç'janë këto gjurma gjaku që po shtohen

nëpër fytyrën tënde,
këto varre e murane që po sillen
rreth shtëpisë sime?..

Zgjohu, Kosovë! Zgjohu nëna ime e dashur,
balli dhe emri im i shkelur –
Zgjohu, Kosovë! ...

Sonte vetëm mbeta e –
në derë të oborrit askush më s'po më troket,
askush më,
thua vdekur jam e harruar
në këto troje e suka gjaku;
thua më është fikur hisja
e mbyllur dera e konakut.

Zgjohu, Kosovë! – flakë e hershme
e ashtit tim të pëlcitur,
Bota në ty të kallet!

Ali PODRIMJA

Bisedojmë për poezinë

Poeti Ali Podrimja, njihet si zë i vendit dhe popullit të vet. Edhe në këtë poezi, që është njëra nga poezitë e poemës së tij të njohur "Hija e tokës", ai i drejtohet vendit të vet ta ruajë krenarinë me gjithë nëpërkëmbjet që iu bënë nga shkelës të huaj. Kjo poezi është jehonë aksionit famëkeq të mbledhjes së armëve të vitit 1956, që nxiti edhe shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Poezia është një protestë e ashpër, një ftesë për qëndresë, por edhe një tërheqje e vërejtjes botës paqedashëse për gjendjen e vështirë këtu.

Pyetje

Kujt ia kushton poeti Ali Podrimja këtë poezi?

Cilat figura letrare përdor ai këtu?

Detyrë

Gjeni dhe lexoni përmbledhjen me poezi të Ali Podrimjes "Lum Lumi"!



Pak fjalë për shkrimtarin

Ali PODRIMJA (1942-2012) lindi në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Prishtinë. Kohë të gjatë punoi redaktor në Ndërmarrjen Botuese Rilindja në Prishtinë. Shkroi kryesisht poezi, por edhe prozë e kritikë letrare. Është autor i një numri të madh përmbledhjesh poetike për të rritur, si Thirrje (1961), Shamijat e përshëndetjeve (1963), Loja nën diell (1967), Dhimbë e bukur (1967), Sampo (1969), Torzo (1971),

Credo (1976), Poema (1978), Drejtpeshimi (1981), Lum Lumi (1982), Fundi i gëzuar (1988), Zari (1990), Buzëqeshje në kafaz (1993), Në bisht të sorrës (1994), Tkurrja e atdheut (1996), Libri që nuk mbyllet (1997), Ishulli Albania (1998) etj.

KOKËRRMELI

Na ishte një plak e një plakë që s'kishin as bir e as bijë në vatër, po ditë për ditë i luteshin zotit t'iu falte një fëmijë. Edhe pas shumë kohësh u lindi një fëmijë i vogël, i vogël sa një kokërr mel, ndaj e thirrën Kokërrmel.

Megjithëse ishte aq i vogël sa mezi shihej, prindërit e donin fort, se Kokërrmeli ishte fëmijë i dëgjueshëm e i bindur për gjithçka që ata i thoshin.

Një ditë e ëma i thotë Kokërrmelit:

— Biro, shko e çoi bukën babait që punon në arë.

Kokërrmeli e mori bukën e humbi nën kusinë e tamblit, e zuri të ecte çup! çup! thua ti se po ecte vetë kusia.

Atë ditë i ati kishte dalë e po lëronte arën. Kur pa të birin të vinte, e mori hopa dhe sa s'qe duke e mbytur me të puthura.

— Baba, — i tha Kokërrmeli, — a ta kap edhe unë njëherë parmendën e të lëroj tokën?

— Je tepër i vogël, mor bir, — i thotë ai, — e s'mundesh.

Po Kokërrmeli iu qep fort e s'i ndahej dhe tek e mbramja atij iu desh ta linte.

Teksa i ati u ul të hante bukë, Kokërrmeli hipi mbi parmendë e nisi t'u grahte qeve. Po çfarë ndodh, njëri nga bucat i ra Kokërrmelit në shpinë dhe e mbuloi.

Si sosi bukën, i ati u ngrit dhe i thirri të birit, por sado që u mundua s'e pa e s'ia dëgjoi zërin, qoftë edhe një herë të vetme. E kërkoi sa e kërkoi dhe, kur ra muzgu, tha me hidhërim:

— E marrtë ora e ligë edhe atë! Një që pata edhe atë e humba.

U kthyer në shtëpi edhe e qau hallin me plakën edhe atë natë nuk mbyllën sy.

Në terrin e natës iu ra rruga e kaluan dy cuba nga ara e plakut. Kokërrmeli i ndjeu e u bërtiti me të madhe:

— Ruajuni se mos më shkelni! Ruajuni se mos më shkelni!

Cubat e trembën herën e parë, po si e dëgjuan edhe nja dy-tri herë të tjera, thirrën dhe e pyesnin:

— Ku je ti, more, që thërret kështu?

— Këtu, këtu, te këmbët tuaja, — i përgjigjet Kokërrmeli. — A të vij edhe unë me ju?

— Me ne? — habiten cubat. — E çfarë do të bësh ti me ne? A do të na bindesh për çfarë do të themi?

— Pooo! Gjithçka të më thoni ju, kam për të bërë, — iu thotë atyre Kokërrmeli.

Atëherë cubat e morën me vete dhe i thanë të shkonte në shtëpi e të merrte njërin ka.

Kokërmeli shkoi e hyri në ahur të shtëpisë së vet dhe bërtiti me të madhe:

— O i zoti i shtëpisë, a të marr kuqonin a larojin?

— Kush na paska hyrë në ahur? — e pyet plaku plakën.

Shkuan të dy në ahur e kërkuan gjithkrah, por s'panë kënd, se Kokërmeli ishte strukur në veshin e njërit ka. Atëherë të dy pleqtë u ngjitën prapë lart e Kokërmeli zuri të bërtiste përsëri:

— O i zoti i shtëpisë, a ta marr kuqojin a larojin?

— Merr larojin, more! Merr larojin!

Edhe Kokërmeli e mori larojin e ua çoi cubave. Ata e ndanë e donin t'i jepnin pjesën më të mirë, por Kokërmeli s'mori veç plëndësin e u nda prej tyre.

Ndërkohë që Kokërmeli ishte duke e parë plëndësin, erdhi një ujk dhe e hëngri me gjithë plëndës. Kokërmeli shkoi e u struk midis dhëmbëve të ujkut. Që nga ajo ditë e më mbas, ujku s'bëri hair, se gjithkund që shkonte për të rrëmbyer ndonjë berr, Kokërmeli nxirrte kryet nga goja e ujkut dhe lëshonte kushtrimin:

— Ooo, ruajuni ore, se erdhi ujku!

I shkreti ujk erdhi e u bë asht e lëkurë e një ditë prej ditësh, barinjtë e zunë dhe e mbytën. Kokërmeli doli duke qeshur e duke kënduar nga goja e ujkut dhe u kthye në shtëpinë e vet.

Përrallë shqiptare, rishkruar Virgjl MUÇI

Fjalorthi

mel, i – lloj drithi, me kokrra shumë të imëta

bucë, a – plis dheu me bar

cub, i – që del në mal për të rrëmbyer e për të vrarë

berr, i – bagëti e imët (dele, qengja etj.)

ahur, i – ndërtesa ku mbahet bagëtia e trashë

kuqoj, i – ka me ngjyrë të kuqe

laroj, i – ka me ngjyrë të larme

Pyetje

Çka u lutën burri dhe gruaja?

Si ishte Kokërmeli? Përshkruaje sa më saktë si e përfytyron ti!

Pse e morën cubat me vete Kokërmelin?

Si ngordhi ujku?

Çka është e pazakonshme, përralore në këtë përrallë?

Detyrë

Ritregojeni / përmbledheni këtë përrallë në dhjetë fjali! Mund edhe ta ilustroni.

Provoni a mund ta shfaqni përrallën si pjesë të vogël teatrale!



ËNDRRA... PASTAJ VLORA

Diqysh shkuam në një planet tjetër
Ku kishte bukë qumësht mish
Dhe s'kishte milicë
Shqiptarët ishin shumë të mirë
Preheshin hijeve
Hidhnin valle shesheve
Bënin dashuri të mëdha
Disi... kur hyri Vlora në dhomë
Babi mbrëmë me dy orë natë
Na shkallmuan derën përsëri
Ata që s'mund t'u zë emrin në gojë

Abdullah KONUSHEVCI

Fjalorth
milicë – policë

Bisedojmë për poezinë

Poezia paraqet jetën e shqiptarëve në Kosovë nën okupimin serb. Dhuna serbe ndaj popullsisë së pafajshme shqiptare, e cila jeton në trojet e saj shekullore, që e vazhdueshme, ndonjëherë më shumë e ndonjëherë më pak e theksuar. Ajo e arriti kulmin në vitet '90 të shekullit të kaluar, kur suprimuan autonominë e Kosovës, nxorën shqiptarët nga puna dhe ndoqën me dhunë nga shtëpitë e tyre afro një milion shqiptarë. Kjo situatë preku ndërgjegjen e botës demokratike, ndaj Kosova gëzoi ndihmën konkrete për të shpëtuar nga ky pushtues. Poezia ofron një detaj të jetës së popullit shqiptar në ato rrethana.

Pyetje

Çka ëndërron poeti?

Çka ia ndërpret ëndrrën atij?

Pse poeti përdor fjalën milicë e jo policë?

Kush janë ata për të cilët poeti thotë: „ata që s’mund t’u zë emrin në gojë“?

Deyrë

Bisedoni me prindërit çfarë ka qenë jeta e shqiptarëve në Kosovë në kohën e okupimit serb!

Shkruani një ese në temën e lirisë!



Pak fjalë për shkrimtarin

Abdullah Konushevci (1958) lindi në Prishtinë. Aty mbaroi shkollën fillore, gjimnazin matematikor, si dhe studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe. Punoi në gazetat “Bota e re” dhe “Rilindja” të Prishtinës. Shkruan poezi për të rritur dhe merret me studime gjuhësore dhe letrare. Botoi librat me poezi “Pasqyrë dhe diell”, “Loja e strucit”, “Pikat AD” etj.



DEBUTIMI IM NË BURGTEATËR

Kur jetoja në Vjenë, isha i ri dhe i varfër. Për të fituar bukën, u jepja mësimet private të gjuhës italiane disa nxënësve. Në atë kohë e ardhmja ime ishte shumë e errët. Nevoja për të jetuar, oreksi i madh, zorrët që me gërryenin, më detyruan të punoja si figurant në Burgteatër duke marrë çdo mbrëmje një shpërblim fare të vogël. Që të them te drejtën, pa u mburrur, nuk isha figurant, po ndihmësfigurant, ose më mirë të themi statist i thjeshtë. Për punën që bëja, merrja 1.35 marka për çdo shfaqje. Si statist, luajta rolin e një plakut grek në pjesën “Mjeshtër Palmira” dhe atë të një plakut romak në tragjedinë “Jul Çezari”.

Por ja, në komedinë e Molierit, “Tartufi”, m’u dha gabimisht roli i shërbëtorit të Tartufit, që kishte një emër, ai quhej Lorenc. Roli nuk ka asnjë fjalë, por atij i flet Tartufi, që e interpretonte Jozef Kainci. Atë unë e kisha parë shumë herë, kurs ai mua asnjëherë.

Tartufi hyn në skenë nga ana e majtë, i përcjellë prej shërbëtorit. Para se të dilnim në skenë, unë isha afër Kaincit dhe i thashë “mirëmbrëma”, por ai nuk ma vuri veshin dhe as më shikoi. Me gishtin tregues të dorës së djathtë, hoqi

pluhurin nga sipërfaqja e një mobilieje dhe i tha inspektorit të skenës: "Duhet të kujdeseni që të ketë më shumë pastërti në teatër? !" Inspektori i nevrikosur iu përgjigj: "Zotni Kainc, ju lutem hyni në skenë" dhe shtoi, duke u drejtuar nga unë: - "Edhe ju".

I gatshëm dhe i shpejtë. Kainci filloi rolin e vet: - "Lorenc, o shërbëtori im, më përgatit petkat e pendesës..." Në çast Kainci ngre sytë, shikimet tona kryqëzohen, ai thotë edhe tri fjalë dhe i mbahet goja.

Sufleri, një burrë i moçëm mjekërosh, i kujton aktorit fjalët e rolit. Mua më mbulojnë djersë të ftohta. Inspektori vrapon si një shpëtimtar dhe, më në fund, e ndihmoi Kaincin të dalë nga kjo gjendje e vështirë.

Pengimi që i ndodhi Kaincit, pati pasoja, jo për të, por për mua, pasi të nesërmen nisën të më kërkojnë në të gjithë Vjenën. Kur më gjetën, më thanë se zoti këshilltar mbretëror, doktor Shlenter, kërkonte të fliste me mua! Nga kjo fjalë u çudita shumë.

Iu paraqita Shlenterit, i cili me njerëzit më tha që t'i recitoja diçka. "Nuk di gjë përmendsh", i thashë dhe i premtova se do të mësoj diçka. Pas një bisede të shkurtër me kolegët e mi figurantë, vendosa të mësoj diçka "Rikardi III".

Këtë ia recitova doktor Shlenterit me një gjuhë të keqe, por ai si guximtar që ishte, më paraqiti përpara kolegjiut drejtues të Burgteatrit. Të gjithë personalitetet e mëdha si: Sonetali, Levinski, Bermajsteri, Harmani e të tjerë, pas një diskutimi serioz, vunë nënshkrimet e tyre në një copë pusulle, ku edhe sot mund të lexohen këto fjalë: "Aleksandër Moisiu, lindur..... Baba..... Shkolla e tjerë, është i paaftë për t'u bërë aktor".

Po rrugët e fatit janë të çuditshme dhe unë ndoshta do t'i isha nënshtruar këtij vendimi sikur..... Jozef Kainci mos t'i kishte dhënë rëndësi atij pengimi të gojës, që i ndodhi kur më pa dhe sikur të mos më kishte mbrojtur.

Ai më tregoi rrugën, që unë ndoshta do ta kisha humbur njëherë e përgjithmonë.

Aleksandër MOISIU

Fjalorth

debutim-i - dalja për herë të parë në skenë

figurant- i – aktori që në skenë nuk luan ndonjë rol të veçantë dhe nuk flet

statist-i – figurant që nuk lëviz në skenë

pendesë-a – pendim-i

sufler-i – pëshpëritësi, ai që ua kujton fjalët aktorëve në skenë

kolegjiut-i – këshilli që merret me mbarrëvajtjen e punëve në një institucion

Biesdojmë për tekstin

Ky tekst është një shkëputje nga autobiografia e aktorit të madh shqiptar Aleksandër Moisiut. Ai shkruan për fillimet e tij në të ashtuquajturin Burgteatër. Në të vërtetë këtu vihet në pah çfarë do të thotë fati për njeriun dhe çfarë do thotë të gëzosh mirëkuptimin dhe përkrahjen e njeriut që të kupton dhe është në gjendje të të ndihmojë.

Pyetje

Çka e shtyri Aleksandër Moisiun të punonte në Burgteatër?

Ç'rol luan ai në komedinë e Molierit "Tartufi"?

Çka i ndodhi në shfaqje aktorit Jozef Kainci, i cili luante rolin e Tartufit?

Kush e nxori Kaincin nga situata e keqe që ra?

Cili ishte vlerësimi i këshillit drejtues të Burgteatrit për Aleksandër Moisiun pasi u paraqit në audicion me një pjesë nga "Rikardi III"?

Kush i ndihmoi Aleksandër Moisiut të ecte rrugës e cila i solli famën botërore?

Detyrë

Gjeni ndonjërin nga librat për Aleksandër Moisiun, të autorëve Bardhyl Kosova, Vangjel Moisiut, apo të Isak Gutës, të mësoni më shumë për të!

Kërkoni në internet më shumë të dhëna për Aleksandër Moisiun dhe bisedoni në klasë për të.

Shpjegoni punën që bëjnë në teatër: aktori, regjisori, figurati, skenografi, sufleri (pëshpëritësi), kostumografi, grimeri, ndriçuesi, kompozitori, garderobieri.



Pak fjalë për autorin

Aleksandër MOISIU (1879-1935) lindi në Trieshtë. Si 19-vjeçar shkoi në Vjenë, ku me ndihmën e Jozef Kaincit, iu përkushtua aktrimit. Punoi në teatrin e Pragës, të Berlinit dhe në shumë vende të Evropës dhe të Amerikës Veriore. Janë të njohura interpretimet e tij të Hamletit, Edipit, të Fedjes etj. Luajti edhe në filma, kryesisht pa zë. Vdiq më 23 mars të vitit 1935 në Vjenë, ndërsa u varros afër Luganos në Zvicër.

DHOMA IME NË ULQIN

Edhe kur unë s'jam aty
Nëna e hap dritaren kah deti

Vjen hëna vijëzohet në qelq
Mbush hapësirën me trupin tim

Nëna e hap dritaren kah deti
Edhe pse unë s'jam aty

Të hyjë erë e mirë me jod
Se unë marr frymë diku
Në the të një ere
Kah lë derën hapur

Basri ÇAPRIQI

Bisedojmë për poezinë

Edhe në këtë poezi, poeti, nga largësia i drejtohet nënës. Athua pse? Bisedoni më shumë për këtë në klasë mes vete dhe me mësuesin.

Pyetje

Përse nëna e le dritaren hapur kur birin nuk e ka në shtëpi?

Çfarë kuptojmë me vargjet: Vjen hëna vijëzohet në qelq / Mbush hapësirën me trupin tim?

Po i biri, si lë ai derën dhe pse?

Çka është simbolike në këtë poezi dhe cilat simbole përdoren për të shprehur çka?

Detyrë

Provo të shkruash një poezi në të cilën përdor edhe ti një apo disa simbole!



Pak fjalë për shkrimtarin

Basri ÇAPRIQI (1958) lindi në Sash të Ulqinit. Shkollën fillore dhe të mesmen i mbaroi në Ulqin, ndërsa studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Prishtinë, ku edhe punon si profesor. Ka botuar disa vëllime me poezi për të rritur, si Ulli me dy mijë unaza (1983), Ma qet gjuhën (1986), Frutat bizare (1996) etj., por edhe vepra studimore për letërsinë.



SI U EMËROVA MËSUES

(Fragment nga autobiografia "Retë dhe gurët")

– Gjer në vjeshtë do të shkosh si arsimtar në shkollën industriale të Korçës. Do të marrësh një rrogë të mirë.

Luigj Shala i foli gjermanisht.

Hilë Mosi foli shqip:

- Në Korçë jo! Se ajo shkollë është italiane dhe profesorët janë veshur mirë. Kurse ti...

"Filloi i dehuri me përrallat, " – mendoja unë. Nuk besoja për ato që më thoshin.

– Më mirë është që ti të shkosh mësues në fshatin tënd gjer në vjeshtë. Aty rrogën e ha me familjen tënde! Si thua? Mirë?

Nuk flisja fare. Ata bisedonin gjermanisht.

M'u drejtua Luigj Shala:

– Më mirë është kështu. Shko në fshatin tënd, se në Korçë, me atë shoqëri, me ata kolegë... Si thua, pranon?

– Ku të doni më çoni, – u thashë, – vetëm të filloj nga puna!

Hilë Mosi u ngrit. Erdhi dhe më përkëdheli faqet.

Më puthi në ballë dhe më tha:

– Tani ik shpejt e na sill dy fotografi për dekretin!

Dola jashtë. Ishte errur. Shokët më prisnin. As unë nuk e di pse vrapoja. Shokët më vinin pas duke më pyetur: "Ç'ka ngjarë? " Kur arritëm te sheshi para Bashkisë, u ndala. Ishte errur mirë. Atje m'u kujtua se në atë kohë fotografët nuk punonin (ata që rrinin aty, nga e majta e Bashkisë, me ato aparate të mëdha në krahë). Mora frymë dhe u ktheva nga shokët. Nonda, Sulejmani, Bariu e ca të tjerë gjimnazistë më bënë një mijë pyetje dhe, kur u tregoja se ç'më kishte ndodhur me Hilë Mosin, nuk më besonin. Bariu i gjorë tha:

– Tallen me ty!

-- Duke ecur, bisedonim rreth kësaj ngjarjeje të jashtëzakonshme.

– Hilë Mosi është poet, – u thosha, – dhe nuk tallet!

– Do të ketë qenë tapë. Se ai pi shumë! Kur të shkosh nesër, s'ka për të të njohur. Ke për ta parë.

– Ndodhin dhe çudira!

– Mos është edhe Hilë Mosi.. ?

–Jo! Jo! – bërtita unë. – Ai është poet. M'u soll sikur të isha djali i tij!

– Po pse? Ç'i hipi atij të të bëjë djalë ty , u çmend? Një ministër të bëjë djalë një varfanjak, një të mjerë si ne? ! I

– Po ai është patriot!

– Ku ka patriotë në ministri!

– Patriotët janë... në burgje!

Biseduam gjer vonë, edhe kur shkuam në një barakë ku flinim, gjersa na zuri gjumi. Unë isha si mbi re. Bisedat me shokët e mi ma prishën ëndrrën! “Patjetër nesër s'ka për të më njohur! Sidomos ai Luigj Sha1a, që më mohoi fitoren e konkursit për gjeografinë! “

Shumë vonë më zuri gjumi. Nuk kisha parë asnjë ëndërr, që të gjykoja për sa më prisnin. Se unë shihja ëndrra profetizuese. U ngrita dhe u thashë se do të shkoja te një fshatar imi që shiste verë e raki, të më jepte pesë lekë borxh për fotografitë. Shokët qeshnin me mua. Nuk besonin asgjë.

Me fotografi ende të lagura, shkova në ministri. Më pa shoferi tullac, m'u afrua, më buzëqeshi dhe më tha:

– Të do shumë ministri, të do sikur të të kishte djalë. I bëre fotografitë? Eja të shkojmë lart. – I pari hyri ai në zyrën e ministrit. Pas tij edhe unë. Hilë Mosi diçka lexonte. Sapo më pa, u ngrit më këmbë dhe m'u afrua. Më hodhi dorën në sup. I dhashë fotografitë.

– Eja këtu për... për tri ditë, se do ta dërgojmë emërimin në Kryeministri. Pas tri ditësh eja këtu, more bir!

“Domethënë nuk është tallur me mua! Domethënë unë po emërohem mësues! Pra, mbaroi kalvari im! Domethënë do të jem edhe unë me rrogë! “

Ato tri ditë qenë shumë të gjata për mua, siç qenë të gjata dhe planet që bëja. Takova Demirin, i thashë se ç'më kishte ngjarë, dhe ai, i gëzuar, më tha:

– Hilë Mosi është patriot, është idealist, është shumë i ndershëm!

Ditën e tretë u gjenda para ministrisë në kohën kur futeshin nëpunësit. Ishte shpejt. Dhe ja, erdhi dhe vetura e ministrit. Doli dhe, sapo më pa - se i dola përpara – më tha:

– Eja me mua! – Asnjë fjalë tjetër. U ngjitëm shkallëve. Me të hyrë në zyrën e tij foli: – Dekretin e morëm qysh ike dje! – U ul dhe nxori nga sirtari dekretin e emërimit tim si mësues në shkollën e Dhërmiut, të nënprefekturës së Himarës.

–Ulu, – më tha pasi më dha dekretin. E shikoja! Ai thirri llogaritarin, njëfarë Berberolli. Një burrë i gjatë. I tha:

– Të bësh një dëftesë për shpenzime udhëtimi Tiranë-Himarë, njëqind franga!

Berberolli iu përgjigj:

– Shkëlqesi, shpenzimet e udhëtimit Tiranë-Himarë nuk janë 100 franga, por njëzet e pesë.

Dhe Hilë Mosi:

– Si po të urdhëroj unë, ashtu të bësh ti! Njëqind franga, dhe silli këtu! – Doli Berberolli dhe ministri më fliste me zë të ulët. Më dukej i mërzhitur, i lodhur.

Mbaj mend se më dha disa porosi për punën time të përkohshme, se do të më dërgonte me bursë jashtë shtetit. Veçanërisht, më porositi:

– Të shkruesh vjersha. Vjersha asht shprehja ma njerëzore e mendimit dhe e zemrës.

Erdhi Berberolli me të njëqind frangat, të cilat i mora pasi nënshkrova. Ai u largua. Hilë Mosi u ngrit në këmbë.

– Tash, more djalë, të kjoftë udha mbarë! Me këto pare vishu mirë, me kostum, me këpucë, dhe shko në fshatin tand! Më shkruiej! – Dhe më përqafoi.

Petro MARKO

Fjalorthi

dekret, i – urdhër, vendim zyrtar

isha mbi re – isha i humbur, i hutuar fare

kalvar, i – vuajtja

llogaritar, i – ai që merret me pagesa

frang, u – njësi monetare e kohës

Pyetje

Për cilin moment të jetës flet autori në këtë fragment?

Me çfarë bindjeje shkon në ministri dhe çka e befason?

Si e marrin në fillim premtimin e tij shokët e Petro Markos?

Pse kanë aq shumë mosbesim në ministrin?

Kush ishte Hilë Mosi dhe çfarë njeriu del ai në këtë fragment kujtimesh?

Si quhet teksti në të cilin autori shkruan për jetën e tij?

Detyrë

Diskutoni për këtë tekst: cilat janë personazhet e tij, si sillen ato, a janë të vërteta a të trilluara, ngjarja për të cilën rrëfëhet është e vërtetë, dialogët janë autentikë apo të ndryshuar etj.

Kërkoni në libra dhe në internet informata dhe fotografi për shkrimtarin Petro Marko dhe për librat e tij!



Pak fjalë për shkrimtarin

Petro MARKO (1913-1991) lindi në Dhërmi të Himarës. Është njëri nga shkrimtarët më të shquar shqiptarë. Mori pjesë si vullnetar në Luftën e Spanjës. Në Tiranë punoi në arsim dhe një kohë drejtoi gazetën “Bashkimi”. Shkroi shumë libra për të rritur, por edhe për fëmijë. I janë të njohur librat “Shpella e piratëve”, “Hasta la vista”, “Qyteti i fundit”, “Halimi”, “Fantazma dhe plani tre plus katër”, “Griva” etj.

RUBAITË E MËNGJESIT

A e di përse kënduesi po këndon
Me natë dhe nga gjumi po na zgjon?
Që shkoi një ditë po lajmëron,
Dhe ti, shkujdesur, fle dhe ëndërron.

Zgjohu! Mëngjesi me shigjet' e grisi
Perden e natës, yjt i arratisi,
Dhe dielli gjahtar me rreze kapi
Çdo majë mali e pallati e lisi.

Qesh trëndafili e thotë: "Lulëzoj
Dhe botës bukurinë po ia shtoj:
Pastaj e hap kuletën e mëndafshtë
Dhe përmbi kopsht thesarin po e shtroj".

Mbi lulet po pikojnë vesë retë,
Dhe me një zë qiellor bilbil'i shkretë:
Ah, Verë! Verë! Verë! Trëndafil
I lyp të skuqë faqezën e zbehtë.

Omar KHAJAMI - (Shqipëroi: Fan S. Noli)

Bisedojmë për poezinë

Këto janë disa strofa nga libri i njohur poetik i poetit persian Omar Khajami (1048-1131). Në gjuhën shqipe poezia e tij erdhi në saje të përkthimit brilant të shkrimtarit, muzikologut, teologut e politikanit Fan Stilian Noli. Nga përkthimi i tij rubairat e Omar Khajamit lexohen si të ishin shkruar në gjuhën shqipe. Kjo arrihet nëpërmjet rikëndimit të tyre, do të thotë rishkrimit të tyre, që nënkupton edhe atmosferën dhe frymëzimin e autorit.

Fan Noli, përveç poezive të tij të mrekullueshme, letërsisë shqipe ia dhuroi të rikënduar (të përkthyer) edhe disa nga xhevahirët e letërsisë botërore, si vepra të Shekspirit, vargje të Edgar Allan Posë etj.

Përkthimi ka një rëndësi të veçantë për të shijuar vlerat që krijohen në letërsi të gjuhëve të tjera. Pa të njohjet tona do të ishin shumë të varfra.

Pyetje

Çfarë thotë këndesi (gjeli) me kikiriku-në e tij në mëngjes?

Ç'metaforë përdoret për të vënë në pah pushtimin që i bën hapësirës që me lindjen e tij?

Çfarë thotë trëndafili në mëngjes?

Po bilbili, çfarë thotë me këngën e tij?

Detyrë

Provoni ta lexoni poezinë sa më bukur; bëni një garë në klasë kush e reciton më së miri!

Provoni të shkruani poezi në stilin e asaj sipër! Pastaj i lexoni njëri-tjetrit dhe diskutoni çka ju pëlqen dhe pse!



POETI I VOGËL

(Fragment tregimi)

Fragment tregimi

E kisha vënë re disa ditë me radhë, kur dilte ora e fundit e mësimet, një çunak i vogël rrinte pranë portës së shkollës e më shikonte si me ndrojtje e turp. Ishte i hollë në trup, i hequr në fytyrë dhe me sy të mëdhenj që i shkëlqenin si ullinj të zinj. Duhej të kishte dalë edhe ditë të tjera, por unë s'e kisha vënë re. Vetëm këto ditët e fundit e kuptova që më priste mua, kishte diçka për të më thënë ose për të më dhënë, por s'vendoste dot. Dhe ashtu qe vërtet. Befas një ditë më del përpara. E pashë që u skuq. U ndala. Ai më zgjati një letër të palosur dhe sapo unë e mora dhe bëhesha gati ta pyesja, ai u zhduk mes nxënësve të tjerë. E shpalosa letrën dhe pashë: ishte një vjershë. Vura buzën në gaz dhe e futa në xhep... Kur shkova në shtëpi, e lexova. Ishte një vjershë që fliste për bukurinë e atdheut dhe thoshte se zemra i këndonte në kraharor kur shqiptonte emrin e

Shqipërisë. Vargjet e ngrohta e të thjeshta që kishin buruar vetiu. Shpesh të tilla vjersha ishin me fjalë të fryra. Por vargjet, që kisha përpara, ishin të mbrujtura me fjalët më të zakonshme, ato shprehnin me butësi një ndjenjë të ëmbël të zemrës së frymëzuar. U gëzova sikur kisha gjetur një mik të humbur, e, me të vajtur në shkollë, desha të mësoja emrin e tij, se ai kishte harruar ta shkruante.

- Nuk e njoh këtë shkrim, - më tha mësuesja e gjuhës.

Atëherë në pushim dola korridorit, hodha sytë nga tëra anët, por nuk e pashë kund. Ai me siguri më fshihej. Vendosa atëherë ta botoja vjershën në gazetën „Letrari i ri“ të shkollës, dhe ashtu bëra: „Tani, - thosha me vete, - ai do të vijë vetë“. E nuk gabova. Kur mbaroi mësimi, poeti i vogël më priste në vendin e zakonshëm.

- Faleminderit, mësues!

I pashë mollëzat që iu skuqën. I vura dorën në sup.

- Vjersha është e bukur. Të lumtë!

- Faleminderit, mësues!

- Më fal që e botova pa emër.

- S'ka nevojë për emër, mësues, s'ka nevojë, - dhe u largua gati me vrap i shqetësuar, sikur ta dinte se unë do ta pyesja se si e quanin.

Por unë e mësova emrin e tij.

- Është nxënës i mirë, - më thanë mësuesit që i jepnin mësim, - i urtë dhe i dashur me të gjithë.

Pas vjershës së parë, ai më dha edhe shumë vjersha të tjera. E të gjitha ishin të freskëta. Edhe kur shkruante për atdheun, i këndonte mes fëshfëritjeve të flamujve, edhe kur i këndonte Skënderbeut majë shkëmbinjve të hirtë të Krujës, edhe kur i dhuronte një buqetë me lule Naimit fjalëzjarrtë, edhe kur ulej për të puthur gurët e fshatit të tij në Zagorie, edhe kur i drejtohej i habitur trenit që e kishte sjellë në Tiranë, që i dukej si një qytet me rrota, dhe kur u mburrej shokëve se kishte mësuar biçikletën. Kurdoherë unë ndieja zemrën e tij të çiltër, të pastër e fëmijërore.

Gjergj ZHEJI

Fjalorth

çunak-u – çun i vogël

Bisedojmë për tregimin

Këtu kemi një fragment nga një tregim më i gjatë i shkrimtarit Gjergj Zheji. Bëhet fjalë për një vogëlush, i cili ka dhuntinë të shkruajë, por druan që atë ta shfaqë hapur. Mirëpo do të gjendet mësuesi i tij i cili do ta kuptojë dhe do t'i ndihmojë atij.

Pyetje

- Çka kishte vënë re mësuesi?
- Përse ngurron çuni i vogël të tregojë vjershën e tij?
- Çfarë bënte mësuesi kur e merr vjershën nga çuni?
- Si reagon çuni kur mësuesi i kërkon falje për shkak se vjershën ia kishte botuar pa emër?
- Çka kishin thënë mësuesit e tjerë për çunin e vogël?
- Si dukeshin tani krijimet e reja poetike të çunit të vogël?
- A ka në klasën tuaj ndonjë nxënës që merret me shkrime?

Detyra

Ritregoni me shkrim këtë tregim!

Provoni të shkruani edhe ju një tregim për ndonjë ngjarje nga jeta juaj shkollore!



Pak fjalë për shkrimtarin

Gjergj ZHEJI (1926-2011) lindi në Tiranë. Shkollën fillore, të mesmen dhe studimet universitare i mbaroi në vendlindje. Punoi në Institutin e Studimeve Pedagogjike në Tiranë. Në fillim botoi vjersha, kurse më vonë tregime, novela, romane, shkrime kritike, studime etj. Shkroi për fëmijë dhe për të rritur. Ka botuar veprat: Çupa e trëndelinave (1957), Tenxherja magjike (1958), Bie zilja (1964), Fjalor termash letrare (1965), Anton Zako Çajupi (1966), Muret e Krujës (1968), Kullat (1969), Rusha (1971), Tregime të zgjedhura për fëmijë (1976), Bazat e vargëzimit shqiptar (1988), Mjellma (2001) etj.



PRANVERË

Pranverë, pranverë, pranverë
në buz't e tua vë vargun tim
Dhe ti atë varg si përherë
E bëre për shpirtin - shpëtim!

Sa herë tek unë ke trokitur
Me hap të lehtë në oborr
Aty dallëndyshen kam pritur
Mes lulesh thurur kurorë...

Atje tani ti vjen e bukur.
Me ty dallëndyshja prapë vjen
Kërkon mes lulesh mos jam futur
Kërkon dhe dot, oh! nuk më gjen.

Do vij një ditë, unë do të vij
Tek ai prag ku prita pranverat
Që ikën bashkë me rininë...
Nga malli vet do hapet dera.

Vitore STEFA - LEKA

Bisedojmë për poezinë

Pranvera është stinë e zgjimit dhe e frymëzimit. Poeteshë i këndon pranverës dhe përjetimit të saj në moshën e fëmijërisë. Ndien mallin i cili ia hap portën për në kohën e shkuar.

Pyetje

Si e përjeton vargun e vet poeteshë?

Me cilin shpesë shtegtar e lidh pranverën autorja?

Çfarë kërkon tash dallëndyshja në vendlindjen e poeteshës?

Çfarë pret të ndodh me rastin e kthimit të poeteshës në vendin ku ka pritur pranverat e fëmijërisë së saj?

Detyrë

Bëj një poster apo pllakat për poezinë e mësipërme; shkruaje sa më bukur dhe zbukuroje me vizatime, fotografi apo objekte!

Kërkoni poezi të tjera për stinët e vitit dhe bëni një incizim me recitime sa më të bukura prej tyre. CD-në që e krijoni mund ta ruani si kujtim ose t'ia bëni dikujt dhuratë.



Pak fjalë për poeteshën

Vitore STEFA-LEKA (1945) lindi në Berat në një familje me tradita arsimore e patriotike. Shkollën fillore dhe pedagogjiken i mbaroi në vendlindje. Punoi mësuese dhe punëtore në fabrikën e verës në Durrës, pa mundur të shkollohej më tej dhe pa mundur të botonte shkrimet e veta nga regjimi komunist. Që nga viti 1991 jeton në Itali, ku shquhet për aktivitetin e saj humanitar dhe për çështjen kombëtare. Ka botuar tetë libra me poezi dhe në prozë, si "Poezi që merr frymë pas pushkatimit", "La liberta". "Jetoj ringjalljen", "Vetmi e largësisë", "Në të dënuarit", "Plagë shpirt" etj.



Xhevat Sylja, Shefkije Islamaj, Rizah Sheqiri

LETËRSIA SHQIPTARE

Fletore tematike - për nivelin e tretë

Botimi i parë

Botues:

Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë

Për botuesin:

Agim Lluka

Redaktor teknik:

Lavdim Beqiri

Tirazhi: 5.000 kopje

Formati: 205x285

U shtyp në shkurt 2013

në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë

www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18:37(076.1)

008(=18)

Sylja, Xhevat

Letërsia shqiptare : fletore tematike për nivelin e tretë /
Xhevat Sylja, Shefkije Islamaj, Rizah Sheqiri. – Botimi i parë. -Pejë:
Dukagjini, 2013. - 110 f.: ilustr. me ngjyra; 29 cm.

Parathënie : f. 5

1. Islamaj, Shefkije 2. Sheqiri, Rizah

ISBN 978-9951-05-259-7

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 2-3774, të datës 17.10.2012*

